

# **EKSTREMIZMI I DHUNSHËM në Shqipëri**

*Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve*



# Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri

*Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve*

**Tiranë, tetor 2018**



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania

*Ky studim u përgatit në kuadër të Projektit “Forcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm”, me mbështetje financiare nga Zyra e Punëve Publike të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara.*

**Autorë:**

Gjergji VURMO, autori kryesor  
Enis SULSTAROVA, bashkautor

**Ekipi i hulumtimit:**

Gjergji Vurmo, Drejtues i hulumtimit  
Enis Sulstarova, Hulumtues  
Aleka Papa, Hulumtuese  
Dalina Jashari, Hulumtuese  
Romario Shehu, Asistent hulumtues

**Këshilltarë të Hulumtimit:**

Sotiraq Hroni  
Leonie Vrugtman

*Layout dhe design: Eduart Cani*

*Proofreading: Iain F Wilson*

ISBN 978-9928-4385-2-2

IDM, tetor 2018

# Përmbajtja

Lista e figurave	5
Lista e tabelave	9
Lista e shkurtesave	10
<b>I. Përmbledhje</b>	<b>11</b>
<b>II. Hyrje</b>	<b>14</b>
<b>III. Metodologjia</b>	<b>16</b>
III.1. Instrumentet e hulumtimit	18
III.1.1. Analiza paraprake dhe rishikimi	18
III.1.2. Intervistat	18
III.1.3. Sondazhi kombëtar	18
III.1.4. Diskutimet në fokus grupe	20
<b>IV. Profili i të anketuarve të sondazhit</b>	<b>21</b>
IV.1. Demografia	21
IV.2. Përkatësia dhe praktikat fetare	25
IV.3. Perceptimet dhe përvoja e bashkekzistencës fetare në Shqipëri	28
<b>V. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri</b>	<b>33</b>
V.1. Nxitësit social-ekonomikë	33
V.1.1. Përrjashtimi social dhe marginalizimi	35
V.1.2. Rrjetet shoqërore dhe dinamikat brenda grupeve	38
V.1.3. Diskriminimi shoqëror	42
V.1.4. Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	47
V.1.5. Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike	51
V.1.6. Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike	54
V.1.7. Përfundime për nxitësit social-ekonomikë	57
V.2. Nxitësit politikë	58
V.2.1. Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	61
V.2.2. Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	64
V.2.3. Pushtimi i huaj dhe dhunimi politik/ushtarak	69
V.2.4. Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	73
V.2.5. Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët	76

V.2.6. Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm	80
V.2.7. Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane	84
V.2.8. Konkluzione për nxitësit politikë	89
V.3. Nxitësit kulturorë	91
V.3.1. Perceptimet e Islamit nën rrethim	92
V.3.2. Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	95
V.3.3. Agjendat “Proaktive” fetare	98
V.3.4. Konkluzione për nxitësit kulturorë	102
V.4. Çështje specifike për Shqipërinë	102
V.4.1. Autoriteti fetar	104
V.4.2. Forcimi i tolerancës fetare—Më shumë apo më pak njohuri fetare?	108
V.4.3. Shkëputja	109
V.4.4. Riintegrimi i ish luftëtarëve të huaj dhe i të rikthyerve	112
<b>VI. Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri —Perceptime, praktika dhe realiteti</b>	<b>115</b>
<b>VII. Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>119</b>
VII.1. Çfarë e nxit ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?	119
VII.2. Shtrirja e ekstremizmit fetar në Shqipëri	123
VII.3. Besimi fetar, ekstremizmi fetar dhe potenciali për ekstremizmin jofetar	123
VII.4. Rruga përpara	124
<b>VIII. Shtojca</b>	<b>127</b>
VIII.1. Shpërndarja e kampionit të sondazhit	127
VIII.2. Pyetësi i sondazhit	129
<b>IX. Bibliografia</b>	<b>140</b>



## Lista e figurave

Figura 1. Përbërja gjinore e të anketuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	22
Figura 2. Vendbanimi i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	22
Figura 3. Niveli arsimor i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	23
Figura 4. Moshja e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	23
Figura 5. Gjendja civile e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,597)	24
Figura 6. Statusi i punësimit i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,599)	24
Figura 7. Të ardhurat neto personale mujore të të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,589)	25
Figura 8. Përkatësia fetare e të anketuarve sipas origjinës (familjes) (%; N = 1,599)	26
Figura 9. Përkatësia fetare (personal përkundër asaj të familjes) së të intervistuarve (%; N = 1,598)	26
Figura 10. Praktikimi i riteve fetare tek të anketuarit (%; N = 1,595)	27
Figura 11. Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (%; N = 1,448)	28
Figura 12. Përkatësia fetare e rrethit shoqëror të të anketuarve (%; N = 1,584)	28
Figura 13. Opinioni i të anketuarve për tolerancën fetare në shoqërinë shqiptare (në një shkallë nga 1, urrejtje fetare, në 4, harmoni fetare. %; N = 1,485)	29
Figura 14. Mbështetja e të intervistuarve për martesën ndërfitare të një anëtari të familjes (%; N = 1,589)	30
Figura 15. Mbështetja për martesat ndërfitare të anëtarëve të familjes sipas praktikimit të fesë nga të anketuarit (%; N = 1584)	31
Figura 16. Mbështetja për martesat ndërfitare të anëtarëve të familjes sipas nivelit arsimor (%; N = 1585)	31
Figura 17. Përqindja e mbështetjes për martesat ndërfitare sipas grupmoshës (%; N = 1573)	32
Figura 18. Opinioni i të anketuarve për kontrollin apo ndikimin e familjes (N = 1,590), dhe për ndikimin e komunitetit (N = 1,585), tek sjellja e të rinjve (%)	36
Figura 19. Mbështetja për pohimin se të rinjtë kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogave dhe sjelljeve të rrezikshme (%; N = 1,592)	38
Figura 20. Opinioni i të intervistuarve për familjen (N = 1,590) dhe rrethin shoqëror (N = 1,587) si nxitës kryesorë për praktikimin e fesë (%)	40
Figura 21. Përqindja e të anketuarve që pretendojnë se në zonën e tyre veprojnë grupe apo individë që nxisin ekstremizmin e krishterë (N = 1,587) apo islamik (N = 1,590)	41
Figura 22. Përqindja e të anketuarve që besojnë se përfitojnë më pak nga mundësitë e zhvillimit social-ekonomik për shkak të përkatësisë fetare (N = 1,593)	44
Figura 23. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se mjekra, shamia dhe burka janë shenjë e ekstremizmit fetar (N = 1,592)	45



Figura 24. Opinioni nëse ka një nivel të mirë të përfaqësimit fetar në politikë dhe institucionet shtetërore (%; N = 1,587)	46
Figura 25. Përgjigjet për pohimin se punëkërkuessit e mbikualifikuar duhet të pranojnë vende pune për të cilat ata janë të mbikualifikuar (%; N = 1,586)	48
Figura 26. Përgjigjet për pohimin se të rinjtë e mirë-arsimuar kanë kapur vende të mira pune (%; N = 1,591)	49
Figura 27. Përgjigjet për pohimin se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë është puna e tyre e ndershme (%; N = 1,588)	50
Figura 28. Përqindja e mbështetjes për pohimin se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime (N = 1,590) dhe se ka shumë familje/individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës (N = 1,589)	52
Figura 29. Përqindja e mbështetjes për pohimin se ka grupe fetare që u ofrojnë privilegje ose përfitime materiale/ekonomike praktikantëve të fesë së tyre (N = 1,592)	53
Figura 30. Përqindja e mbështetjes për pohimin se disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që nuk m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja (N = 1,580)	55
Figura 31. Përqindja e mbështetjes për pohimin se për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm (N = 1,588) dhe pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet (N = 1,589)	56
Figura 32. Mbështetja për pikëpamjen se të drejtat dhe liritë civile të qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore dhe se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (%; N = 1,583)	62
Figura 33. Opinioni për sjelljen e institucioneve ligjzbatuese ndaj myslimanëve përkundër të krishterëve (%; N = 1,582)	66
Figura 34. Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se zbatimi i Sheriatit duhet të lejohet për besimtarët myslimanë (%; N = 1,582)	67
Figura 35. Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore (%; N = 1,586)	68
Figura 36. Opinioni i të anketuarve për Pohimin 1 (N = 1,581) dhe Pohimin 2 (N = 1,580) për sa i përket pikëpamjeve për nxitësin 'Pushtimi i huaj' (%)	71
Figura 37. Perceptimi i të anketuarve për detyrën e çdo besimtari që të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim (%; N = 1,584)	72
Figura 38. Opinioni i të anketuarve për Pohimin 1 (N = 1,570) dhe Pohimin 2 (N = 1,579) në lidhje me pikëpamjet për nxitësin 'korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta' (%)	75
Figura 39. Opinioni i të anketuarve nëse aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti (%; N = 1,576)	77
Figura 40. Opinioni i të anketuarve për prezencën e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët (%; N = 1,581)	79
Figura 41. Opinioni i të anketuarve për praninë e shtetit në zonat rurale krahasuar me qytetet (%; N = 1,579)	79





Figura 42. Përqindja e përgjigjeve ‘plotësisht dakord’ dhe ‘aspak dakord’ tek të anketuarit për pohimet 1–3 të nxitësit “Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm”	81
Figura 43. Opinioni i të anketuarve për praninë e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në komunitetin e tyre (%; N = 1,580)	82
Figura 44. Opinioni i të anketuarve për praninë e presionit ndaj besimtarëve që t’i bashkohen kauzave ekstremiste (%; N = 1,580)	83
Figura 45. Opinioni i të anketuarve për gatishmërinë e besimtarëve të denjë për të denoncuar anëtarët e komunitetit të tyre që kanë bindje ekstremiste fetare (%; N = 1,582)	83
Figura 46. Përqindja e përgjigjeve “plotësisht dakord” dhe “aspak dakord” tek të anketuarit për Pohimin 1 dhe Pohimin 2 të nxitësit “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane”	86
Figura 47. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se strukturat globale janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet myslimane (%; N = 1,579)	86
Figura 48. Përqindja e mendimit të të anketuarve që vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare (%; N = 1,584)	87
Figura 49. Përqindja e të anketuarve që janë plotësisht dakord dhe aspak dakord për padrejtësinë në Ballkan nga BE dhe ShBA (%)	88
Figura 50. Perceptimet e të anketuarve se Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (%; N = 1,586)	88
Figura 51. Perceptimet e të anketuarve SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (%; N = 1,587)	89
Figura 52. Opinioni i të anketuarve nëse Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame (%; N = 1,585)	93
Figura 53. Opinioni i të anketuarve (%) se në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman (N = 1,583) apo i krishterë (N = 1,581)	94
Figura 54. Opinioni i të anketuarve nëse myslimanët në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator (%; N = 1,576)	96
Figura 55. Opinioni i të anketuarve (%) nëse Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare në vend (N = 1,575) dhe jashtë vendit (N = 1,574)	97
Figura 56. Përgjigjet e të anketuarve për mendimin se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm (%; N = 1,575)	98
Figura 57. Opinioni i të anketuarve se predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshkatan me tendencat moderne e perëndimore të vendit (%; N = 1,569)	100
Figura 58. Opinioni i të anketuarve për praninë e grupeve myslimane (N = 1,567) apo të krishtera (N = 1,575) që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë (%)	101
Figura 59. Qëndrimi i të anketuarve për ndalimin e objekteve të paligjshme fetare (%; N = 1,580)	105
Figura 60. Qëndrimet e të anketuarve nëse qëndrimet e kreut të komunitetit të tyre fetar gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve (%; N = 1,577)	105



Figura 61. Opinioni i të anketuarve nëse klerikët lokalë janë me influencë (%; N = 1,579)	106
Figura 62. Qëndrimet e të anketuarve nëse klerikët kanë arsimin e duhur fetar (%; N = 1,577)	107
Figura 63. Përqindja e të anketuarve që konfirmojnë praninë e objekteve të paligjshme fetare, mbështetjen e drejtuesve të komunitetit fetar, ndikimin e perceptuar dhe kapacitetet e klerikëve lokalë (pohimet 1-4)	108
Figura 64. Opinioni i të anketuarve që njohuritë fetare si lëndë me zgjedhje në shkolla do të forconin tolerancën fetare në Shqipëri (%; N = 1,577)	109
Figura 65. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se besimtarët e radikalizuar mund të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare (N = 1,579) dhe ekstremistët e dhunshëm mund të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste fetare (N = 1,577)	111
Figura 66. Opinioni i të anketuarve nëse rikthimi i luftëtarëve të huaj është kërcënim për shoqërinë (%; N = 1,576)	112
Figura 67. Opinioni i të anketuarve që vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por nuk kanë kryer krime duhet të riintegrohen (%; N = 1,574)	113
Figura 68. Opinioni i të anketuarve se organet shtetërore duhet të angazhohen për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit (%; N = 1,575)	114
Figura 69. Opinioni i të anketuarve për praninë e individëve ekstremistë fetarë në Shqipëri (%)	123
Figura 70. Prania e konfirmuar e ekstremizmit të dhunshëm fetar dhe potenciali për mesazhet ekstremiste jofetare (%)	124



## Lista e tabelave

Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe çështjet specifike për Shqipërinë	17
Tabela 2. Nxitësit social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm	34
Tabela 3. Nxitësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm	59
Tabela 4. Nxitësit kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm	92
Tabela 5. Opinioni i të anketuarve për arsyet kryesore që krijojnë apo nxisin radikalizimin fetar tek individët	115
Tabela 6. Opinioni i të anketuarve për aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri	116
Tabela 7. Faktorët e qëndresës ndaj ekstremizmit të dhunshëm	117



## Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BP	Ballkani Perëndimor
KEDH	Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
DFK	Diskutime në fokus grupe
EDH	Ekstremizmi i dhunshëm
FARC	Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë
FH	Freedom House
FHE	Forumi i hulumtimeve për ekstremizmin
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komisioni Evropian
KMSH	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
LH	Luftëtarët e huaj
LMAV	Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (North Atlantic Treaty Organisation)
OJQ	Organizata jo-qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
RSF	Reporters sans frontières (Reporterët pa kufi)
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë



# I. Përmbledhje

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm mbetet i pranishëm dhe përbën ende një kërcënim të mundshëm për Shqipërinë, pavarësisht progresit të arritur në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (nëntor 2015). Me anë të veprimeve të koordinuara të shtetit, komunitetit fetar, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në vend është rritur ndërgjegjësimi për rreziqet dhe format e ekstremizmit të dhunshëm dhe është forcuar vigjilenca e komuniteteve dhe autoriteteve fetare. Po ashtu, Shqipëria ka forcuar kuadrin ligjor me mekanizma kufizues dhe ka përmirësuar kapacitetet e autoriteteve qendrore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë për t'iu përgjigjur ekstremizmit fetar. Gjithsesi, nga ky studim konfirmohet prania e ideologjive dhe individëve ekstremistë fetarë. Më konkretisht, një në dhjetë shqiptarë konfirmojnë se në zonën e tyre ka individë që nxisin ekstremizmin fetar, të cilët mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar ose që u bëjnë presion besimtarëve t'u bashkohen kauzave ekstremiste. Për më tepër, kërcënimi nuk vjen thjesht nga prania e këtyre individëve, por më shumë nga pasojat që mund të rrjedhin prej veprimeve të tyre, nëse aktorët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri nuk arrijnë të trajtojnë problematikat e grupeve në rrezik dhe të adresojnë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm përmes një qasjeje të përshtatur.

Nxitësit social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm mbeten prezentë dhe mundësues për ideologjitë ekstremiste. Situata e demokracisë në vend dhe niveli aktual i zhvillimit social-ekonomik ngrenë shqetësime, të cilat kur ndërthuren me faktorë të tjerë mund të rrezikojnë grupe të caktuara të shoqërisë me anë të fuqisë së manipulimit të ideologjive ekstremiste.

Prania e individëve dhe ekstremistëve fetarë që ushtrojnë presion tek besimtarët fetarë për t'iu bashkuar kauzave ekstremiste konfirmohet edhe në ato bashki që më parë nuk njiheshin si vatra të nxehta nga komuniteti i aktorëve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Besimtarët praktikantë të komuniteteve fetare janë më të ekspozuarit ndaj rreziqeve dhe mesazheve që lidhen me nxitësit kulturorë. Edhe pse shumica e shqiptarëve nuk besojnë se problemet që përcillen nga mesazhet ekstremiste kanë lidhje me vendin e tyre, disa prej këtyre problemeve mund të justifikohen nga një përqindje jo e vogël e besimtarëve fetarë dhe të anketuarve të moshës 30-40 vjeç.

Nxitësit politikë përbëjnë një rrezik të mundshëm në kontekstin shqiptar për shkak të zhgënjimit të madh të publikut me qeverisjen dhe shtetin ligjor. Profilet që janë më të rrezikuar nga nxitësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm janë të papunët, meshkujt, njerëzit me nivel të ulët arsimor, banorët e zonave rurale, dhe individë të moshës deri në 35 vjeç. Çështje të tilla si korrupsioni, pandëshkueshmëria dhe besimi i përhapur se sistemi politik kontrollohet dhe i shërben vetëm elitave me lidhje të forta janë faktorët që ushqejnë mospërfilljen e madhe që karakterizon shqiptarët, pavarësisht besimit të tyre fetar. Në kushte të tilla, ideologjitë ekstremiste të dhunshme mund të depërtojnë tek komunitetet lokale dhe mesazhet e tyre mund të mos jenë domosdoshmërisht vetëm fetare. Megjithatë, kërcënim për besimtarët fetarë janë manipulimi i problematikave të nxitësve politikë përmes fryrjes së ndjenjave fetare dhe përhapjes së mesazheve ekstremiste që bazohen në realitete konkrete të vetë besimtarëve. Nxitësit kulturorë dhe politikë mund të përforcojnë njëri-tjetrin, duke e bërë bashkësinë e besimtarëve fetarë një shënjestër të rrezikuar nga ekstremizmi i dhunshëm.



Zonat e pazhvilluara dhe periferitë e qendrave urbane që luftojnë për të ndërtuar komunitete kohezive përballen më shumë me sfidat e nxitësve social-ekonomikë. Së bashku me problematikat që vijnë nga niveli i lartë i informalitetit, nga papunësia, cilësia e dobët e shërbimeve publike dhe nga zhgënjimi i të rinjve, këto zona janë më të rrezikuara nga nxitësit social-ekonomikë. Ndonëse nga ky studim del se ka shumë pak mundësi që vetëm problemet social-ekonomike t'i shtyjnë besimtarët fetarë drejt ekstremizmit të dhunshëm, nxitësit social-ekonomikë mund të bëhen shkak tërheqës për t'u lidhur me ekstremizmin e dhunshëm jofetar.

Studimi konstaton se aktorët shqiptarë e kanë nënvlerësuar potencialin e ekstremizmit jofetar. Një potencial i tillë shfaqet tek një numër i konsiderueshëm shqiptarësh që justifikojnë përdorimin e mjeteve të paligjshme për përballimin e problemeve, përfshirë këtu luftën e përditshme për mbijetesë, sistemin politik që perceptohet si i pandershëm apo që i shërben vetëm elitave me lidhje të forta, dhe mohimin e të drejtave dhe lirive nga institucionet shtetërore. Gjetje të tilla përbëjnë një potencial tepër të madh për lulëzimin e alternativave politike radikale, anti-establishment e populiste në kontekstin shqiptar për shkak të mosbesimit prej disa dekadash dhe pritshmërive të paplotësuara që vijnë si pasojë e qeverisjes dhe shtetit ligjor në Shqipëri. Rreziku nga mesazhe të tilla është veçanërisht i lartë nëse mesazhet ekstremiste vendosin lidhjen me nxitësit politikë dhe social-ekonomikë.

Gjetjet e mësipërme sugjerojnë se Shqipëria duhet të vazhdojë të punojë në drejtim të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (EDH) dhe të ngrejë komunitete të qëndrueshme ndaj ideologjive të EDH, veçanërisht duke përdorur faktorët e qëndresës. Në studim theksohet rëndësia e komuniteteve kohezive, arsimit, fuqizimit të grave, tolerancës fetare, traditës së moderuar të praktikimit të fesë, dhe informimit dhe vigjilencës së publikut për të luftuar diskriminimin dhe paragjykimet si faktorë që i pengojnë ato. Shqiptarët i vënë theksin rolit dhe kapaciteteve të autoriteteve fetare, institucioneve shtetërore, sistemit arsimor, medias dhe shoqërisë civile si aktorët kryesorë për parandalimin e EDH. Ndonëse nga një numër më i vogël shqiptarësh të rinjtë dhe gratë konsiderohen si aktorë kryesorë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në nivel komuniteti, përfshirja e tyre duhet të bëhet prioritet, sepse këto grupe përbëjnë si mundësinë ashtu edhe sfidën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm (KEDH). Femrat tregojnë një nivel më të madh qëndrese ndaj veprimeve të paligjshme apo të dhunshme, por ato janë më pak të artikuluar për sa i përket çështjeve të ndjeshme, përfshirë këtu denoncimin e individëve ekstremistë në qendrat e tyre të banimit.

Shqipëria duhet të ecë më shpejt duke u zhvendosur nga modeli i veprimeve për luftën/parandalimin e EDH me fokus kryesor tek EDH fetar drejt një kuadri të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial për qëndresën e komunitetit kundrejt të gjitha formave dhe ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm, qofshin ato fetare apo jo. Prioritetet më urgjente në këtë kontekst janë si më poshtë:

1. Vendimmarrësit kombëtarë duhet të shqyrtojnë strategjinë aktuale KEDH dhe të zgjerojnë objektin e planit të saj të veprimit për të përfshirë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm.
2. Autoritetet shtetërore, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm duhet të rrisin fokusin e tyre tek qëndresa e komunitetit. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të asistohen në punën e tyre për përshtatjen e planeve të qëndresës së komunitetit me qëllim që të trajtohen problematikat e komunitetit. Këto plane të mbështeten në përfshirjen e aktorëve publikë, privatë dhe shoqërorë në nivel vendor.



3. Strategjitë sektoriale që mbulojnë çështje të caktuara ku trajtohen të gjithë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm duhet të përfshijnë edhe masa që trajtojnë problematikat, nevojat dhe përparësitë që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.
4. Masat që merren me synim parandalimin duhet të përshtaten për grupe të caktuara që janë në rrezik. Në vend që të punohet me metodën “një numër bën për të gjithë”, në veprimet e parandalimit duhet të merren parasysh larmia e grupeve në rrezik dhe numri i madh i nxitësve. Për shembull, besimtarët janë më në rrezik nga mesazhet ekstremiste fetare që synojnë të manipulojnë faktorë të ndryshëm të nxitësve kulturorë dhe politikë të ekstremizmit të dhunshëm. Besimtarët fetarë tregojnë më shumë rezistencë se grupet e tjera ndaj nxitësve social-ekonomikë. Po ashtu, ky studim tregon se gratë i refuzojnë mesazhet ekstremiste që justifikojnë dhunën, por ato duhet të fuqizohen për të ngritur më shumë zërin kundër mesazheve të tjera ekstremiste.
5. Duhet t’u jepet përparësi zonave gjeografike me rrezik të lartë dhe mesazheve ekstremiste që nuk iu është kushtua vëmendja e duhur. Rreziku që vjen nga ekstremizmi jofetar, i lënë pas dore për një kohë të gjatë, kërkon marrjen e masave urgjente për rikthimin e besimit tek qeverisja dhe shteti ligjor në Shqipëri, shoqëruar me përmirësimin e analizës dhe rritjen e njohurive në hartimin e strategjive më afatgjate kundër alternativave politike populiste dhe të tjera radikale.
6. Edhe pse toleranca fetare është vlerë me bazë të fortë në shoqërinë shqiptare, është me rëndësi të vazhdohet me promovimin e pranimit dhe përfshirjes së besimtarëve praktikantë. Pa këtë, besimtarët mund të ndjehen të lënë pas dore dhe mund të bëhen më të vëmendshëm ndaj mesazheve ekstremiste fetare. Investimi në kapacitetet e autoriteteve fetare dhe inkurajimi i hapjes së tyre, dialogut dhe veprimeve do të ishin një qasje efektive për parandalimin e ekstremizmit fetar, duke qenë se këto autoritete gëzojnë besim të madh tek shqiptarët.
7. Nuk duhet të lihet më jashtë vëmendjes hapja e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimin. Shumica e shqiptarëve mbështesin rikthimin dhe riintegrimin e ish luftëtarëve. Megjithatë, mungesa e një debati të informuar dhe e veprimeve konkrete nga ana e aktorëve kryesorë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm kontribuon në konfuzionin e përgjithshëm që ekziston në lidhje me të rikthyerit dhe përbën një mundësi të humbur për riintegrimin e tyre konstruktiv.
8. Aktorëve komunitarë duhet t’u jepet mundësia t’u dëgjohet më shumë zëri dhe t’u sigurohen kapacitete dhe mjete për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me qëllim që të rritet vigjilenca dhe të mundësohen komunitete kohezive në nivel vendor. Duhet të promovohen qasje dhe modele me përfshirjen e shumë aktorëve, ku të bëhen bashkë dhe të koordinohen veprimet e qeverisë qendrore dhe pushteti vendor, shoqërisë civile, komuniteteve fetare, medias, botës akademike, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë.





## II. Hyrje

Tre vjet pas vlerësimit të parë të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri (Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2015), IDM ka analizuar edhe një herë situatën duke bërë një vlerësim të gjithanshëm të nxitësve dhe faktorëve të tjerë që çojnë apo mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm në nivel kombëtar.

Ky studim vjen në një kohë kur ndjeshmëria për ekstremizmin e dhunshëm është më e lartë, përfshirja e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë është më aktive dhe komunitetet fetare janë më vigjilente. Po ashtu, edhe publiku është më i ndërgjegjshëm për kërcënimet dhe rreziqet dhe për vetë ekzistencën e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, ndonëse me një intensitet shumë më të vogël se në disa vende fqinje. Më e rëndësishmja, mjedisi shqiptar i marrëdhënieve institucionale dhe shoqërore në lidhje me luftën kundër ekstremizmit fetar zhvillohet në një kontekst që ka mishëruar tolerancën dhe bashkëjetesën fetare si një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë dhe traditave qytetare që gëzojnë mbështetje pothuajse unanime tek shqiptarët.<sup>1</sup>

Qeveria shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit në nëntor të vitit 2015.<sup>2</sup> Një vit më vonë u emërua Koordinatori Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDH) me detyrë bashkërendimin e zbatimit të strategjisë kombëtare. Pothuajse dy vjet më vonë, Zyra Kombëtare e Koordinatorit të KEDH-së u shndërrua në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) me larmi burimesh dhe me zyrë në Kryeministri.<sup>3</sup>

Aktorët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri kanë ndërthurur gjatë viteve të fundit përdorimin e masave kufizuese me ato parandaluese për të luftuar përhapjen e grupeve dhe mesazheve të EDH dhe për të parandaluar nisjen e luftëtarëve të huaj (LH) nga Shqipëria. Numri i këtyre luftëtarëve nga Shqipëria që largohen për të marrë pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak ra në zero në fund të vitit 2015. Një rënie e tillë drastike ishte rezultat i drejtpërdrejtë i ndryshimeve që iu bënë Kodit Penal (2014) që i konsideron tashmë vepër penale pjesëmarrjen dhe rekrutimin për konfliktet e armatosura në vende të huaja. Gjatë viteve 2012 – 2015 rreth 144 shtetas shqiptarë shkuan në Siri dhe Irak për luftuar në konfliktet e armatosura në këto vende, ndërsa raporti i Komisionit Evropian i vitit 2018 thekson se rreth 45 luftëtarë janë kthyer dhe 26 janë vrarë, me 73 vetë (përfshirë 18 luftëtarë dhe 55 anëtarë të familjeve) që gjenden ende në zonat e luftës. Në vitin 2016, Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi nëntë rekrutues të LH dhe bashkëpunëtorët e tyre me 126 vjet burg në total, ku dënimet për secilin prej tyre varionin 7-18 vjet. Organet e zbatimit të ligjit dhe strukturat e inteligjencës kanë realizuar disa operacione në bashkëpunim edhe me agjencitë e vendeve partnere. Në vitin 2017, u realizuan pesë operacione, në të cilat u

- 
1. Shih Toleranca fetare në Shqipëri (IDM 2018, f. 4): “Shqiptarë e konsiderojnë tolerancën fetare si një vlerë themelore, më shumë të rrënjosur thellë në traditën dhe vlerat e tyre morale e shoqërore sesa të përjetuar si praktikë, bindje, apo politikë sociale, të cilat mbështeten në njohjen e feve të ndryshme dhe pranimin e ndryshimeve fetare.” Burimi: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf>
  2. Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 930, datë 18 nëntor 2015. Shih fletoren zyrtare [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf)
  3. Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 737, datë 13 dhjetor 2017. Burimi: <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%20225/VKM%20nr.%20737,%20date%2013.12.2017.pdf>





arrestuan 12 të dyshuar për veprën penale të terrorizmit.<sup>4</sup>

Këto tre vitet e fundit kanë qenë veçanërisht intensive edhe nga perspektiva e masave parandaluese, të drejtuara nga Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe të mbështetura nga një sërë donatorësh ndërkombëtarë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Bashkimi Evropian (BE) dhe shtetet e saj anëtare, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), agjencitë e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë. Komunitetet fetare, veçanërisht Komiteti Mysliman Shqiptar (KMSH), dhe aktorë të shoqërisë civile u angazhuan në aktivitete specifike për parandalimin e radikalizimit, për luftën kundër efekteve të mesazheve ekstremiste, për ngritjen e kapaciteteve e punonjësve që janë në kontakt të parë me njerëzit, për rritjen e ndërgjegjësimit, për punën me të rinjtë dhe gratë, për krijimin e modeleve të bashkëpunimit në nivel vendor - si nisma “shkolla si qendër komunitare”, për nxitjen e tolerancës fetare, e kështu me radhë. Komiteti Mysliman ka vazhduar të jetë një nga aktorët kryesorë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend, pavarësisht sfidave që i dalin përpara për shkak të presionit të jashtëm dhe luftës së brendshme për pushtet.<sup>5</sup> Një arritje tjetër me rëndësi të madhe është diskutimi i ekstremizmit të dhunshëm përtej suazave të sigurisë (desekuritizimi) nga autoritetet shtetërore, gjë që ilustron me përfshirjen aktive të agjencive shtetërore jashtë spektrit të institucioneve të sigurisë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. D.m.th., mirëkuptimi i përgjithshëm i institucioneve shtetërore në vitet 2014 dhe 2015 mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftëtarëve të huaj është se këto sfida bëjnë më se të nevojshme përfshirjen e institucioneve të sigurisë. Kjo mendësi ka ndryshuar në mënyrë drastike në vitet e fundit dhe në qasjen aktuale i vihet theks i veçantë rolit të institucioneve jo të sigurisë (arsimi, bashkitë, zyrat e punës, etj.) në nivel kombëtar dhe vendor. Sidoqoftë, sfidat dhe shqetësimet e ekstremizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm bëjnë të nevojshme që përpjekjet në luftën dhe parandalimin e EDH të zhvendosen nga veprimet kombëtare (ndërgjegjësimi) me aktorë me qendër në Tiranë drejt veprimeve në nivel vendor me angazhimin e aktorëve të tjerë.<sup>6</sup>

Gjetjet e këtij studimi synojnë përmirësimin e performancës së Shqipërisë në luftën dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, fetar apo jo-fetar, ngritjen e kapaciteteve të aktorëve në nivel kombëtar dhe komuniteti, përmirësimin e të kuptuarit dhe njohurive të aktorëve kryesorë, ndihmën për politikëbërësit dhe vendimmarrësit për realizimin e një plani veprimesh që mbështeten në prova të rëndësishme dhe të përditësuara. Në fund të fundit, kjo do të bëjë të mundur që të rriten përpjekjet dhe të ndikimi i masave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe do të kontribuojë tek një debat më i informuar publik dhe në ngushtimin e rrugëve që përdoren nga ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm për rritjen e mbështetjes apo të numrit të ndjekësve të tyre.

4. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2018 (f. 36). Burimi: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

5. Forumi i Hulumtimeve për Ekstremizmin (FHE) në Raportin për Shqipërinë 2018, f. 12, argumenton se “lufta e brendshme për pushtet brenda KMSH-së, që u zhvillua edhe më tej gjatë vitit 2017 si rezultat i rritjes së presionit nga Turqia për të ashtuquajturat strukturat gyleniste në Shqipëri, përfshin më së shumti klerikët dhe nuk ka prekur ndonjë numër të konsiderueshëm besimtarësh fetarë.” Burimi: <https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/erf2oalbania2oreport202018.pdf>

6. Duke konsideruar se fenomeni i ekstremizmit shqiptar është shumë më pak shqetësues sesa në vendet fqinje (p.sh. Maqedoni, Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë), masat për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel vendor duhet të harmonizohen në kontekstin e programeve të policimit në komunitet (ku të përfshihen bashkitë, shkollat, shoqëria, mediat, udhëheqësit e komunitetit, grupet fetare), duke ofruar kështu më shumë hapësirë për aktorët vendorë shoqërorë jo-shtetërorë dhe duke pakësuar arsyet për idenë e gabuar në publik se ekstremizmi është i lidhur ekskluzivisht me Islamin dhe Komitetin Mysliman Shqiptar.” Raporti i FHE për Shqipërinë 2018 (fq. 29)



### III. Metodologjia

Ky studim ka si qëllim të ofrojë informacione që lidhen me kontekstin dhe evidenca për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Në të analizohet situata aktuale pas pothuajse katër vitesh fushatë për masat e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe nxitësit dhe faktorët përkatës që e ushqejnë apo e mundësojnë atë. Studimi synon të paraqesë karakteristikat kryesore të ekstremizmit të dhunshëm, shtrirjen dhe madhësinë e tij, komunitetet në rrezik, zonat dhe grupet e cenueshme, rreziqet dhe implikimet e tjera të tij. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është të përmirësojë performancën e vendit, ndikimin dhe kapacitete e aktorëve të KEDH nëpërmjet debatit të informuar, veprimeve të bazuar në evidenca, përmirësimit të të kuptuarit dhe njohurive të aktorëve kryesorë –shtetërore dhe jo-shtetërorë– të shoqërisë si dhe komunitetit të partnerëve që mbështesin Shqipërinë në këtë përpjekje.

Kështu, studimi orientohet nga qasja metodologjike e vlerësimit të parë bazë të realizuar nga IDM në vitet 2014 dhe 2015 “Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”<sup>7</sup>, por me një objektiv më të gjerë dhe instrumente kërkimore me përmirësime të konsiderueshme. Në mënyrë të veçantë, metodologjia e hulumtimit të këtij studimi bën të mundur shqyrtimin e nxitësve që lidhen me ideologjitë ekstremiste fetare dhe jofetare në nivel kombëtar.<sup>8</sup>

Për të shqyrtuar fenomenin, në këtë studim u përdor kuadri i nxitësve social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm, të përshkruar nga Denoëux dhe Carter (2009) në botimin e tyre “Guida e Nxitësve të Ekstremizmit të Dhunshëm”. Nuk u përfshinë tre nxitës politikë – konflikti lokal, mbështetja shtetërore, dhe qeveri të diskretituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore – për shkak të mungesës së lidhjes me kontekstin e Shqipërisë.<sup>9</sup> Për më tepër, ky studim e ka zgjeruar gamën e faktorëve të tjerë që lidhen specifikisht me Shqipërinë në kuadër të përpjekjeve KEDH, nëse e krahasojmë me studimin e vitit 2015. Kështu, IDM ka analizuar në këtë hulumtim çështje të reja që lidhen me riintegrimin e ish luftëtarëve të huaj, shkëputjen dhe kurrikulën për fenë, së bashku me faktorët e tjerë (që në këtë studim klasifikohen nën autoritetin fetar), të cilët ishin të përfshirë në studimin e vitit 2015.

Si rezultat, kuadri i këtij studimi për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorët e tjerë nën shqyrtim përbëhet nga katër kategori, me gjithsej 17 nxitës të ekstremizmit të dhunshëm dhe shtatë çështje specifike për Shqipërinë, siç evidentohet në Tabelën 1.

---

7. Studimi i IDM-së i vitit 2015 gjendet në adresën <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/RadikalizmiFetar-webOK2.pdf>

8. Studimi i IDM-së i vitit 2015 fokusohet kryesisht tek ekstremizmi i dhunshëm dhe mbulonte tetë zona (bashki) në Shqipëri që konsideroheshin si vatra të nxehta të ekstremizmit të dhunshëm sipas intervistave me informatorë kyçë dhe media që raportonin për luftëtarët e huaj nga Shqipëria.

9. E njëjta qasje si ajo e përdorur në studimin e IDM-së në vitin 2015



**Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe çështjet specifike për Shqipërinë**

NXITËSIT SOCIAL-EKONOMIKË		NXITËSIT KULTURORË	
Perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social	Rrjetet shoqërore dhe	Islami nën rrethim	Agjendat “proaktive” fetare
dinamikat e grupit	Unmet social and economic needs	Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	
Diskriminimi shoqëror	Nevoja të papërmbushura		
ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR SHQIPËRINË		NXITËSIT POLITIKË	
Kurrikula për fenë	Shkëputja	Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta
Autoriteti fetar: 1. Qëndrimet ndaj objekteve të paligjshme fetare 2. Autoriteti fetar (qendror) i (pa) diskutuar 3. Klerikë fetarë vendorë me influencë? 4. Klerikët vendorë me (pa) arsimin e duhur fetar	Riintegrimi i ish luftëtarëve të huaj dhe i të kthyerve	Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Zonat e paqeverisura ose të qeverisura dobët
		Pushtimi i huaj	Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm
		Dhunimi politik ose ushtarak, ose të dyja	Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë

*Burimi: Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018*

Për të shqyrtuar kuadrin e mësipërm, studimi u mbështet në një sërë instrumentesh kërkimore që shtjellohen më poshtë, përfshirë këtu hulumtimin paraprak, rishikimin e të dhënave dytësore, diskutimet në fokus grupe dhe një sondazh kombëtar. Sondazhi publik përfaqëson një instrument parësor kërkimi që prodhon informacione dhe të dhëna konkrete për secilin prej nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe për çështje të tjera të veçanta dhe faktorë që përshkruajnë realitetin e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe debatin shqiptar në këtë moment. U hartuan gjithsej



pesëdhjetë pohime për të testuar rëndësinë dhe përmasat e tre kategorive të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm, me një mesatare prej gati tre pohimesh për secilin nxitës si dhe dhjetë pohime të tjera që analizojnë çështjet specifike për Shqipërinë. Pohimet u hartuan në përputhje me objektivat e studimit, (mangësitë dhe nevojat për) praktikën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe me kontekstin teorik të nxitësve të EDH, siç përshkruhen nga Denoeux dhe Carter (2009). Kështu, analiza mbështetet në një gamë të gjerë burimesh dhe të dhënash për një shqyrtim gjithëpërfshirës të a) nivelit të nxitësit ose faktorit përkatës, b) kategorisë së nxitësit ose faktorit, dhe c) marrëdhënies mes nxitësve të kategorive të ndryshme dhe ndërveprimeve të tyre në kontekstin shqiptar.

### **III.1. Instrumentet e hulumtimit**

Ky studim u mbështet në hulumtimin e të dhënave parësore dhe dytësore, në mënyrë që jo vetëm të japë një panoramë të gjendjes aktuale të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm me informacione të përditësuara, por edhe të evidentojë progresin e arritur në vitet e fundit dhe dinamikën e debatit për KEDH-në, drejtimin e masave, ndikimin e tyre dhe rezultatet. Këto të fundit bëjnë të mundur të shqyrtohet më mirë çdo transformim apo dobësim i fenomenit të EDH.

#### **III.1.1. Analiza paraprake dhe rishikimi**

Qëllimi i analizës paraprake dhe rishikimit të hulumtimeve të fundit për ekstremizmin e dhunshëm ishte i dyfishtë. Së pari, ai synonte procesin e hartimit të metodologjisë, veçanërisht instrumentin e sondazhit, dhe qasjen e përgjithshme metodologjike të këtij studimi. Së dyti, përmes hulumtimit të të dhënave dytësore u krijua një bazë e përditësuar e treguesve të ndryshëm (socialë, ekonomikë dhe politikë) për të ndihmuar në analizimin e nxitësve dhe kontekstit të ekstremizmit të dhunshëm.

#### **III.1.2. Intervistat**

Në fazën fillestare dhe në atë të vleftësimit të metodologjisë u bënë një numër i kufizuar (dhjetë) intervistash gjysmë të strukturuar me ekspertë, punonjës të KEDH, përfaqësues të fesë dhe institucioneve shtetërore. Instrumenti i hulumtimit (pyetësi), hartimi i pohimeve të kontrollit dhe gjetjet nga procedurat e testimit u konsultuan me ekspertë të zgjedhur dhe përfaqësues të bashkësive fetare, së bashku me konsultime të brendshme brenda grupit hulumtues të IDM-së që përbëhej nga hulumtues me përvojë në ekstremizmin e dhunshëm dhe sigurinë, shkencat shoqërore, anketat dhe diskutimet në fokus grupe.

#### **III.1.3. Sondazhi kombëtar**

Bazuar në gjetjet e fazës së vleftësimit të metodologjisë dhe duke përdorur instrumentin e sondazhit të IDM-së për vitin 2015 si bazë fillestare, ekipi hulumtues hartoi një pyetësor më gjithëpërfshirës. Testimi paraprak i pyetësorit me 100 të anketuar u bë në dhjetor 2017. Gjetjet e pilotimit të parë u përdorën për të përmirësuar instrumentin e sondazhit dhe për ta nisur atë për një testim të dytë në dy versione (janar 2018, me 50 të anketuar për secilën), të cilat kishin të ndryshme shkallën e vlerësimit për pohimet e kontrollit. Bazuar në rezultatet e testimit të dytë, ekipi



hulumtues i IDM-së përgatiti një version përfundimtar të pyetësorit (shih shtojcat), i cili iu nënshtrua testimit të fundit në mars të vitit 2018 dhe u miratua nga ekipi hulumtues, pa ndryshime të mëdha.

Pyetësori i përdorur për këtë sondazh përbëhet nga pesë seksione. Seksioni i parë përbëhet nga dhjetë pyetje me anë të të cilave mblidhen të dhëna demografike për të anketuarit dhe hollësi për përkatësinë e tyre fetare dhe nivelin e praktikimit të fesë. Seksioni i dytë përqendrohet në përvojat dhe qëndrimet e tyre në lidhje me faktorët social-ekonomikë dhe çështje të ndryshme të fesë dhe shoqërisë. Në këtë seksion parashtrihen tre pyetje, me 19 pohime me anë të të cilave të anketuarit pyeten nëse dhe sa janë dakord. Seksioni i tretë shqyrton perceptimet e të anketuarve për ndërveprimin e fesë dhe faktorëve politikë përmes tre pyetjeve ku përfshihen 22 pohime kontrolli. Në seksionin e katërt shqyrtohen perceptimet dhe qëndrimet e të anketuarve ndaj praktikave fetare në Shqipëri, duke u kërkuar të shprehen sa dakord janë me trembëdhjetë pohime në një pyetje të vetme. Seksioni i fundit shqyrton, nëpërmjet shtatë pyetjeve, çështje të ndryshme që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, riintegrimin, faktorët e qëndresës, kërcënimet dhe çështje të tjera që ndihmojnë të kuptohen qëndrimet personale të të anketuarve.

Në mars të vitit 2018, ekipi i IDM-së përgatiti logjistikën për kryerjen e sondazhit në terren me një kampion kombëtar përfaqësues prej 1,600 të anketuarish. Anketa u krye në popullatën e përgjithshme me qytetarë të moshës mbi 18 vjeç, të cilët ishin banorë të përhershëm të Shqipërisë në kohën e sondazhit. Kuadri i kampionimit u bazua tek të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë (2011) të përditësuara me informacione për dinamikën e popullsisë. Shkalla e emigrimit të shtetasve shqiptarë u llogarit nga një Koeficient Sasior Vendbanimi bazuar në regjistrimin e popullsisë dhe numrin e popullsisë sipas Regjistrimit Civil 2015 (shtetas shqiptarë) dhe në shpërndarjen e tyre në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore.<sup>10</sup> Të dhënat nga Regjistri Civil 2017 u ponderuan me koeficientët sasiorë të vendbanimit për secilën prej 61 bashkive nga të cilat u përzgjedhën 50, duke përfshirë ato më të mëdha dhe duke zëvendësuar disa bashki të vogla me të tjera për të mundësuar një mbulim më të mirë gjeografik.<sup>11</sup>

Vlerësimet e gabimit statistikor janë si më poshtë:

***Në nivel besueshmërie prej 95%, për një popullsi me 2,859,598 banorë, intervali i besueshmërisë është ±2.4.***

***Në nivel besueshmërie prej 99%, për një popullsi me 2,859,598 banorë, intervali i besueshmërisë është ±3.2.***

Grupi i intervistuesve u trajnuar në fund të muajit mars 2018 dhe puna në terren për sondazhin kombëtar u realizua në muajt prill dhe maj 2018. Të dhënat u mblodhën nga intervistat ballë për ballë. Në të gjithë procesin u zbatuan kritere të rrepta për përzgjedhjen e të intervistuarve në çdo bashki dhe njësi administrative si dhe u përdorën mekanizma rigorozë për sigurimin e cilësisë gjatë punës në terren me

10.  $WM = NM\_C2011 / NM\_CR2015$ , ku: WM është Koeficienti Sasior i Vendbanimit për çdo bashki; NM\_C2011 është numri i banorëve në çdo bashki sipas Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011; dhe NM\_CR2015 është numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në çdo bashki sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile të shtetasve shqiptarë 2015.

11. Shihni shtojcat për të parë listën e plotë të bashkive dhe shpërndarjes së tyre urbane dhe rurale.



sondazhin dhe administrimin e pyetësorëve. Të dhënat e sondazhit u futën, pastruan dhe përpunuan në një bazë të dhënash duke përdorur programin SPSS dhe në muajin qershor 2018 nisi analizimi i gjetjeve paraprake.

Të dhënat e sondazhit të prezantuara në këtë studim janë rrumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.

#### ***III.1.4. Diskutimet në fokus grupe***

Në muajt qershor dhe korrik 2018 u realizuan katër diskutime në fokus grupe (DFG), pas përfundimit të punës në terren me sondazhin dhe të analizimit të gjetjeve paraprake të perceptimeve, qëndrimeve dhe përvojave të një kampioni me përfaqësi kombëtare (shih më poshtë) në lidhje me kategoritë e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe çështje të tjera specifike për kontekstin si dhe faktorëve, të shqyrtuar në matricë (Tabela 1).

Për të kuptuar më mirë disa nga gjetjet e sondazhit me publikun dhe për të depërtuar më thellë tek qëndrimet mes profileve specifike të shtetasve shqiptarë, u bënë këto diskutime në fokus grupe:

1. DFG1: 25 qershor, me pjesëmarrës nga grupe të ndryshme demografike (sipas vendbanimit, gjinisë, moshës, statusit të punësimit, etj.) që kishin përfunduar arsimin e lartë (universitetin ose studime pasuniversitare);
2. DFG2: 26 qershor, me pjesëmarrës nga grupe të ndryshme demografike (sipas vendbanimit, gjinisë, moshës, statusit të punësimit, etj.) të grupmoshës 18–35 vjeç;
3. DFG3: 27 qershor, me pjesëmarrës nga grupe të ndryshme demografike (sipas vendbanimit, gjinisë, moshës, statusit të punësimit, etj.) që kishin mbaruar arsimin fillor ose pa arsim fare;
4. DFG4: 2 korrik, me pjesëmarrës nga grupe të ndryshme demografike (sipas vendbanimit, gjinisë, moshës, statusit të punësimit, etj.) që praktikojnë fenë rregullisht.

Gjetjet e diskutimit u analizuan dhe u përfshinë në dhe analizën e kontekstit dhe nxitësve në këtë studim.





## IV. Profili i të anketuarve të sondazhit

Hulumtimet për radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm orientohen nga pritshmëria se duke kuptuar më mirë këto fenomene do të bëhen të mundur paralajmërimi në kohën e duhur dhe parandalimi e reagimi më efikas kundër dhunës me motive fetare. Në fakt, studimet e pakta të kryera në Shqipëri në vitet e fundit për ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin, luftëtarët e huaj, debati në media për ekstremizmin dhe çështjet e lidhura me të, kanë përmirësuar ndjeshëm njohuritë e aktorëve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo ka rritur ndërgjegjësimin e publikut, ka forcuar qëndresën e bashkësive fetare dhe ka fuqizuar grupe specifike duke u dhënë aftësi dhe kapacitete më të mira për të luftuar dhe parandaluar fenomenin. Përveç instrumenteve të hulumtimit cilësor, -p.sh., intervistat gjysmë të strukturuar ose të strukturuar me informatorët kyçë, diskutimet në fokus grupe, shqyrtimi i të dhënave dytësore, analizat paraprake- me rëndësi të madhe janë edhe instrumentet e hulumtimit sasior për të përcaktuar përhapjen e një fenomeni të caktuar. Në studimin e IDM-së të vitit 2015 për tetë fusha u përdor një sondazh i synuar për besimtarë fetarë që praktikojnë fenë rregullisht dhe me qytetarë të zakonshëm për të analizuar nxitësit dhe faktorët e ekstremizmit të dhunshëm në një mjedis fare pak të ndërgjegjësuar publik dhe institucional. Të dhënat dhe dëshmitë e përftuara përmes këtij studimi bazë ndihmuan në formësimin e reagimit institucional dhe të masave të aktorëve të tjerë jo-shtetërorë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Për të vlerësuar ndikimin e këtyre masave në tre vitet e fundit dhe për të analizuar më thellë dhe në mënyrë më gjithëpërfshirëse kërcënimet dhe rreziqet që vijnë nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm, ky studim e shqyrton këtë fenomen në nivel kombëtar. Siç u shpjegua edhe tek pjesa e metodologjisë, sondazhi u projektua për një kampion përfaqësues kombëtar me 1600 të anketuar. Pyetëtori shqyrton jo vetëm perceptimet, por edhe përvojat personale dhe qëndrimet e shqiptarëve në lidhje me kategoritë e nxitësve, çështjet specifike që përshkruajnë realitetin shqiptar dhe përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

### IV.I. Demografia


Përshkrimi i kampionit të sondazhin na ofron të dhëna të rëndësishme që ndihmojnë të analizohen dhe kuptohen perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve të anketuar.<sup>12</sup> Procedura e përcaktimit të kampionit mundësoi një kampion përfaqësues kombëtar. Nga perspektiva gjinore, popullsia aktualisht rezidente në Shqipëri, sipas vlerësimit të 1 janar 2018, ka një numër pak më të madh meshkujsh (1,438,609; 50.1%) sesa femra (1,431,715; 49.9%).<sup>13</sup> Kampioni ynë prej 1,600 individësh përbëhej nga 823 meshkuj (51.4%; Figura 1) dhe 777 femra (48.6%), shumë pranë përbërjes së përgjithshme gjinore të popullsisë.

12. Shënim: Të dhënat e sondazhit të prezantuara në këtë studim janë rrumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.

13. INSTAT. "Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2018". Lutemi referojuni: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/population/publication/2018/population-in-albania-1-january-2018/> (Aksesuar në datën 18.09.2018).




**Figura 1. Përbërja gjinore e të anketuarve të sondazhit (%; N = 1,600)**



Gjatë përcaktimit të të anketuarve për secilën bashki në vend, në sondazh u tregua kujdes për sa i përket raportit të vendbanimit zonë urbane-zonë rurale për secilën bashki. Në nivel kombëtar, ky raport në sondazh (shih figurën 2) rezultoi të ishte 58:42 (928 të intervistuar që jetojnë në qytet dhe 672 që jetojnë në zonat rurale, në fshat), ndërkohë sipas Censurit më të fundit të Popullsisë dhe Banesave të Shqipërisë (2011), raporti është 54:46.<sup>14</sup> Ky ndryshim i vogël nga të dhënat e Censurit 2011 ishte i qëllimshëm dhe merr parasysh ndarjen e re administrative-territoriale të vendit (ndarje që hyri në fuqi në vitin 2015), ku përfshiheshin disa zona rurale brenda kufijve administrativë të qendrave urbane në bashkitë e reja.

**Figura 2. Vendbanimi i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)**



14. INSTAT. “Shqipëria: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011.” Tirane, 2012, f. 10. Lutemi referojuni: [http://www.instat.gov.al/media/3058/main\\_results\\_\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf)





Mbi 2/3 e të anketuarve kanë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë (Figura 3), me 22% e të anketuarve që kanë mbaruar arsimin fillor ose janë pa arsim: 59 të intervistuar (3.7%) janë pa arsim ose nuk e kanë përfunduar ciklin e plotë 8-vjeçar, 295 të intervistuar (18.5%) kanë mbaruar arsimin 8-vjeçar se 9-vjeçar; 658 të anketuar (41.2%) kanë mbaruar arsimin e mesëm, 498 të anketuar (31.2%) kanë diplomë universitare dhe 86 të anketuar (5.4%) kanë mbaruar studimet pasuniversitare (studime master ose më tej).

**Figura 3. Niveli arsimor i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)**





Figura 4 tregon se pothuajse gjysma e të anketuarve janë më të rinj se 35 vjeç (20%, 18-25 vjeç, 27.2%, 25-34 vjeç), përqindje që bie gradualisht tek kategoritë e të anketuarve më të vjetër në moshë (18.6%, 35-44 vjeç, 16.3 %, 45-54 vjet, 12.5%, 55-64 vjeç, 5.4%, mbi 65 vjeç).

**Figura 4. Moshë e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)**




Shumica e të anketuarve janë të martuar (61.1%, shih Figurën 5), pothuajse sa dyfishi




i numrit të atyre që janë të pamartuar (31%). Një tjetër 3.8 për qind bashkëjetojnë dhe pjesa tjetër janë të ve (2.3%) ose të divorcuar (1.3%). Pesë të anketuar (0.3%) refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

**Figura 5. Gjendja civile e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,597)**



Për qëllime të hulumtimit tonë, kemi mbledhur informacione për statusin e punësimit të të anketuarve. Pjesa më e madhe (628 të anketuar ose 39.3%) ishin të punësuar me pagë (Shih Figurën 6), pasuar nga të papunët (458 të anketuar ose 28.6%), të vetëpunësuarit (233 të anketuar ose 14.6%), studentët (147 të anketuar ose 9.2%) dhe të tjerë, përfshirë kryesisht pensionistë (130 të anketuar ose 8.1%). Përqindja e të intervistuarve të punësuar dhe të vetëpunësuar në këtë kampion – 53.9 për qind – është afër nivelit të punësimit prej 57.3 për qind në gjysmën e dytë të vitit aktual, 2018.<sup>15</sup>

**Figura 6. Statusi i punësimit i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,599)**




15. Ekonomia e tregtisë: <https://tradingeconomics.com/albania/employment-rate> (aksesuar më 19.09.2018).



Shpërndarja e të ardhurave mujore personale tregohet në Figurën 7, me 535 të anketuar (33.7%) që janë pa të ardhura mujore, 261 të anketuar që fitojnë deri në 20,000 lekë në muaj – afër pagës minimale aktuale të përcaktuar nga qeveria– 358 të anketuar (ose 22.5%) ka të ardhura deri në 40,000 lekë në muaj, 261 vetë (16.4%) me të ardhura mujore deri në 60,000 lekë, 70 (4.4%) me të ardhura deri në 100,000 lekë në muaj dhe 15 të anketuar (0,9%) që fitojnë më shumë se 100,000 lekë në muaj.<sup>16</sup>

**Figura 7. Të ardhurat neto personale mujore të të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,589)**



## IV.2. Përkatësia dhe praktikat fetare

Në Shqipëri, njerëzit mund të zgjedhin lirisht fenë që dëshirojnë të besojnë dhe nivelin e devotshmërisë dhe përfshirjes personale në bashkësitë fetare. Shqipëria ka komunitete fetare tradicionale që janë krijuar para shumë shekujsh si dhe komunitetet fetare që janë krijuar kohët e fundit, në këto tre dekadat e fundit. Për qëllimet e hulumtimit tonë, i kërkuam të anketuarve të deklarojnë fenë e familjes së tyre dhe fenë e tyre personale. Feja e familjes është veçanërisht e dobishme për të mundësuar që kampioni të jetë sa më përfaqësues i shpërndarjes së bashkësive fetare në popullsinë e Shqipërisë. Sipas Censurit të vitit 2011, i cili përfshinte pyetje rreth identitetit fetar, 56.7 për qind deklaruan se ishin myslimanë sunitë, 10 për qind të krishterë katolikë, 6.8 për qind të krishterë ortodoksë, 2.1 për qind bektashinj, 0.15 për qind të kishave të tjera të krishtera, 5.5 për qind besimtarë të paspecifikuar dhe 2.5 për qind ateistë, ndërsa 13.8 për qind nuk e deklaruan fenë e tyre.


Në kampionin tonë, 987 të anketuar (61.7%) deklaruan se feja e familjes së tyre është Islami (Figura 8), 182 të anketuar (11.4%) vijnë nga familje të krishtera ortodokse, 175 të anketuar (10.9%) janë nga familje katolike, 130 të anketuar (8.1%) deklaruan se feja e

16. 1 USD = 108 Lekë; 1 EUR = 126 ALL. Burimi: Banka e Shqipërisë [https://www.bankofalbania.org/Markets/Official\\_exchange\\_rate/](https://www.bankofalbania.org/Markets/Official_exchange_rate/) (aksesuar në shtator 2018).




familjes së tyre ishte bektashi, 16 të anketuar (1%) janë nga familje protestante dhe 87 të anketuar (5.4%) anëtarë të familjeve të përziera fetare.

**Figura 8. Përkatësia fetare e të anketuarve sipas origjinës (familjes) (%; N = 1,599)**




Pjesa më e madhe në kampionin tonë (80.2%) deklaruan se i përkasin të njëjtës fe si prindërit e tyre (shih Figurën 9). Përgjigjet e tjera për këtë pyetje janë si më poshtë: 13.3 për qind kanë zgjedhur të identifikohen me fenë e një prej prindërve të tyre, ndërsa 5.4 për qind deklaruan se identifikimi i tyre fetar nuk është i njëjtë me atë të prindërve të tyre.

**Figura 9. Përkatësia fetare (personal përkundër asaj të familjes) së të intervistuarve (%; N = 1,598)**



Për të vlerësuar besimin e tyre, të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin një opsion sipas një shkalle që përshkruan praktikimin e fesë së tyre. Kjo shkallë varion nga besimtari që i përmbush rregullisht kërkesat e besimit të tyre, tek besimtari që respekton ritet dhe rregullat kryesore të besimit, por që neglizhon pjesën tjetër, tek besimtari që nuk praktikon fare rregullat dhe ritet fetare, deri tek ateisti. Shumica e të anketuarve (41%) bien në kategorinë e besimtarëve nominalë, pra që nuk bëjnë ndonjë jetë edhe aq fetare (Figura 10). Një tjetër 31.8 për qind janë besimtarë që praktikojnë ritet kryesore dhe rregullat e fesë së tyre dhe 19.2 për qind e deklarojnë veten që përmbushin rregullisht të gjitha ritualet fetare. Numri i të anketuarve që deklaruan se ishin ateistë ishte 103 (6.5%).

**Figura 10. Praktikimi i riteve fetare tek të anketuarit (%; N = 1,595)**




Një tjetër mënyrë për të vlerësuar besimin fetar të individëve është pyetja për devotshmërinë ose përkushtimin e tyre ndaj fesë. Një tregues i devotshmërisë është lutja/falja, një komunikim që njerëzit përpiqen ta vendosin me hyjninë apo hyjnitë, ose qeniet dhe forcat e mbinatyrshe. Lutja/falja është ndoshta akti më i individualizuar në fetë abrahamike dhe në të njëjtën kohë është një shprehje kolektive e devotshmërisë, tejet e ritualizuar, me klerikë të specializuar dhe rregulla që duhen ndjekur. Prandaj, të anketuarve u bëme këtë pyetje: “Mund të më thoni sa shpesh luteni/faleni?” U dhamë një opsion për besimtarin e përkushtuar që lutet/falet rregullisht çdo ditë ose çdo javë, dy opsione për besimtarët që lutën/falën gjatë ritualeve kolektive, që është tregues i devotshmërisë më të vogël, një opsion për besimtarët që kryesisht bëjnë një jetë laike dhe i kthehen fesë në kohë krize, ndoshta si një mjet i fundit, një opsion si për besimtarët që nuk lutën apo edhe për jobesimtarët, si dhe një opsion për të mos e zbuluar këtë informacion personal.

Gjetjet e sondazhit tregojnë se 23.9 për qind e shqiptarëve nuk lutën/falën asnjëherë (Figura 11), 23.3 për qind lutën/falën me raste, në ngjarje të veçanta fetare, 21 për qind lutën/falën rregullisht (çdo ditë ose javë) dhe 19.5 për qind që lutën/falën në festa fetare përgjatë gjithë vitit. Dhjetë për qind e të anketuarve lutën/falën vetëm në kohë krize personale ose familjare. Vetëm 2.3 për qind refuzuan t’i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.




**Figura 11. Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (%; N = 1,448)**



### IV.3. Perceptimet dhe përvoja e bashkekzistencës fetare në Shqipëri

Duke qenë se jetojnë në një shoqëri me shumë fe, pjesa më e madhe e shqiptarëve ndeshen me njerëz të feve të tjera gjatë jetës së tyre të përditshme. Prandaj, shqyrtuam se në ç'masë ndikon përkatësia fetare në marrëdhëniet kuptimplote që ata ndërtojnë në rrethin e tyre shoqëror. Për pjesën më të madhe të të anketuarve, (596; 37.6%) rrethi i tyre shoqëror përbëhet nga njerëz të feve të ndryshme (Figura 12), ndërsa një tjetër grup i madh i të intervistuarve (335; 21.1%) raportojnë se rrethi i tyre shoqëror përbëhet nga njerëz që i përkasin feve të ndryshme dhe ateistë. Gjithsesi, rrethi shoqëror i 548 të anketuarve (34.6%) dominohet nga e njëjta fe. Rrethi shoqëror i 21 të intervistuarve (1.3%) përbëhet kryesisht nga ateistë, ndërsa 75 të anketuar (4.7%) ose nuk e dinin ose nuk e kishin menduar këtë gjë më parë. Nëntë të anketuar refuzuan t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.


**Figura 12. Përkatësia fetare e rrethit shoqëror të të anketuarve (%; N = 1,584)**



Toleranca fetare dhe bashkekzistenca paqësore janë tipare të mirënjohura të shoqërisë shqiptare, ekzistenca e të cilave pranohet dhe promovohet gjerësisht. Të intervistuarve iu bë kjo pyetje: “Sipas mendimit tuaj, në Shqipëri ka urrejtje apo harmoni fetare?”

Duke pasur parasysh se opsionet “urrejtje” dhe “harmoni” reflektojnë besime të qëndrueshme, të anketuarve iu ofruam një shkallë të ndryshueshme, me dy opsione të tjera në mes që gjithsesi do ta ruanin bipolaritetin e përgjigjeve përgjatë boshtit negativ-pozitiv. Shumica dërrmuese e kampionit kombëtar (995 të anketuar, ose 67%) thanë se ka harmoni fetare në vend (Figura 13) me një numër tjetër të konsiderueshëm (383 të anketuar, ose 25.7%) që zgjodhën një opsion pak më të ulët. Shumë pak të intervistuar (12; 0.8%) zgjodhën urrejtjen fetare si perceptimin e tyre për situatën aktuale, ndërsa një përqindje pak më e madhe (95 të intervistuar, 6.4%) zgjodhën një situatë që ishte më pak negative.

**Figura 13. Opinioni i të anketuarve për tolerancën fetare në shoqërinë shqiptare (në një shkallë nga 1, urrejtje fetare, në 4, harmoni fetare. %; N = 1,485)**




Siç u theksua më sipër, shumica e shqiptarëve identifikohen me të njëjtën përkatësi fetare të të dy prindërve të tyre. Megjithatë, studimi shqyrton nëse ka tolerancë fetare dhe nëse pranohet nga familja martesë e një anëtari të saj me një person të një feje tjetër.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve të anketuar (67.1%) do ta mbështesnin një anëtar të familjes nëse do të martohej me një person të një përkatësie tjetër fetare (Figura 14), ndërsa një përqindje shumë më e vogël (13.5%) thanë se do ta pranonin, por nuk do ta mbështesnin apo inkurajonin, një martesë të tillë. Gjithsesi, pothuajse dhjetë për qind do të kundërshtonin një martesë të tillë “në çdo rast” (4.7%) ose nëse personi tjetër do të ishte besimtar praktikant i fesë (4.9%). Një numër më i vogël (135 të anketuar ose 8.6%) nuk ishin të sigurt se cili do të ishte reagimi i tyre në një situatë të tillë, ndërsa një tjetër grup prej 19 të anketuarish (1.2%) nuk pranuan t’i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.




**Figura 14. Mbështetja e të intervistuarve për martesën ndërfitare të një anëtari të familjes (%; N = 1,589)**



Është me interes të analizohen gjetjet e mësipërme nga pikëpamja e praktikimit të fesë: d.m.th., nëse ka dallime në qëndrimet ndaj martesave ndërfitare mes të intervistuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare, mes atyre që praktikojnë ritet kryesore dhe ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Siç tregohet në Figurën 15, mbështetja e pakushtëzuar për një martesë të tillë të një anëtari të familjes (vëlla apo motër, djalë apo vajzë) bie gradualisht teksa rritet shpeshësia e praktikimit të fesë nga të anketuarit, nga mbështetja më e madhe (75.1%) nga të anketuarit që nuk praktikojnë asnjë rit fetar, tek gjysma (50.5%) e atyre që praktikojnë të gjitha ritet fetare. Shohim një trend të kundërt mbështetjeje për opsionin e dytë, “Do ta pranoja, por nuk do ta mbështesja/inkurajoja”, ku të anketuarit më fetarë priren të zgjedhin këtë opsion sesa ata që janë më pak apo aspak fetarë. Ata që praktikojnë të gjitha ritet fetare kanë përqindjen më të lartë të përgjigjes “do ta kundërshtoja në çdo rast”. Dallimet për opsionet e tjera janë brenda harkut prej tre për qind për të anketuarit sipas rregullsisë së praktikimit të riteve fetare.




**Figura 15. Mbështetja për martesat ndërjetare të anëtarëve të familjes sipas praktikimit të fesë nga të anketuarit (%; N = 1584)**



Arsimi është një tjetër karakteristikë që evidenton dallimet mes profileve të të anketuarve. Kështu, të anketuarit më të arsimuar kishin një përqindje më të lartë të përgjigjeve “Patjetër që po” për martesën ndërjetare të një anëtarit të familjes (Figura 16).

**Figura 16. Mbështetja për martesat ndërjetare të anëtarëve të familjes sipas nivelit arsimor (%; N = 1585)**




Të anketuarit që kanë diplomë universitare ose pasuniversitare (master apo gradë më të lartë) tregojnë një nivel më të lartë mbështetjeje të pakushtëzuar dhe piren më pak tek përgjigja “Do ta pranoja, por nuk do ta mbështesja/inkurajoja” sesa të intervistuarit e tjerë. Ata që nuk kanë arsim ose ata që kanë arsim deri atë fillor tregojnë një nivel



më të lartë kundërshtimi (do ta kundërshtoja në çdo rast ose do ta kundërshtoja nëse bashkëshorti/ja është besimtar/e praktikant/e) sesa kategoritë e tjera. Është interesante të evidentohet se të anketuarit me arsim të mesëm janë në mes të kategorive të tjera, ndonëse, në përgjithësi, janë më pranë të anketuarve që kanë diplomë universitare apo nivel më të lartë arsimit.

Mosha e të anketuarve është një tjetër variabël që evidenton dallime të konsiderueshme mes grupeve për përgjigjet ndaj pyetjes: “Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes suaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) të martohej me një person të një besimi tjetër?” Siç tregohet në Figurën 17, sa më i ri në moshë i anketuari aq më e madhe është mbështetja (“Patjetër që po”) për martesën ndër fetare. Si për kontrast, sa më i madh në moshë të jetë i intervistuari, aq më e lartë është përqindja e përgjigjeve “Do të pranoja por nuk do ta mbështesja/inkurajoja” dhe “Nuk jam i sigurt”.

**Figura 17. Përqindja e mbështetjes për martesat ndër fetare sipas grupmoshës (%; N = 1573)**



Nuk ka dallime të konsiderueshme në lidhje me këtë pyetje mes të intervistuarve sipas vendbanimit, gjinisë dhe statusit të punësimit (me përjashtim të të anketuarve të papunë që priren tek përgjigja “nuk jam i sigurt” dhe me më pak mbështetje për opsionin “patjetër që po” krahasuar me kategoritë e tjera), dhe variablat e tjera.

Gjetjet e studimit tregojnë se qëndrimet personale të shqiptarëve për të qenë të hapur dhe pranues të marrëdhënieve ndër fetare –martesa e vëllezërve dhe motrave apo bijve dhe bijave me njerëz të përkatësive të tjera fetare– ndryshojnë dukshëm mes brezave, mes njerëzve me nivel të ndryshëm arsimor dhe sipas nivelit të besimit fetar. Në përgjithësi, njerëzit fetarë, brezat e vjetër dhe njerëzit me nivel të ulët arsimor duket se janë më rezistentë ndaj marrëdhënieve të tilla. Është interesante të theksohet se gjinia, vendbanimi dhe gjendja ekonomike dhe financiare nuk janë tregues të nivelit të pranimit apo refuzimit të kësaj çështjeje.

Ky studim vazhdon në kapitujt e tjerë ku shqyrtohen qëndrimet dhe përvojat e shqiptarëve me një sërë çështjesh, me analizat që përfshijnë edhe dallimet mes opinioneve të të anketuarve sipas karakteristikave të tyre demografike.

## V. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri

### V.I. Nxitësit social-ekonomikë

Në këtë kapitull shqyrtohet ndikimi i nxitësve social-ekonomikë në krijimin e kushteve të favorshme për përhapjen e ideve radikale dhe ekstremiste. Faktorë të tillë si varfëria absolute dhe relative, fragmentarizimi social, përjashtimi social dhe diskriminimi, aktiviteti ekonomik i paligjshëm, mes të tjerash, dihet se shoqërohen me zhgënjimin me sistemin ekonomik dhe politik. Të rinj të papunë të izoluar që vijnë nga zona të pazhvilluara mund të bëhen pre i lehtë e propagandës dhe ideologjive ekstremiste që mbrojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të mundësuar ndryshimet e dëshirueshme së bashku me përfitimet personale.

Në fund të dekadës së parë të tranzicionit, Shqipëria karakterizohej si shoqëri periferike<sup>17</sup> dhe kjo, për fat të keq, mbetet e vërtetë për gjendjen e sotme social-ekonomike të saj. Shqipëria është tashmë një vend ku të ardhurat për frymë janë mbi mesataren<sup>18</sup>, por vazhdon të mbajë një pozicion periferik në raport me zonën fqinje të zhvilluar ekonomike të BE-së. Në vitin 2017, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i Shqipërisë për frymë u vlerësua në 4,543 USD<sup>19</sup>, e barasvlershme me 12.4 për qind të mesatares së BE-së për atë vit.<sup>20</sup> Periferitë social-ekonomike ekzistojnë edhe brenda vendit kur bëhet fjalë për zhvillimin gjeografikisht të pabarabartë, me pjesën e madhe të investimeve të përqendruara në qendër, rreth kryeqytetit, ndërkohë që zonat rurale dhe malore mbeten tejet të marginalizuara; kur flasim për shtresat e cenueshme sociale, të cilat përbëhen kryesisht nga njerëzit që migrojnë nga zonat rurale drejt periferive të qyteteve, nga të papunë që jetojnë me asistencë sociale, nga pensionistë të cilët nuk mund të përballojnë koston e trajtimit mjekësor etj.; kur bëhet fjalë për lulëzimin e ekonomisë informale dhe aktiviteteve të paligjshme ekonomike, të cilat vendosen zakonisht në periferitë e padukshme të ekonomisë formale. Të rinjtë, pjesa më vitale e popullsisë, zënë një përqindje tepër të madhe në statistikat e papunësisë. Në tremujorin e fundit të vitit 2017, papunësia e të rinjve vlerësohej të ishte 24.6 për qind, krahasuar me nivelin e përgjithshëm prej 13.4 për qind.<sup>21</sup>

Në këtë studim kombëtar janë marrë parasysh disa nxitës social-ekonomikë me qëllim që të kuptohet ndikimi i tyre në zona të ndryshme të vendit dhe kërcënimi që paraqesin ato për shoqërinë, sepse ofrojnë mundësitë për lindjen e grupeve radikale fetare dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Në Tabelën 2 jepen nxitësit e identifikuar dhe përshkrimi i tyre (hartuar nga Denoeux dhe Carter 2009).

17. Fuga, Artan (2004) Shoqëria periferike. Tirane: Ora.

18. <http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>

19. <https://countryeconomy.com/gdp/albania> (Aksesuar më 25 korrik 2018).

20. <https://tradingeconomics.com/european-union/gdp-per-capita> (Aksesuar më 25 korrik 2018).

21. <https://tradingeconomics.com/albania/youth-unemployment-rate>; <http://www.balkaneu.com/unemployment-in-albania-drops> (Aksesuar më 25 korrik 2018).




**Tabela 2. Nxitësit social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm**

<b>NXITËSI</b>	<b>PËRSHKRIMI</b>
<b>Perceptimet e përjashtimit social dhe marginalizimit</b>	Ky perceptim mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë. Kjo sjell si rezultat një ndjesi izolimi dhe dëshirë për të shkelur ligjet. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive.
<b>Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit</b>	Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm në radikalizim dhe rekrutim. Njerëzit mund të përfshihen në grupe të ekstremizmit të dhunshëm së bashku me miqtë ose si rezultat i ndikimit të afërmve, fqinjëve apo të ndonjë predikuesi karizmatik lokal.
<b>Diskriminimi shoqëror</b>	Diskriminimi i perceptuar apo i vërtetë ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja), në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, gjë që provokon radikalizimin.
<b>Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ</b>	Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm për të rinjtë duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor priren të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria. Në përgjithësi, ata nuk mund të marrin vendet punës që mendojnë se i meritojnë; ata e dinë që nepotizmi pengon mundësitë për punë. Meshkujve të rinj mund t'u mungojnë burimet ekonomike që nevojiten për të krijuar familje dhe në përgjithësi në shoqëritë tradicionale iu mohohet mundësia të thonë fjalën e tyre.
<b>Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike</b>	Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.
<b>Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike</b>	Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshetur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.

Burimi: Denooux dhe Carter (2009)<sup>22</sup>

22. Shih Guilain Denooux dhe Lynn Carter “Development Assistance and Counter Extremism: A Guide to Programming” (Asistenca për zhvillim dhe Kundër-Ekstremizmi: Guidë për hartimin e programeve) (Tetor 2009). Po ashtu, shihni edhe Guilain Denooux dhe Lynn Carter “Guide to the Drivers of Violent Extremism” (Guidë për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm) (Shkurt 2009).



**V.I.I. Përrjashtimi social dhe margjinalizimi**

*Ky perceptim mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë. Kjo sjell si rezultat një ndjesi izolimi dhe dëshirë për të shkelur ligjet. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive.*

Koncepti i përjashtimit social i referohet zhvendosjes së individëve jashtë hapësirës së jetës shoqërore, ekonomike dhe kulturore, sepse atyre u mohohet sistematikisht aksesit tek të drejtat, burimet dhe mundësitë. Individët dhe grupet e përjashtuara mund të jenë në disavantazh për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të burimeve materiale dhe prestigjit kulturor në shoqëri, ose mund të diskriminohen nga grupe të tjera që u bllokojnë aksesin tek burimet materiale dhe tek mundësia për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre. Koncepti i përjashtimit social është më i gjerë sesa koncepti i varfërisë, pasi përjashtimi social përfshin jo vetëm privimin ekonomik, por edhe nevojat e papërmbyshura sociale, kulturore dhe të tjera. Përveç të varfërve dhe të papunëve, grupet e tjera të përjashtuara sociale mund të jenë gratë, fëmijët, brezi i të moshuarve, pakicat etnike, racore, fetare dhe seksuale, emigrantët, personat me aftësi të kufizuara, të burgosurit, etj. Përjashtimi social bazohet edhe në perceptimet e njerëzve për pozitën e tyre relative në shoqëri në krahasim me të tjerët si dhe tek idetë e përcaktuara nga shoqëria për normalitetin, barazinë, drejtësinë dhe të drejtat. Njerëzit që janë të përjashtuar në aspektin social ndjehen të izoluar, të tjetërsuar, të inatosur dhe të parëndësishëm. Përgjigjet e tyre ndaj përjashtimit të perceptuar social mund të tronditen duke u zhvendosur nga gjendja e apatisë drejt përqafimit të ideve radikale dhe ekstremiste.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2016, 35 për qind e popullsisë në Shqipëri jeton në varfëri (me 2-5,5 dollarë në ditë).<sup>23</sup> Instituti i Statistikave dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 vlerësojnë se zonat më të varfra janë zonat rurale bregdetare dhe malore.<sup>24</sup> Një faktor i rëndësishëm i përjashtimit social në vend mbetet niveli i lartë i papunësisë, i cili prek më shumë tek të rinjtë. Gjatë shqyrtimit të perceptimeve për përjashtimin social, sondazhi ynë kombëtar u fokusua tek treguesit që lidhen me nivelin e integritit apo përjashtimin e të rinjve nga komunitetet e tyre. Supozimi është se ndryshimet strukturore të tre dekadave të fundit në punësim, urbanizim, migrim, përbërje familjare, ndër të tjerash, kanë çuar në nivele më të larta të individualizimit dhe përjashtimit të të rinjve nga lidhjet shoqërore.

Për të përcaktuar kontekstin e këtij nxitësi në Shqipëri, në këtë studim u mblodhën perceptimet e të intervistuarve të sondazhit dhe përvojat e tyre në lidhje me familjen, kontrollin shoqëror, strukturat dhe sjelljen e të rinjve në komunitetet e tyre vendore. Edhe pse vetëm me këtë informacion nuk mund të përcaktojmë dot shkallën dhe rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm, ky informacion na ndihmon të analizojmë seriozitetin e nxitësve të ndryshëm social-ekonomikë dhe problematikat që krijojnë ato

23. Banka Botërore (2007) "Migration and Mobility." (Migrimi dhe lëvizshmëria) fq. 59-60. Lutemi referojuni: <http://documents.worldbank.org/curated/en/445651508415857577/pdf/120539-replacement-PUBLIC.pdf> (Aksesuar në 25 korrik 2018).

24. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. "Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020." f. 10.




kur ndërthuren me nxitës të tjerë nga kjo kategori ose kategori të tjera, nxitës që mund të përdoren më tej nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm për të përhapur ideologjitë ekstremiste dhe për të ndërtuar bazën e mbështetësve rreth tyre.

Në studim të intervistuarit u pyetën sa dakord janë me pohimet e mëposhtme:

- Pohimi 1: Në komunitetin ku jetoj familja ka gjithnjë e me pak kontroll/ndikim tek të rinjtë.
- Pohimi 2: Sjellja e të rinjve ndikohet ndjeshëm nga opinioni i komunitetit të banorëve.
- Pohimi 3: Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumar, alkool, droga etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhuna, akte vandalizmi etj.).

Përgjigjet në këtë sondazh nxjerrin në pah se pjesa më e madhe e të anketuarve (56.7%) mendojnë se në komunitetin ku jetojnë familja ka gjithnjë e me pak kontroll/ndikim tek të rinjtë, por që gjithsesi sjellja e të rinjve ndikohet ndjeshëm nga opinioni i komunitetit të banorëve (53.4% mbështesin pohimin e dytë).

**Figura 18. Opinioni i të anketuarve për kontrollin apo ndikimin e familjes (N = 1,590), dhe për ndikimin e komunitetit (N = 1,585), tek sjellja e të rinjve (%)**



Ndonëse ndikimi i familjes tek të rinjtë është i kufizuar, lidhjet shoqërore që i mbajnë të bashkuara komunitetet vazhdojnë të ushtrojnë presionin e tyre tek brezat e rinj dhe kjo është një pasuri e madhe për politikat e koordinuara që synojnë individë me sjellje antisociale dhe të dhunshme. Pjesëmarrësit e diskutimeve që u bënë në fokus grupet me të rinjtë (DFG2), tek ata me arsim të ulët (DFG3) dhe ata që praktikojnë fenë (DFG4) argumentuan se ka disa arsye pse familjet tani ushtrojnë më pak kontroll mbi të rinjtë. Disa nga këto arsye janë: prindërit në marrëdhënie pune që kalojnë më shumë kohë se më parë jashtë shtëpisë për të siguruar jetesën për familjet e tyre; jeta e të rinjve sot është më dinamike, më e ekspozuar ndaj ndikimeve sociale jashtë familjes, përfshirë grupin e bashkëmoshatarëve dhe mediat sociale; dhe studentët që jetojnë larg familjeve të tyre për periudha të gjata kohore. Nga ana tjetër, disa pjesëmarrës të rinj në DFG2 e

lidhën mendimin e komunitetit lokal me paragjykimet dhe stereotipet, veçanërisht ato të brezave më të moshuar (mbi 40 vjeç), të cilët e kanë të vështirë të ndjekin ritmin e ndryshimeve në kulturë dhe në vlera.

Perceptimi se roli i familjes është dobësuar është më i konsoliduar tek të anketuarit që nuk janë edhe aq fetarë (60.1%) sesa tek ata që praktikojnë ritet fetare ose rregullisht (53.3%) ose në të shumtën e rasteve (54.3%). Ky dallim mund të jetë pasqyrim i stilit më tradicional dhe familjar të jetesës së personave fetarë. Sidoqoftë, personat fetarë janë të vetëdijshëm për dobësimin e aftësive të familjes për të kontrolluar jetët e të rinjve. Një pjesëmarrës mysliman në DFG4 theksoi se: “Nga këndvështrimi i fesë, familja nuk mund t’i mbajë nën kontroll të rinjtë, por mund të kuptojë ndryshimet në sjelljen e fëmijës”, gjë që flet për një marrëdhënie më të ndërlikuar mes prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Ka një lidhje pozitive mes moshës dhe dakordësisë me Pohimin 1 se familjet e sotme kanë gjithnjë e më pak kontroll tek të rinjtë, gjë që pasqyron ndryshimin mes brezave për qëndrimet ndaj familjes. Një pjesëmarrës i ri në DFG2 tha se “Në ditët e sotme roli i familjes është më pozitiv dhe demokratik sesa gjatë periudhës së komunizmit, sepse sot fëmijët kanë më shumë mundësi për të zgjedhur, autoriteti i babait mungon për shkak të emigrimit për punë dhe marrëdhëniet mes prindërve janë më të barabarta se më parë.”

Marrëdhënia mes nivelit arsimor dhe pranimit të pohimit të parë është negative, duke qenë se ata që kanë nivel të ulët arsimit kanë një përqindje më të lartë mbështetjeje për këtë pohim sesa mesatarja kombëtare (56.8%) dhe ata që kanë diplomë pasuniversitare duket se janë më të ndarë (41.9% janë dakord dhe 39.5% nuk janë dakord).


Me Pohimin 2 bien më shumë dakord të anketuarit nga zonat rurale sesa ata nga zonat urbane (58.2% dhe 50%, përkatësisht), ndofta duke reflektuar faktin se fshatrat janë komunitete me lidhje të ngushta farefisnore, gjë që është më shumë e pranishme sesa në qytetet e vogla apo lagjet e qyteteve të mëdha. Ka një zhvendosje tejet të madhe në perceptimet mes të anketuarve që nuk kanë përfunduar arsimin 8-9 vjeçar dhe atyre që e kanë mbaruar këtë arsim. Mes atyre që kanë përfunduar arsimin e mesëm, përqindja e dakordësisë përafrohet me mesataren kombëtare, ndërsa opinionet e të anketuarve me diplomë pasuniversitare janë më të larmishme (38.4% nuk janë dakord, 44.2% janë dakord dhe 11.6% mendojnë se pohimi nuk ka lidhje).

Për sa i përket Pohimit 3, pjesa më e madhe e të anketuarve tregojnë se janë të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe veset me të cilat ndeshen të rinjtë në komunitetet e tyre. Shumica dërrmuese (80.8%) e të anketuarve besojnë se të rinjtë bien pre e kumarit, alkoolit dhe drogave, ose kanë sjellje antisociale dhe kryejnë akte vandalizmi.





**Figura 19. Mbështetja për pohimin se të rinjtë kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogave dhe sjelljeve të rrezikshme (%; N = 1,592)**



Niveli i dakordësisë me këtë pohim është i qëndrueshëm si tek fetarët ashtu edhe të anketuarit më pak fetarë, mes grupmohave të ndryshme, të intervistuarve nga zonat urbane dhe rurale, mes meshkujve dhe femrave dhe ata që kanë përfunduar arsimin bazë apo studimet pasuniversitare, si dhe mes atyre që janë të punësuar, të papunë apo studentë. Të anketuarit në 11 bashkitë e mëposhtme bien dakord me Pohimin 3 në përqindje më të lartë se mesatarja kombëtare (ku 80.8% janë dakord ose plotësisht dakord): Elbasan (99%), Lezhë (97%), Kamëz dhe Kukës (secila 93%), Kurbin (88.5%), Pogradec dhe Korçë (86% secila), Krujë (85%), Durrës (84%), Fier (83%), dhe Tiranë (82%). Përqindjet mbi mesataren kombëtare raportohen edhe në bashki me kampion prej 10-20 të anketuarish, si Cërrik, Mirditë, Belsh, Mat dhe Gramsh (100% secila), Librazhd (94%), Bilisht, Peqin, Prrenjës dhe Mallakastër (93% secila), Bulqizë (88%) dhe Vorë (87%).

*Gjetjet për nxitësin e përjashtimit social tregojnë se ekziston një perceptim i përhapur për dobësimin e lidhjeve familjare në Shqipëri, ndonëse opinioni i komunitetit/lagjes është ende i rëndësishëm në jetën e individëve. Aksesi në arsim dhe përhapja e urbanizimit shoqërohen me botëkuptim më të individualizuar të jetës, të cilat, kur ndërthuren me nxitësit e tjerë, mund të bëjnë që të rinjtë dhe të papunët të jenë të rrezikuar nga ekstremizmi i dhunshëm. Të anketuarit fetarë tregojnë më shumë përkrahje ndaj vlerave familjare, por, nga ana tjetër, një dukuri shqetësuese është edhe përhapja e veseve dhe sjelljes anti-sociale mes të rinjve në periferitë urbane dhe komunitetet e pazhvilluara. Edhe pse feja mund të ketë një ndikim frenues në këtë drejtim, sjellja e pahijshme sociale e të rinjve mund të kanalizohet drejt dhunës në rastet e indoktrinimit nga grupet ekstremiste.*

### V.I.2. Rrjetet shoqërore dhe dinamikat brenda grupeve

*Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm i rekrutimit dhe radikalizimit. Individët mund të përfshihen në grupe ekstremiste të dhunshme përmes shokëve apo si rezultat i ndikimit nga të afërm, fqinj, apo të ndonjë predikuesi karizmatik.*





Ekziston një mirëkuptim i gjerë mes studiuesve për sa i përket rëndësisë së familjes dhe lidhjeve shoqërore në radikalizimin e të rinjve dhe prezantimin e tyre me ekstremizmin e dhunshëm. Idetë radikale përçohen nga rrjetet e të afërmeve me lidhje gjaku, farefisnia dhe shokët në grupe të vogla shoqërore. Marc Sageman, ekspert për terrorizmin, thekson se ndërveprimi mes njerëzve me të njëjtin mendim ka shumë rëndësi për radikalizimin; kështu rrethi shoqëror dhe farefisi janë vendimtarë në këtë proces.<sup>25</sup> Raportet e medias në Shqipëri kanë konfirmuar ekzistencën e lidhjeve familjare dhe shoqërore mes besimtarëve fetarë ekstremistë që janë përfshirë në aktivitete të dhunshme në Siri dhe Irak. Këto lidhje ekzistojnë para rekrutimit dhe u riformuan gjatë procesit të radikalizimit. Për shembull, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) ka konstatuar se nga tre fshatra pranë Pogradecit u bashkuan me luftëtarët xhihadistë në Siri plot 24 vetë, përfshirë këtu edhe gratë dhe fëmijët e tyre. Disa meshkuj të rinj nga ky grup janë të afërm ose shokë, të cilët u bashkuan rrjetit radikal të ngritur rreth një xhamie në një prej këtyre fshatrave.<sup>26</sup> Një tjetër kanal radikalizimi dhe rekrutimi për grupet ekstremiste janë mediat sociale në internet.<sup>27</sup>

Ky studim mbledh perceptimet e të intervistuarve të sondazhit për rrugën që ndiqet për t'u bërë besimtar fetar me qëllim që të kuptohet më mirë konteksti lokal. Edhe pse vetëm me këtë informacion nuk mund të përcaktojmë dot radikalizimin apo ekstremizmin fetar, studimi shqyrton më tej nëse të anketuarit konfirmojnë praninë e individëve/grupeve që nxisin ekstremizmin fetar në zonën ku banojnë. Kështu, për të analizuar këtë nxitës shërbejnë katër pohimet e mëposhtme.

- |           |   |
|-----------|---|
| Pohimi 1: | Familja ka qenë shtysa kryesore për praktikimin e fesë nga ana e shumicës së besimtarëve që njoh. |
| Pohimi 2: | Shumica e njerëzve që njoh janë bërë besimtarë praktikantë për shkak të rrethit të tyre shoqëror. |
| Pohimi 3: | Në zonën ku banoj veprojnë individë/grupe që nxisin ekstremizmin e krishterë.                     |
| Pohimi 4: | Në zonën ku banoj veprojnë individë/grupe që nxisin ekstremizmin islamik.                         |

Shumica e të intervistuarve (53.5%) kanë perceptimin se familja është shtysa kryesore për transmetimin e besimeve fetare. Feja është pjesë e “realitetit të mirëqenë” kulturor ku njerëzit socializohen, së bashku me gjuhën dhe përkatësinë etnike. Edhe pse ndryshimi i besimit fetar, si p.sh., të bëhesh ateist apo të konvertohesh në një fe tjetër, është gjithmonë një mundësi, tendenca në përgjithësi është që individët krijojnë lidhje apo praktikojnë fenë që u transmetohet atyre nga familja. Nga të anketuarit e këtij studimi 93.5 për qind konfirmuan të njëjtën përkatësi fetare me atë të prindërve të tyre

25. Sageman, M. (2004) *Understanding Terror Network*. Philadelphia: University of Philadelphia Press.

26. Bogdani, A. (2016) Fshatrat e xhihadit: Si u rekrutuan të rinjtë për të luftuar në Siri. Reporter.al, gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/fshatrat-e-xhihadit-si-u-rekrutuan-te-rinjte-per-te-luftuar-ne-siri/> (aksesuar më 26 korrik, 2018).


27. Qafmolla, R. et al. (2017) Xhihadistët nga Ballkani ‘të lirë’ në internet. Reporter.al, gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/xhihadistet-nga-ballkani-te-lire-ne-internet/> (aksesuar më 26 korrik, 2018); Fazliu, H. (2017) Xhihadistët e burgosur në Maqedoni përpigën të rekrutojnë online, Reporter.al, gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/xhihadistet-e-burgosur-ne-maqedoni-perpigen-te-rekrutojne-online/> (aksesuar më 26 korrik, 2018).



(të dy prindërit, 80.2%, një prind, 13.3%).

Të intervistuarit duket se janë të ndarë për sa i përket pohimit se “Shumica e njerëzve që njoh janë bërë besimtarë praktikantë për shkak të rrethit të tyre shoqëror,” ku 41.7 për qind janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim dhe 43.6 për qind nuk janë dakord ose aspak dakord me të, ndërkohë që 14.7 për qind ose nuk e dinë ose e konsiderojnë si pa lidhje këtë pohim (shih Figurën 20). Në përgjithësi, familja është mbi rrethin shoqëror si shtysa apo nxitja kryesore që besimtarët fetarë të praktikojnë fenë.

**Figura 20. Opinioni i të intervistuarve për familjen (N = 1,590) dhe rrethin shoqëror (N = 1,587) si nxitës kryesorë për praktikimin e fesë (%)**



Në kampionin tonë kombëtar, ata që praktikojnë rregullisht rregullat dhe ritet fetare kanë tendencë të jenë më shumë dakord me ndikimin fetar të familjes (58.4%). Të anketuarit e rinj, nga mosha 18 deri në 24 vjeç, priren të jenë më pak dakord (44.7%) dhe kjo është në të njëjtën linjë me qëndrimet më të hapura që mund të kenë brezat e rinj ndaj përkatësisë fetare, ndërsa në grupmoshat 55-64 vjeç e lart përqindja e dakordësisë është shumë më e lartë se ajo kombëtare (66.7% dhe 69.8% respektivisht), duke reflektuar kështu një pikëpamje më tradicionale. Me rritjen e nivelit të arsimit nga 8 ose 9-vjeçar në diplomë universitare evidentohet më pak dakordësi me pohimin, ndonëse mbetet opsioni i shumicës në secilën prej këtyre nënkategorive.

Për sa i përket pohimit të dytë (rrethi shoqëror si shtysa kryesore), të anketuarit që praktikojnë ritet kryesore apo të gjitha ritet fetare të fesë së tyre priren më shumë të mos jenë dakord me këtë pohim (47.9% dhe 47.3%, përkatësisht) krahasuar me ata që janë më laikë (39.8%), ku niveli i dakordësisë është në të njëjtën përqindje (41% deri në 43%). Grupmoshat 45 vjeç e lart në përgjithësi e mbështesin ndikimin e rrethit shoqëror për besimin fetar të individëve, ndërsa grupmoshat 18-44 vjeç priren më shumë të mos jenë sesa të jenë dakord me këtë pohim. Pjesa më e madhe e të papunëve priren të mos jenë dakord me rolin e rrethit shoqëror në besimin fetar të individëve. Dallimet në opinionet brenda kategorive të tjera demografike janë në përqindje më të vogla.

Intervistat me fokus grupet mbështesin gjetjet e sondazhit se familja është institucioni më i rëndësishëm i socializimit dhe transmetimit të vlerave dhe besimeve. Megjithatë, në vitet e para të rinisë, ndikimi i rrethit shoqëror që i prezanton ata me besimin dhe ritet fetare është më i rëndësishëm. Informatorët e intervistuar evidentuan raste ku

adoleshentë dhe të rinj kanë zgjedhur të praktikojnë rite fetare në kundërshtim me dëshirat e prindërve të tyre ateistë ose kanë zgjedhur të besojnë në një fe të ndryshme nga ajo e prindërve të tyre. Të rinjtë tërhiqen edhe nga aktivitetet shoqërore dhe kulturore të organizuara nga organizatat fetare. Një informator e arsimuar (DFG1) zgjodhi të ndiqte një kishë ungjillore, sepse asaj i pëlqenin “veprimtaritë artistike dhe kulturore, ku çështjet fetare ngrihen në një formë të këndshme.” Organizatat fetare organizojnë aktivitete sociale dhe kulturore për të rinjtë dhe i paraqesin ato si aktivitete për formimin e moralit që i mbajnë të rinjtë larg tundimeve. Duke qenë se prindërit i kanë humbur disa prej aftësive për të kontrolluar jetën e përditshme të fëmijëve të tyre, ata ndonjëherë e vlerësojnë këtë aspekt të aktiviteteve fetare. Një informator mysliman (DFG3) pranoi se fillimisht shprehu kundërshtim kur mësoi se vajza e tij po frekuentonte një kishë me shoqet e saj. Por më vonë arsyetoi se për të ishte më mirë që vajza të kalonte kohë në kishë sesa të frekuentonte lokalet e natës, kështu që dha miratimin e tij.


Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë dijeni për ekzistencën e ekstremizmit fetar në zonën e tyre. Të intervistuarit u pyetën nëse dhe sa ishin dakord me pohimet 3 dhe 4 më sipër. Më konkretisht:

***Në zonën ku banoj veprojnë individë/grupe që nxisin ekstremizmin e krishterë.***

***Në zonën ku banoj veprojnë individë/grupe që nxisin ekstremizmin islamik***

Shifrat janë të njëjta për të dy llojet e ekstremizmit: në nivel kombëtar 10.8 për qind janë dakord ose plotësisht dakord se në zonën ku banojnë veprojnë individë apo grupe që nxisin ekstremizmin e krishterë, ndërsa 12.3 për qind e pranojnë këtë gjë për grupet islamike. Nga ana tjetër, 69.1 për qind nuk janë dakord ose aspak dakord se në zonën e tyre veprojnë grupe ekstremiste të krishtera, ndërsa 67.3 për qind nuk janë të mendimit se në zonën e tyre veprojnë grupe ekstremiste islamike.

**Figura 21. Përqindja e të anketuarve që pretendojnë se në zonën e tyre veprojnë grupe apo individë që nxisin ekstremizmin e krishterë (N = 1,587) apo islamik (N = 1,590)**



Një numër më i madh të intervistuarish që praktikojnë ritet fetare nuk janë dakord me Pohimin 3 (71.5–73%) krahasuar me ata që nuk praktikojnë asnjë rit (66%). Ky trend vihet re edhe për ekstremizmin islamik me një përqindje mosdakordësie që është pothuajse e njëjtë (12-13%). Tendenca e përgjithshme është që të anketuarit që kanë më shumë arsim të shfaqin një nivel më të lartë dakordësie, përqindje më të lartë të përgjigjes “nuk e di” dhe përqindje më të ulët të mosdakordësisë me pohimet për individë apo grupe ekstremiste të krishtera ose islamike. Një përqindje e lartë e banorëve të zonave urbane (19.6% dhe 19.3%) dhe e të anketuarve femra (20.8% dhe 20.7%) zgjedhën opsionin “nuk e di” për të dy pohimet për ekstremizmin fetar.

Perceptimet për ekstremizmin e krishterë janë në nivel më të lartë se mesatarja kombëtare për të anketuarit në këto bashki: Krujë (53%), Elbasan (39.5%), Shijak (35%), Durrës (29%), Kavajë, Maliq dhe Vlorë (13% secila), dhe Tiranë (11%). Në një numër të vogël bashkish me madhësi të vogël kampioni prej 20 të anketuarish u raportua një nivel më i lartë i ekstremizmit të krishterë se mesatarja e raportuar në rang kombëtar: Vorë (20%), Mallakastër (14%), Bilisht (14%) dhe Mat (13%). Ndërkohë, perceptimet për ekstremizmin islamik u raportua në mënyrë të konsiderueshme nga të anketuarit në këto bashki: Krujë (56%), Elbasan (48%), Shijak (35%), Durrës (25%), Kamzë (17%), Korçë (16%) dhe Tiranë (15%). Përqindje të larta për praninë e ekstremizmit islamik u evidentuan në bashki më të vogla (me madhësi kampioni prej 10-19 të intervistuarish), si Bilishti (21%), Vora (20%), Saranda (20%), Rrogozhina (15%) dhe Gramshi (15%).

Disa pjesëmarrës të fokus grupeve priren ta lidhin radikalizmin ose ekstremizmin fetar me praktikimin rigoroz apo me ndryshimet në sjelljen dhe pamjen dhe jo domosdoshmërisht me dhunën. Një fenomen shqetësues për ta është izolimi relativ i besimtarëve radikalë nga komuniteti dhe qëndrimet e tyre të ngurtësuar ndaj ideve që janë të ndryshme nga besimet e tyre ose që i kundërshtojnë ato. Siç tha një i ri i intervistuar (DFG2), “Unë nuk mendoj se këta njerëz janë ekstremistë, por nuk është normale që të jenë aq mendjembyllur ndaj pikëpamjeve të të tjerëve dhe aq kokëfortë në mbrojtjen e ideve të tua.” Një tjetër i intervistuar (DFG4), mysliman që praktikon ritet, tha se “Ekstremizmi mund të shfaqet kur një individ beson emocionalisht, pa përdorur logjikën. Feja është si ilaçi që merr në farmaci. Çdo personi duhet t’i jepet ilaçi që ai apo ajo ka nevojë.”

*Gjetjet për nxitësin e rrethit shoqëror konfirmojnë se familja mbetet shtysa kryesore për transmetimin e besimeve dhe pikëpamjeve fetare tek të rinjtë. Shumica e të anketuarve në kampionin tonë i japin më pak meritë rrethit shoqëror për përhapjen e pikëpamjeve fetare, por nga diskutimet në fokus grupe me pjesëmarrës të rinj në moshë dhe besimtarë fetarë u bë e qartë se bashkëmohatarët dhe shokët luajnë një rol më të madh në këtë drejtim. Ndonëse pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk mendojnë se në zonën e tyre veprojnë grupe fetare, në disa bashki si Krujë, Elbasan, Shijak, Durrës, Bilisht, Kamzë, Korçë, Tiranë dhe Vorë ka mendime të qarta për ekzistencën e grupeve ekstremiste fetare. Sidoqoftë, numri i përgjigjeve ndaj dy pohimeve të fundit dhe krahasimi i tyre me përgjigjet e pohimeve të tjera të kontrollit (shih më poshtë), tregojnë se nevojiten më shumë hulumtime për mënyrën se si e konceptojnë ekstremizmin fetar njerëzit me prejardhje të ndryshme social-ekonomike, të grupmohave të ndryshme dhe me nivel të ndryshëm arsimor.*

### V.1.3. Diskriminimi shoqëror

*Diskriminimi i perceptuar apo i vërtetë ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja), në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës*



*për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, duke provokuar radikalizimin.*

Në Shqipëri për shekuj me radhë ka ekzistuar një atmosferë e përgjithshme e tolerancës fetare dhe kjo konfirmohet edhe nga studimet e fundit, si Toleranca fetare në Shqipëri (IDM 2018). Siç raportohet në seksionet e mësipërme, më pak se një për qind e të anketuarve në këtë studim mendojnë se ka një nivel të lartë të urrejtjes fetare në Shqipëri. IDM (2018) konstatoi se 92.3 për qind e të anketuarve mendojnë se toleranca fetare është vlerë themelore në Shqipëri. Për më tepër, shumica e të anketuarve nuk pranuan se ata, anëtarët e familjeve të tyre apo dikush tjetër në komunitetet e tyre lokale të jenë diskriminuar për shkak të besimit fetar.<sup>28</sup> Raporti Ndërkombëtar për Lirinë Fetare për vitin 2017, i botuar nga Departamenti i Shtetit i ShBA-ve, thekson se në Shqipëri ekziston liria e fesë dhe konstaton se nuk ka diskriminim për asnjë komunitet fetar.<sup>29</sup>

Për të analizuar më tej perceptimet për diskriminimin, iu paraqitëm pjesëmarrësve të sondazhit kombëtar pohimet e mëposhtme duke i pyetur nëse dhe sa janë dakord me to:

Pohimi 1:	Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.
Pohimi 2:	Mjekra (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.
Pohimi 3:	Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.

Thelbi dhe rëndësia që ka ky nxitës për të favorizuar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm u vlerësuan në bazë të përgjigjeve pozitive për dy pohimet e para dhe përgjigjes negative për pohimin e tretë. Ndërkohë që pohimi i parë dhe i tretë ofrojnë një perspektivë për diskriminimin real apo të perceptuar, pohimi i dytë (me përgjigjet pozitive për të), lidhet më shumë me diskriminimin dhe paragjykimet në shoqëri.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (68.9%) nuk mendojnë se besimet fetare janë shkak i diskriminimit shoqëror në Shqipëri. Vetëm 12.8 për qind janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin e parë, ndërsa 18.3 për qind mendojnë se ky pohim është pa lidhje ose nuk kanë një përgjigje për të. Ndër të anketuarit që praktikojnë rregullisht ritet fetare ekziston një nivel më i lartë i dakordësisë me këtë pohim (17.8%), por, nga ana tjetër, përqindja e të intervistuarve të kësaj kategorie që nuk janë dakord me pohimin është 70.7 për qind, pak më e lartë se mesatarja kombëtare. Të anketuarit që nuk praktikojnë ritet fetare priren të mos jenë dakord me pohimin (9.4%). Një numër më i madh të anketuarish priren më pak të besojnë se diskriminimi shoqëror bëhet për shkak të fesë dhe përqindja e atyre që mendojnë se ky pohim është pa lidhje rritet


28. PNUD & Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018) "Toleranca fetare në Shqipëri." Tiranë, f. 45-51. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf>

29. "Albania 2017 International Religious Freedom Report." Lutemi referojuni: <https://www.state.gov/documents/organization/281118.pdf> (aksesuar më 27 korrik 2018).



me nivelin e arsimit. Një numër më i madh i të intervistuarve (20%) që nuk kanë përfunduar arsimin tetë ose nëntëvjeçar ose nuk kanë fare arsim janë dakord me këtë pohim. Është interesante që zonat me një përqindje më të lartë se mesatarja kombëtare janë zonat e pazhvilluara (Bilishti, Bulqiza, Dibra, Kruja, Gramshi, Hasi, Kukësi, Librazhdi, Mallakastër, Patosi, Përrenjasi, Roskoveci, Rrogozhina, Tepelena dhe Tropoja), por edhe disa bashki që janë afër ose pjesë e zonave të zhvilluara si Elbasani, Fieri, Kamza, Pogradeci dhe Shijaku.

**Figura 22. Përqindja e të anketuarve që besojnë se përfitojnë më pak nga mundësitë e zhvillimit social-ekonomik për shkak të përkatësisë fetare (N= 1,593)**




Shenjat e dukshme të besimit fetar, si shamia e kokës dhe burka që veshin femrat dhe mjekrat që mbajnë meshkujt, janë çështje debatesh të nxehta në sferën publike. Personat që nuk janë shumë fetarë mund t'i lidhin shamitë e kokës dhe mjekrën me fundamentalizmin dhe ekstremizmin fetar. Në këtë studim kjo hipotezë u testua nëpërmjet kampionit përfaqësues kombëtar. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve (55.9%) nuk mendojnë se ka ndonjë lidhje mes burrave që mbajnë mjekra dhe grave që mbajnë shami nga njëra anë dhe ekstremizmit fetar nga ana tjetër. Por është edhe një pakicë e konsiderueshme e të anketuarve (30.5%) që janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim. Me sa duket, shoqëria shqiptare nuk është ende e imunizuar ndaj ideve të gabuara në lidhje me fenë. Për më tepër, “shumica e shqiptarëve bëjnë një jetë shekullore. Ata kanë pak informacion apo njohuri për fenë dhe kundërshtojnë idenë se pikëpamjet fetare duhet të formësojnë apo të kushtëzojnë mënyrën e tyre të jetesës.”<sup>30</sup>

30. Shih “Toleranca fetare në Shqipëri” IDM 2018, f. 7. Burimi: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf>



**Figura 23. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se mjekra, shamia dhe burka janë shenjë e ekstremizmit fetar (N = 1,592)**



Siç pritej, të anketuarit që praktikojnë ritet fetare janë më të familjarizuar me zakonet fetare (përfshirë këtu edhe kodin e veshjes) dhe më të prirur të mos jenë dakord (63.2%) me Pohimin 2 sesa ata që nuk i praktikojnë fare ritet fetare (51.4%). Lidhja e shamive dhe mjekrave me ekstremizmin fetar është më e madhe në zonat urbane sesa në zonat rurale (respektivisht 36.1% dhe 22.7%) si dhe më e madhe mes të punësuarve (34%) dhe të vetëpunësuarve (34.5%) në krahasim me ata të intervistuar që janë të papunë (23.2%). Kur shqyrtojmë përgjigjet nga prizmi i nivelit arsimor të të anketuarve, ka një ndryshim të konsiderueshëm në përqindje nga nënkategoria e atyre që nuk kanë mbaruar ciklin bazë tetë ose nëntëvjeçar tek ata që e kanë përfunduar këtë nivel arsimor. Në nënkategorinë e parë, përqindjet e “jam dakord” ose “nuk jam dakord” janë më të ulëta dhe më të larta përkatësisht, në krahasim me të anketuarit e niveleve të tjera arsimore, me 11.9 për qind dhe 69.5 për qind. Në nënkategorinë e dytë këto përqindje janë përkatësisht 26.4 për qind dhe 55.3 për qind, ndërsa përqindjet e përgjigjeve “s’ka lidhje” dhe “nuk e di” janë pothuajse të njëjta si në nën-kategorinë e parë, duke nënkuptuar se kemi një numër më të madh të anketuarish në nënkategorinë e dytë që e lidhin shaminë e kokës dhe mbajtjen e mjekrës me ekstremizmin fetar. Tendencia mes atyre me nivel më të lartë arsimimi është për dakordësi me pohimin. Kjo është e çuditshme duke pasur parasysh se presim që niveli më i lartë arsimor të ketë korrelacion negativ me nivelin e paragjyqimit ndaj personave me pamje të jashtme fetare. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë se, duke qenë se shamitë e kokës dhe mjekra janë të lidhura me mënyrën e jetesës të prapambetur, rurale dhe tradicionale, njerëzit e arsimuar priren t’i shohin ato si devijime nga normaliteti aktual, ndoshta duke bërë që disa t’i perceptojnë gratë që mbajnë shami koke dhe burra që mbajnë mjekër si ekstremistë fetarë. Disa pjesëmarrës në DFG2 me të rinj mendonin se mbajtja e mjekrës, burkës, shamive ose pantallonat deri te kërciri i këmbës për meshkujt janë të gjitha shenja të ekstremizmit, ndërsa të tjerë nuk janë dakord me këtë mendim.


Për sa i përket pohimit të tretë të kontrollit, supozohet se nëse ndaj komuniteti të caktuar fetar ndiqen politika diskriminuese, ky komunitet do të jetë më pak i përfaqësuar në politikë dhe tek institucionet publike. Pavarësisht nëse në realitet ekziston një politikë e tillë diskriminuese, nga debati i grupeve radikale fetare



pretendohet se rendi ekzistues social dhe politik është i njëanshëm ndaj bashkësisë së tyre fetare. Individë ose grupe ekstremiste fetare mbrojnë përdorimin e mjeteve të dhunshme për të përmbysur rendin ekzistues, sepse sipas tyre ky rend nuk i siguron përfaqësimin e duhur komunitetit të tyre fetar.

Përgjigjet për pohimin “Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore” janë të ndara, pa shumicë të qartë për opsionet “jam dakord” ose “nuk jam dakord”, përkatësisht me 30 për qind dhe 37.7 për qind, ndërsa 24.7 për qind dhanë përgjigjen “nuk e di” dhe 7.6 për qind mendonin se pohimi “s’ka lidhje”.

**Figura 24. Opinioni nëse ka një nivel të mirë të përfaqësimit fetar në politikë dhe institucionet shtetërore (%; N = 1,587)**



Nuk u vunë re dallime të konsiderueshme mes kategorive të ndryshme demografike, përveç atyre me nivele të ndryshme të praktikimit të riteve fetare. Pjesa më e madhe e të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare priren të jenë dakord me pohimin (41.9% janë dakord; 38.3% nuk janë dakord), ndërsa shumica e atyre që praktikojnë ritet kryesore dhe atyre që nuk praktikojnë asnjë rit nuk janë dakord me këtë pohim (44.8% dhe 33.1%, përkatësisht), d.m.th., ata mendojnë se grupi i tyre fetar nuk përfaqësohet sa ç’duhet në politikë dhe institucione shtetërore. Megjithatë, tek të tre nënkategoritë përqindjet e “nuk e di” dhe “s’ka lidhje” janë të konsiderueshme dhe janë edhe më të larta tek nënkategoritë më pak fetare. Është më se e qartë se për të anketuarit jo dhe aq fetarë përfaqësimi i duhur politik i komuniteteve fetare nuk është problem për të cilin të kenë menduar më parë. Në intervistat në fokus grupet me besimtarë myslimanë (DFG4), këta të fundit nuk shprehën asnjë shqetësim për sa i përket përfaqësimit të myslimanëve në politikë dhe institucione shtetërore.

*Në përgjithësi, ky studim konfirmon se toleranca fetare është e vërtetë në Shqipëri dhe vlerë themelore e shoqërisë shqiptare. Pjesa më e madhe e të intervistuarve mendojnë se përkatësia fetare nuk përbën bazë për diskriminimin në shoqëri. Megjithatë, duket se të anketuarit janë të ndarë për sa i përket pohimit “Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore”, ku të anketuarit që janë më të afërt me identitetet fetare duket se priren të jenë dakord me këtë pohim. Në diskutimet në*



*fokus grupe me besimtarë myslimanë nuk u raportua asnjë pakënaqësi me përfaqësimin e tyre në institucione shtetërore dhe në politikë. Një pjesë e konsiderueshme e kampionit, më shumë se 30 për qind e të intervistuarve, e perceptojnë shprehjen e besimit islam nëpërmjet pamjes së jashtme, si mbulimi dhe shamia e kohës për gratë dhe mbajtja e mjekrës për burrat, si shenja të ekstremizmit fetar. Brenda kësaj pakice, personat e arsimuar dhe njerëzit që jetojnë në zonat urbane kanë më shumë gjasa që të vendosin lidhje mes pamjes së jashtme dhe botëkuptimeve ekstremiste.*

#### **V.I.4. Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ**

*Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm për të rinjtë duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor priren të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria. Në përgjithësi, ata nuk mund të marrin vendet punës që mendojnë se i meritojnë; ata e dinë që nepotizmi pengon mundësitë për punë. Meshkujve të rinj mund t'u mungojnë burimet ekonomike që nevojiten për të krijuar familje dhe në përgjithësi në shoqëritë tradicionale iu mohohet mundësia të thonë fjalën e tyre.*

Pavarësisht përmirësimeve relative në vitet e fundit, të rinjtë në Shqipëri, përfshirë ata me diplomë universitare, vazhdojnë të përballen me shumë vështirësi dhe privime, duke bërë që të zhgënjehen në pritshmëritë që kanë. Një studim i INSTAT-it dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) i botuar në vitin 2015 dhe që bazohet tek të dhënat e Censurit kombëtar të 2011 dhe tek sondazhet e kryera në vitet e mëvonshme merr në shqyrtim aspektet e ndryshme të jetës së njerëzve të moshës 15-29 vjeç. Sipas nivelit të konsumit të të mirave materiale, 15 për qind e këtij grupi konsiderohet të jenë të varfër. Situata në lidhje me arsimin është përmirësuar shumë në Shqipëri, ku kemi më shumë të diplomuar nga universiteti se më parë: për grupmoshën 25-29 vjeç në vitin 2011 kishte 23.5 për qind të diplomuar, një rritje mjaft e madhe krahasuar me 7.5 për qind që ishte në vitin 2001. Papunësia afatgjate (mbi 12 muaj) në vitin 2011 ishte 63.1 për qind tek të rinjtë dhe 53.9 për qind tek të diplomuarit universitarë. Pavarësisht rritjes së nivelit arsimor, të rinjtë zënë një përqindje të madhe tek shifrat e papunësisë në krahasim me popullsinë e përgjithshme: në periudhën 2011-2014 raporti i punësimit: popullsia ra nga 68.2 për qind në 62.7 për qind, por numri i të rinjve ra nga 42.8 për qind në 28.2 për qind. Shumica e të rinjve janë të punësuar në bujqësi dhe vlerësohet se 33.5 për qind e të diplomuarve të rinj janë të mbikualifikuar për punën që bëjnë. Këto shifra nxjerrin në pah mosrakovimin mes sistemit arsimor dhe ekonomisë në vend, përfshirë edhe mundësitë social-ekonomike që ofrohen aty.<sup>31</sup>

Njerëzit e rinj dhe të mirë-arsimuar mund të ndihen të zhgënjyer nëse nuk gjejnë punë që përshtatet me kualifikimet e tyre. Zhgënjimi mund të çojë në shprehje të ankesave ndaj sistemit social-ekonomik dhe politik dhe drejt radikalizimit. Në këtë studim u shqyrtua roli radikalizues dhe potenciali i zhgënjimit tek të rinjtë duke analizuar perceptimet e të anketuarve rreth përputhshmërisë së arsimit me punësimin,

31. INSTAT, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim & UNFPA (2015) Të rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë. Tiranë.




kënaqësinë në punë dhe të ardhurave të ligjshme. Të anketuarve iu parashtruan këto pohime:

- Pohimi 1: Punëkërkuessit e mirë-arsimuar duhet të pranojnë edhe vende pune për të cilat ata janë të mbikualifikuar.
- Pohimi 2: Në përgjithësi, të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune.
- Pohimi 3: Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme.

Mundësia se ky nxitës mund të krijojë një mjedis që keqpërdoret nga ideologjitë ekstremiste u vleftësua në bazë të përgjigjeve negative për pohimet e mësipërme, të cilat vërtetojnë perceptimet për pritshmëritë e dështuara për punësimin e të rinjve të mirë-arsimuar, perceptimet e privimit relativ të të rinjve dhe shkallën e respektimit të rregullave dhe normave sociale nga të rinjtë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (68.2%) janë dakord me pohimin e parë. Sa më i madh në moshë të jetë i intervistuari, aq më shumë mendon se punëkërkuessit e mirë-arsimuar duhet të pranojnë vende pune për të cilat ata janë të mbikualifikuar. Ata që kanë përfunduar ciklin bazë të arsimit tetë ose nëntëvjeçar ose arsimin e mesëm kanë më shumë gjasa të jenë dakord me këtë pohim (72.1% për të dy nënkategoritë) sesa të diplomuarit universitarë (63,5%) dhe pasuniversitarë (58.1%).

**Figura 25. Përgjigjet për pohimin se punëkërkuessit e mbikualifikuar duhet të pranojnë vende pune për të cilat ata janë të mbikualifikuar (%; N = 1,586)**




Shumë të diplomuar universitarë e kanë të vështirë të gjejnë punë dhe të nisin karrierë në vendet e tyre të origjinës, duke zgjedhur kështu të vendosen në kryeqytet ose jashtë vendit. Perceptimi mbizotërues i të anketuarve (67.6%) në sondazhin tonë është se të rinjtë e arsimuar në qarqet e tyre nuk kanë vende të mira pune. Ky perceptim është më i fortë në nënkategorinë e atyre të intervistuar që praktikojnë ritet fetare (71.7%), mes



të anketuarve nga zonat rurale (72.2%), tek meshkujt (71%) dhe në kategoritë e atyre që kanë përfunduar arsimin tetëvjeçar (71%) ose arsimin e mesëm (71%), mes të papunëve (73.5%) dhe “të tjerë” (dominuar nga të anketuarit pensionistë, 76.7%). Sa më e madhe mosha e të anketuarit, aq më shumë ka gjasa që ata të mos jenë dakord me pohimin se të rinjtë e arsimuar në rajonin e tyre kanë kapur vende të mira pune.


**Figura 26. Përgjigjet për pohimin se të rinjtë e mirë-arsimuar kanë kapur vende të mira pune (%; N = 1,591)**



Në qarqet që përjetojnë privim social-ekonomik dhe papunësi të të rinjve ka rrezik që këta të fundit të angazhohen në veprimtari të paligjshme për të siguruar jetesën për vete dhe për familjen. Nëse ky fenomen përhapet në zonat periferike, ai mund të shkaktojë dëme tek vlerat e komunitetit, gjë që sjell si rezultat rritjen e tolerancës ndaj daljes nga rruga e drejtë dhe ndaj kriminalitetit. Nënkultura që toleron veprimtari në kriminale ushqen ekstremizmin dhe dhunën. Pjesa më e madhe e të anketuarve (61.7%) besojnë se të ardhurat kryesore për të rinjtë në zonën e tyre janë nga puna e ndershme (Figura 27).



**Figura 27. Përgjigjet për pohimin se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë është puna e tyre e ndershme (%; N = 1,588)**



Ata që praktikojnë rregullisht ritet fetare tregojnë një nivel më të lartë dakordësie me këtë pohim sesa ata që janë laikë (68.8% dhe 58.4%, përkatësisht). Ky trend vërehet tek të anketuarit nga zonat rurale si dhe mes atyre me nivel më të ulët arsimor (me arsim të mesëm ose më pak). Të intervistuarit e fokus grupeve (DFG1-4) raportuan raste të të rinjve të papunë që në sajë të veprimtarive të paligjshme, si kumari apo shitja e lëndëve narkotike, jetonin në luks që nuk justifikohesh nga të ardhurat e tyre. Pjesëmarrësit e një diskutimi në fokus grup me besimtarët myslimanë deklaruan se të rinjtë fetarë kanë më pak gjasa të angazhohen në aktivitete të paligjshme (DFG4).

*Arsyeja se privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara shihen si nxitës drejt ekstremizmit të dhunshëm është se personat e zhgënjyer nga mosrealizimi i pritshmërive dhe ata që përjetojnë forma të ndryshme të privimit social mund të tërhiqen drejt ideologjive ekstremiste fetare, sepse këto të fundit u japin atyre premtimin e shpëtimit dhe shpëtimin e përshtatshëm. Përgjigjet për pohimet e kontrollit konfirmojnë se ka një përhapje të perceptimit se personat e mirë-arsimuar nuk janë në gjendje të gjejnë një punë që të përputhet me kualifikimet dhe arsimin e tyre. Hendeku mes arsimin dhe punësimit mund të bëhet burim zhgënjimi për shumë të rinj. Megjithatë, sipas analizës së përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit, feja mund të bllokohet kalimin nga zhgënjimi drejt ekstremizmit. Ndonëse në kampionin tonë kombëtar, personat fetarë shfaqën mosdakordësi më të madhe sesa mesatarja kombëtare me pohimin “Në përgjithësi, të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën ku banojnë kanë siguruar vende të mira pune”, ata kanë më shumë gjasa të pranojnë vende pune për të cilat janë të mbikualifikuar. Kundërshtimi me pohimin e dytë është më i fortë në zonat rurale, mes meshkujve, atyre me nivel më të ulët arsimor dhe tek të papunët. Përsëri, fetarët kanë më shumë gjasa të mbajnë distancë nga aktivitetet e paligjshme sesa njerëzit laikë. Të anketuarit që banojnë në zonat rurale dhe ata me nivele më të ulët arsimor janë më shumë dakord me pohimin se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banojnë është puna e ndershme.*

**V.1.5. Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike**

*Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.*

Në shumë zona periferike dhe të pazhvilluara, shumë njerëz varen nga ndihma dhe asistencë ekonomike që jepen nga shteti. Prandaj, ka rëndësi të madhe që institucionet shtetërore të punojnë në mënyrë profesionale me individët dhe familjet në nevojë, jo thjesht për shkak të varfërisë, por edhe për shkak të ndjenjave akute të neglizhimit dhe përjashtimit që nxisin radikalizmin, ekstremizmin dhe sjelljen e dhunshme. Në vendet në zhvillim si Shqipëria, sektori i shoqërisë civile hyn në partneritet me shtetin për të ofruar ndihmë, asistencë dhe trajnime për njerëzit në nevojë. Përveç fondacioneve të huaja humanitare dhe organizatave joqeveritare (OJQ), në vend kanë qenë aktive edhe organizatat e huaja fetare, duke ofruar ndihma materiale, shërbime shëndetësore, arsim dhe këshillim shpirtëror për shumë qytetarë të tillë. Por ndonjëherë organizatat humanitare fetare kanë shërbyer si mbulesë për ekstremistët e huaj fetarë për përhapjen e mesazheve të tyre dhe për ta kthyer Shqipërinë në një bazë operative për aktivitetet e tyre në vende të tjera. Në vitet 1990, duke përfituar nga situata e rënduar social-ekonomike në vend dhe nga mangësitë në agjencitë e zbatimit të ligjit, shumë organizata fetare “bamirësie” filluan të përhapnin ide ekstremiste fetare tek popullsia. Ato u futën në komunitetet lokale përmes financimit të bursave për të rinjtë, ndërtimit të xhamive dhe ndihmave për familjet e varfra. Ato patën ndikim të madh në zonat e varfra periferike dhe rekrutuan shumë pasues, kryesisht djem të rinj, të cilët filluan të praktikonin rite që ishin të panjohura për Islamin tradicional shqiptar deri në atë kohë. Me zbulimin e lidhjeve mes terrorizmit ndërkombëtar dhe disa prej këtyre organizatave “bamirëse”, këto të fundit u detyruan të mbyllnin aktivitetin e tyre në Shqipëri.<sup>32</sup>

Niveli i lartë i varfërisë dhe papunësisë në zonat periferike dhe të privuara si dhe shërbimet e dobëta sociale i ekspozojnë komunitetet vendore ndaj aktiviteteve të këtyre grupeve. Për të kuptuar më mirë këtë dukuri, të intervistuarve iu parashtruan pohimet e mëposhtme:

- |           |  |
|-----------|--|
| Pohimi 1: | Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime. |
| Pohimi 2: | Në zonën ku banoj ka shumë familje/individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës.   |
| Pohimi 3: | Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë privilegje ose përfitime materiale/ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.         |

32. Balkan Investigative Reporting Network (2014) Zanafilla e islamit radikal në Shqipëri. Reporter.al, gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/zanafilla-e-islamit-radikal-ne-shqiperi/> (aksesuar më 30 korrik 2018).




Rëndësia e këtij nxitësi u vleftësua në bazë të përgjigjeve negative për pohimin e parë dhe përgjigjeve pozitive për dy pohimet e tjera. Mungesa e profesionalizimit dhe abuzimi nga institucionet shtetërore të asistencës sociale dhe ekonomike mund të shkaktojnë perceptimin e përjashtimit social. Pohimi i dytë lidhet me perceptimin e nevojave bazë të papërmblushura dhe pohimi i tretë shqyrton praninë e grupeve fetare që shfrytëzojnë cenueshmërinë social-ekonomike.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (64.2%) nuk janë dakord me pohimin e parë, megjithëse më shumë të anketuar fetarë tentojnë të tregojnë një nivel më të lartë dakordësie me këtë pohim sesa ata që janë më pak fetarë (32.4% kundrejt 22.8%) dhe banorët e zonave urbanë janë më dakord sesa të anketuarit nga zonat rurale (28.3% kundrejt 22.5%). Të intervistuarit e papunë dhe studentët, kategoritë sociale që kanë më shumë lidhje me institucionet e asistencës sociale, në mënyrë të veçantë, nuk janë aspak dakord me këtë pohim. Pjesëmarrësit në fokus grupe theksojnë se, për shkak të mangësive dhe korrupsionit në institucionet shtetërore të ndihmës ekonomike, shumë familje të varfra në zonën e tyre nuk përfitojnë nga skemat e ndihmës sociale (DFG1, DFG3).

Në lidhje me pohimin e dytë, pjesa më e madhe e të anketuarve (85.6%) mendojnë se në komunitetin e tyre ka familje dhe individë që nuk plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës. Të intervistuarit e moshës mbi 65 vjeç, shtresë e cenueshme e popullsisë, tregojnë nivelin më të lartë të dakordësisë me këtë pohim, në masën 94.2 për qind.

**Figura 28. Përqindja e mbështetjes për pohimin se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime (N = 1,590) dhe se ka shumë familje/individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës (N = 1,589)**




Dihet që grupet ekstremiste dhe radikale fetare i rekrutojnë pasuesit e tyre në zonat e varfra ekonomikisht ose nga grupe të marginalizuara në zona të tjera duke u premtuar këtyre njerëzve përfitime materiale apo të formave të tjera. Siç tregohet edhe nga gjetjet tona, ka një numër të madh familjesh dhe individësh në Shqipëri që luftojnë për të siguruar jetesën. Në disa raste, në shpëtim të tyre vijnë njerëz nga komuniteti që u plotësojnë atyre nevojat bazë materiale, si ushqim, strehim apo veshmbathje për



fëmijët. Megjithatë, kjo nuk është zgjidhje e strukturuar dhe e përhershme. Një rol i rëndësishëm luhet nga një sërë organizatash bamirëse që mbushin këtë hendek, disa prej të cilave kanë synim specifik fetar. Asistenca e tyre vjen në disa forma, përfshirë edhe mbështetjen social-ekonomike, shërbime shëndetësore dhe të tjera shërbime për njerëzit në nevojë. Kjo asistencë i legjitimon këto organizata në sytë e komunitetit ku veprojnë, duke ua bërë më të lehtë atyre ta përdorin këtë pozicion si mjet për t'i bindur njerëzit që t'i bashkohen një organizate të caktuar fetare.

Të anketuarit e këtij sondazhi (30.7%) konfirmojnë raste të grupeve fetare që u ofronin privilegje apo të mira materiale njerëzve që praktikonin ritet fetare. Përqindja e atyre që nuk janë dakord me këtë pohim është 39 për qind, ndërsa 28 për qind u përgjigjën “nuk e di”.

**Figura 29. Përqindja e mbështetjes për pohimin se ka grupe fetare që u ofrojnë privilegje ose përfitime materiale/ekonomike praktikantëve të fesë së tyre (N = 1,592)**



Një numër më i vogël të intervistuarish që praktikojnë rregullisht ritet fetare dhanë përgjigjen “nuk e di” (shumica ose ishin dakord 42.2% ose nuk ishin dakord 35.3% me këtë pohim) krahasuar me ata që praktikojnë ritet kryesore fetare dhe ata që bëjnë jetë laike. Nga këndvështrimi i arsimit, ata me arsim më pak se tetë- apo nëntëvjeçar, apo pa arsim, treguan përqindjen më të lartë të mosdakordësisë dhe nivelin më të vogël të dakordësisë me këtë pohim. Është me interes të evidentohet se të gjitha kategoritë e arsimit raportuan një nivel të ngjashëm të përgjigjeve “nuk e di” (27-31%). Pjesëmarrësit e diskutimeve në fokus grupe raportuan disa raste të organizatave bamirëse me aktivitet fetar që synonin të merrnin nën kujdesin e tyre individë të ndryshëm pa përkrahje (si fëmijët jetimë në Tiranë dhe Gjirokastrë) për t'i konvertuar ata në fenë e tyre (DFG2). Prania e grupeve të tilla konfirmohet nga përqindje më të larta (sesa mesatarja kombëtare) e intervistuarve që bien dakord me këtë pohim në bashkitë Kurbin (69%), Lezhë (53%), Elbasan (52%), Krujë (51.5 (35%), Maliq (35%), Korçë (33%), Bilisht (33%), Kavajë (43.5%), Gjirokastrë (43%), Vlorë (42%), Durrës dhe Dibër (32%). Përqindje të larta u vunë re edhe në bashki më të vogla si Kuçova (61%), Vora (43%), Roskoveci (41%), Puka (40%), Ura Vajgurore (40%) dhe Vau i Dejës (39%).





*Analiza e këtij nxitësi – “Nevoja të papërmbushura sociale dhe ekonomike” – na jep një pamje të privimit në qarqe të ndryshme anembanë vendit. Perceptimi dominues është se në shërbimet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike që duhet të mbështesin njerëzit në nevojë ka mangësi dhe korrupsion. Kategoritë e veçanta të cenueshme janë të papunët, pensionistët dhe studentët. Organizata bamirëse fetare si dhe laike veprojnë me projekte që synojnë përmirësimin e jetës së banorëve të komuniteteve në zonat ku veprojnë. Ekziston një përqindje e konsiderueshme prej 30.7 në kampionin kombëtar që konfirmojnë praninë e grupeve fetare në zonat e tyre që u ofrojnë privilegje ekonomike atyre që praktikojnë fenë e tyre. Përqindjet më të larta se mesatarja kombëtare që raportojnë praninë e këtyre grupeve raportohen në këto bashki: Kurbin (69%), Kuçovë (61%), Lezhë (53%), Elbasan (52%), Krujë (51.5% (43%), Vorë (43%), Gjirokastrë (43%), Vlorë (42%), Roskovec (41%), Pukë (40%), Ura Vajgurore Durrës (36%), Shijak (35%), Maliq (35%), Korçë (33%), Bilisht (33%) dhe Dibër (32%). Në raste të tilla ekziston mundësia e përhapjes së ndikimeve të huaja fetare dhe depërtimit të ideologjive fundamentaliste dhe ekstremiste tek besimtarët fetarë shqiptarë.*

#### **V.I.6. Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike**

*Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshehur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.*

Edhe pse ekstremizmi dhe terrorizmi i dhunshëm klasifikohen si krime të orientuara politikisht, ato janë të lidhura ngushtë edhe me aktivitete të tjera të paligjshme që kanë synime ekonomike. Organizatat terroriste angazhohen në veprimtari të paligjshme ekonomike për të financuar aktivitetet e tyre. Ato blejnë armë, dokumente false dhe materiale të tjera logjistike nga trafikantë si dhe pastrojnë paratë nëpërmjet kanaleve që përdoren edhe nga krimi i organizuar. Organizata terroriste të njohura, si Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë (FARC) në Kolumbi dhe Abu Sayyaf në Filipine, kanë ndërmarrë operacione të paligjshme ekonomike në trafikun e drogës dhe rrëmbime personi si dhe rekrutojnë anëtarë të rinj duke u premtuar atyre pasuri.<sup>33</sup> Siç u tha edhe më sipër, disa organizata bamirëse islamike në Ballkan kanë vepruar në të kaluarën si organizata të fshehta për aktivitete terroriste, duke u siguruar terroristëve dokumente të rreme të prodhuara në tregun e zi dhe duke financuar përmes transfertave bankare udhëtimet e tyre në rajon.<sup>34</sup> Kur këto OJQ u mbyllën nga autoritetet shqiptare në fillim të viteve 2000, vlera e asetëve të tyre të ngrira llogaritet të shkonte deri në 20 milionë dollarë.<sup>35</sup>

Për të shqyrtuar nëse mjedisi në Shqipëri ofron hapësirë për lidhjen e veprimtarisë

33. O'Brien, M. (2012) "Fluctuations Between Crime and Terror: The Case of Abu Sayyaf's Kidnapping Activities." *Terrorism and Political Violence*, 24: 320–336; Picarelli, J. T. (2012) "Osama bin Korleone? Vito the Jackal? Framing Threat Convergence Through an Examination of Transnational Organized Crime and International Terrorism", *Terrorism and Political Violence*, 24: 180–198.

34. Zoto, E. (2013) *Failure and Success of the Jihadi Information Operations on the Internet*. Tezë për gradën master. Monterey (CA): Naval Postgraduate School.

35. Kullolli, A. (2009) *Proselytization in Albania by Middle Eastern Islamic organizations*. Monterey (CA):






kriminale me ekstremizmin e dhunshëm, në këtë studim të anketuarit e sondazhit u pyetën se sa ishin dakord me pohimet e mëposhtme:

- Pohimi 1: Disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja.
- Pohimi 2: Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm.
- Pohimi 3: Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet.

Sipas përgjigjeve nga kampioni kombëtar, 33.1 për qind janë dakord me pohimin e parë dhe 51.2 për qind nuk janë dakord. Kështu, pjesa më e madhe nuk do ta refuzonin një punë të caktuar të ligjshme që nuk ua lejon feja. Perceptimet e të intervistuarve fetarë janë diametrikalisht të kundërta me ato të të anketuarve laikë për sa i përket kësaj teme: nga të anketuarit që praktikojnë rregullisht ritet fetare, 53.7 për qind u përgjigjën në mënyrë afirmative dhe 31.7 për qind nuk ishin dakord me pohimin. Një prirje e ngjashme me kampionin kombëtar vihet re edhe tek të anketuarit që praktikojnë ritet kryesore (36.7% janë dakord; 49.4% nuk janë dakord) apo ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (22.7% janë dakord; 59.2% nuk janë dakord). Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç prirën të jenë më shumë dakord me këtë pohim (39.5%) sesa ata të moshës 25 - 34 vjeç, që kanë edhe përqindjen më të ulët të dakordësisë (29.2%) mes grupmoshave të ndryshme.

**Figura 30. Përqindja e mbështetjes për pohimin se disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që nuk m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja (N = 1,580)**




Pjesa më e madhe e të anketuarve (56.7%) nuk do të ndërmerrenin asnjë aktivitet ekonomik që mund të jetë i paligjshëm për hir të mbijetesës së përditshme, ndërsa



36.2 për qind ishin dakord ose shprehën mbështetjen e plotë për këtë pohim. Të intervistuarit jo-besimtarë kishin më shumë gjasa të pranonin të ndërmerrnin aktivitete të paligjshme për të siguruar mbijetesën e përditshme krahasuar me të anketuarit besimtarë (38% kundrejt 34.5%). Të anketuarit e moshës 18 - 34 vjeç kanë më shumë gjasa të përgjigjen në mënyrë pohore sesa të anketuarit në moshë më të madhe, ndonëse në çdo grupmoshë shumica nuk ishte dakord me këtë pohim. Të anketuarit meshkuj ishin dakord më shumë se femrat (40.2% dhe 31.9%, përkatësisht). Më shumë dakordësi me pohimin vihet re tek të anketuarit që kanë përfunduar arsimin tetë- ose nëntëvjeçar dhe shkollën e mesme, në kontrast me të anketuarit me diplomë universitare dhe pasuniversitare. Studentët dhe të anketuarit e papunë prireshin më shumë të ishin dakord me pohimin (40.7% dhe 40.9%, përkatësisht) sesa të punësuarit, të vetëpunësuarit dhe pensionistët.

Ndërkohë që dy pohimet e para synojnë nivelin personal –ku të anketuarit pyeten nëse ata do të zgjidhnin mbijetesën e përditshme ndaj vlerave dhe normave të tyre– në pohimin e tretë synohet një nivel më i përgjithshëm. Prandaj, përgjigjet ndaj pohimit “Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet” qëndrojnë në kontrast të madh me ato që u dhanë për pohimet personale. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve (53.7%) ishin dakord se të gjithë do të dëshironin të pasuroheshin shpejt pavarësisht mjeteve për t’ia arritur atij.

**Figura 31. Përqindja e mbështetjes për pohimin se për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikojë çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm (N = 1,588) dhe pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet (N = 1,589)**



Niveli i besimit fetar i të anketuarve në lidhje me Pohimin 3 ka korrelacion negativ me mbizotërimin e përgjigjeve, ku rritja e praktikimit të riteve fetare shoqërohet me rënie në përqindjen e dakordësisë (dhe përqindje më të lartë të mosdakordësisë me pohimin). Të anketuarit që kanë përfunduar arsimin tetë- ose nëntëvjeçar dhe arsimin e mesëm kanë më shumë gjasa të jenë dakord me pohimin (55.8% dhe 55.6%, përkatësisht) sesa ata që kanë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare (51.3% dhe 48.8%, përkatësisht). Me diferencë të madhe, të anketuarat femra priren më shumë të mos jenë dakord krahasuar me meshkujt kur bëhet fjalë për pohimin “për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikojë çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm”. 61% e grave e kundërshtojnë këtë qëndrim, ndërsa vetëm 32% e tyre priren të bien

dakord. Ky raport qëndron në shifrat 53% (nuk jam dakord) në 40% (jam dakord) për të anketuarit meshkuj. Një i intervistuar i ri në DFG2 vuri në dukje se: “Ata që angazhohen në aktivitete të paligjshme kanë një themel të brishtë morali dhe një botëkuptim shumë të kufizuar; prandaj ndikohen më të lehtë nga grupet radikale”.

*Në përgjithësi, shumica e të anketuarve kanë qëndrim laik ndaj punësimit: për shkak të pikëpamjeve fetare ata nuk do të refuzonin një punë të ligjshme që u ofrohet. Shumica e besimtarëve fetarë që praktikojnë rregullisht ritet fetare kanë më shumë gjasa të refuzojnë një vend të ligjshëm pune nëse e dinë se pranimi i këtij vendi pune do të ishte kundër besimit të tyre fetar, duke kufizuar kështu mundësitë për përmirësimin e jetës. Të rinjtë të moshës 25-34 vjeç janë më pragmatikë sesa brezat e vjetër, pasi nuk do të refuzonin një vend pune për shkak të bindjeve fetare. Po ashtu, të rinjtë zënë përqindje më të madhe tek të anketuarit që janë dakord me Pohimin 2: “Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikojnë çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm.” Ky fakt në vetvete duhet të përbëjë shqetësim të madh për shoqërinë, ndonëse pjesa më e madhe e kampionit nuk ishte dakord me pohimin. Gratë tregojnë rezistencë më të madhe ndaj një qëndrimi të tillë në krahasim me burrat. Nga ana tjetër, vihet re një dakordësi e konsiderueshme me pohimin tek studentët dhe të papunët. Të anketuarit besimtarë priren më shumë të mos jenë dakord me këtë pohim si dhe me pohimin tjetër “Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet.” Sa më i lartë të jetë niveli arsimor aq më i ulët duket se është niveli i dakordësisë me këtë pohim. Grupet radikale apo ekstremiste që u premtojnë përfitime materiale ndjekësve të tyre kanë më shumë gjasa të gjejnë rekrutë mes të rinjve që duan të pasurohen shpejt dhe që nuk kanë një bazë të shëndetshme fetare.*

#### **V.I.7. Përfundime për nxitësit social-ekonomikë**

Nxitësit social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm përbëjnë kërcënim për Shqipërinë, një vend në zhvillim në periferi të BE-së. Shqiptarët po përjetojnë dobësim të lidhjeve familjare dhe ato të rrethit shoqëror. Sjellja e pahijshme dhe anti-sociale e të rinjve perceptohet të jetë e fortë në bashkitë Elbasan, Lezhë, Kamëz, Kukës, Kurbin, Pogradec, Korçë, Krujë, Durrës, Fier dhe Tiranë. Familjet fetare tregojnë më shumë mbështetje ndaj vlerave familjare dhe në një farë mase mund të pengojnë sjelljen anti-sociale të të rinjve. Edhe pse identitetet fetare transmetohen tek adoleshentët dhe të rinjtë kryesisht nëpërmjet familjes, grupet e bashkëmoshatarëve dhe shokëve luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen drejt një botëkuptimi fetar.

Hendeku mes nivelit arsimor dhe mundësive për punësim është burim zhgënjimi për shumë të rinj, të cilët, pavarësisht kualifikimeve të tyre, shpesh nuk mund të gjejnë punën e duhur. Në një farë mase, feja mund të ndihmojë në parandalimin e devijimit nga zhgënjimi drejt ekstremizmit: analiza jonë tregoi se besimtarët fetarë priren më shumë se mesatarja kombëtare të pranojnë një vend pune për të cilin janë të mbikualifikuar. Perceptimi se njerëzit me moshë të re dhe të mirë-arsimuar nuk kanë punë të mirë është më i përhapur në zonat rurale sesa në zonat urbane, mes meshkujve, tek të anketuarit me më pak arsim dhe tek të papunët.

Të anketuarit fetarë kanë më shumë gjasa të refuzojnë një punë të ligjshme nëse këtë ua kërkon besimi i tyre fetar. Të rinjtë e moshës 25 - 34 vjeçare janë më pragmatistë sesa brezat e vjetër, duke qenë se nuk do të refuzonin një vend pune për shkak të bindjeve fetare. Po ashtu, të rinjtë janë më shumë të prirur të justifikojnë çdo aktivitet ekonomik, qoftë edhe të paligjshëm, për hir të mbijetesës. Gratë tregojnë rezistencë më të madhe për këtë çështje, pasi kundërshtojnë aktivitetet e paligjshme ekonomike për hir të



mbijetesës në një përqindje më të lartë se burrat. Të anketuarit fetarë kanë më shumë gjasa të mos jenë dakord me një qëndrim të tillë, duke rikonfirmuar se besimi fetar mund të ndihmojë në parandalimin e faktorëve social-ekonomikë që bëhen nxitës drejt rrugës së ekstremizmit fetar. Gjithsesi, jo gjithmonë mund të jetë kështu duke qenë se problemet social-ekonomike manipulohen nëpërmjet prizmit të diskriminimit fetar. Grupet radikale apo ekstremiste fetare që u premtojnë përfitime materiale ndjekësve të tyre kanë më shumë gjasa të rekrutojnë të rinj që udhëhiqen nga lakmia. Nga ana tjetër, perceptimet se ekstremizmi fetar, i krishterë ose islamik, ekziston në zona të tilla si Kruja, Elbasani, Shijaku, Durrësi, Bilishti, Kamza duhet të merren seriozisht nga aktorët përkatës –qoftë shtetërore apo jo-shtetërore– të angazhuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Toleranca fetare është e vërtetë në Shqipëri dhe vlerë themelore e shoqërisë shqiptare. Pjesa më e madhe e të intervistuarve mendojnë se përkatësia fetare nuk përbën bazë për diskriminimin në shoqëri. Megjithatë, nëse gërvishtim këtë sipërfaqe, poshtë saj do shohim se ka faktorë që duhet të shqyrtohen me kujdes. Për shembull, për një të tretën e kampionit kombëtar mbulimi dhe shamia e kohës për gratë dhe mbajtja e mjekrës për burrat konsiderohen si shenja të ekstremizmit fetar. Koncepte të tilla të gabuara mund të shkaktojnë lindjen e paragjykimëve dhe diskriminimit në shoqëri, gjë që nga ana tjetër mund shërbejnë si faktorë shtytës drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ndërkohë, disa të anketuar fetarë shprehin shqetësimin e tyre për një përfaqësim më të drejtë të grupeve të tyre fetare në politikë dhe institucionet shtetërore.

Perceptimi dominues për mangësitë dhe korrupsionin në shërbimet shtetërore të asistencës sociale dhe ekonomike është veçanërisht i fortë tek të papunët, pensionistët dhe studentët. Grupet fetare që veprojnë në zonat e varfra mund ta lehtësojnë disi situatën për njerëzit në nevojë, por një përqindje e konsiderueshme (30.7%) e kampionit kombëtar mendon se ndihma që japin këto grupe kushtëzohet me praktikimin e riteve fetare nga përfituesit e kësaj ndihme. Përqindje më të larta se mesatarja kombëtare për ekzistencën e këtyre grupeve fetare raportohen në bashkitë Kurbin, Kuçovë, Lezhë, Elbasan, Krujë, Kavajë, Vorë, Gjirokastrë, Vlorë, Roskovec, Pukë, Ura Vajgurore, Vau i Dejës, Shijak, Maliq, Korçë, Bilisht dhe Dibër. Këto përqindje, qoftë perceptim apo (nëse konfirmohen) realitet, duhet të trajtohen nga autoritetet përkatëse për të portretizuar, ndër të tjera, vetë frymën e bashkëjetesës dhe tolerancës fetare si vlerë themelore e shoqërisë shqiptare.

## V.2. Nxitësit politikë

Pjesa më e madhe e nxitësve politikë të EDH që lidhen me gjendjen e demokracisë, qeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në vend, me përjashtim të tre nxitësve në kontesktin e Shqipërisë: “pushtim i huaj” dhe “dhunimi politik/ushtarak”, nuk përshkruajnë realitetin aktual të vendit, ndërsa “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane” lidhet kryesisht me perceptimet dhe qëndrimet e publikut ndaj Perëndimit dhe sistemit ndërkombëtar në përgjithësi. Gjithsesi, ato vlerësohen në këtë studim nëpërmjet prizmit të fenomenit të luftëtarëve të huaj dhe qëndrimeve të besimtarëve fetarë ndaj vlerave dhe dinjitetit fetar (Tabela 3).



Tabela 3. Nxitësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm

NXITËSI	PËRSHKRIMI
<b>Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile</b>	Mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të nxisin besimin se dhuna është mjete i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë qytetare e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
<b>Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut</b>	Drejtesia është vlerë me rëndësi kritike në Islam. Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individit në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.
<b>Pushtimi i huaj</b>	Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre.
<b>Dhunimi politik dhe/ose ushtarak</b>	Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.
<b>Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta</b>	Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet qytetar e apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i sulen elitave të pamoralshme qeverisëse.
<b>Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët</b>	Këto zona janë të izoluar, rajone me dendësi të ulët popullore që përbëjnë vatra të sigurt ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Duhet të kuptohet se grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të tërhiqen drejt "shteteve me forcë të kufizuar", në krahasim me shtetet e dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer operacionet.
<b>Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm</b>	Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre.
<b>Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë</b>	Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ngatërrohet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit.

Burimi: Denoeux dhe Lynn Carter (2009)



Lista e raportuar në Tabelën 3 nuk është shteruese. Nxitësit politikë nuk veprojnë të izoluar nga njëri-tjetri apo nga nxitës të tjerë brenda kategorive kulturore dhe social-ekonomike. Gjithsesi, Denoeux dhe Carter (2009) argumentojnë se këta nxitës politikë shpesh sigurojnë mjedisin mundësues për ekstremizmin e dhunshëm

*Një apo disa nga këta nxitës politikë mund të ndërthuren ngushtësisht me disa nga nxitësit socialë dhe ekonomikë që u trajtuan më sipër. Për shembull, korrupsioni mund të dobësojë gradualisht kapacitetin e shtetit duke dëmtuar aftësinë e qeverisë për t'u përballur me përjashtimin social, i cili, siç u diskutua edhe më sipër, shpesh nxit ekstremizmin e dhunshëm.<sup>36</sup>*

Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë mjedisin e gjerë politik duke analizuar ndikimin e nxitësve në këtë kategori si dhe ndërveprimin e tyre me nxitësit e tjerë dhe faktorët kontekstualë që përcaktojnë realitetin shqiptar dhe përpjekjet e vendit për të konsoliduar shtetin ligjor. Vlerësimi i demokracisë në Shqipëri nuk ka ndryshuar gjatë tre viteve të fundit që nga vlerësimi i parë i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri (IDM 2015). Sipas Indeksit të Demokracisë të Njësisë së Inteligjencës të Revistës The Economist, Shqipëria konsiderohet ende si regjim hibrid.<sup>37</sup> Vendi shpreson të hapë negociatat e anëtarësimit me BE-në në gjysmën e dytë të vitit 2019, në varësi të përparimit me konsolidimin e shtetit ligjor dhe në fushat me interes të veçantë, si gjyqësori, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, të drejtat e njeriut dhe administrata publike, ndër të tjera.<sup>38</sup> Hyrja në BE është objektiv strategjik për vendin dhe procesi i anëtarësimit është platforma më e plotë për demokratizimin dhe zhvillimin që ka përjetuar vendi.<sup>39</sup> Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka miratuar dhe ka filluar zbatimin e një prej reformave më të rëndësishme në gjyqësor, me qëllim rritjen e pavarësisë dhe dhënies fund të mosndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë. Kjo reformë, dhe sidomos procesi i verifikimit të figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting-u), gëzon mbështetje të gjerë në publik, pavarësisht një rënieje të vogël të besimit të publikut tek rezultatet e reformës, shkaktuar nga vonesat në procesin e vetting-ut dhe në krijimin e organeve të reja gjyqësore për luftën kundër korrupsionit.<sup>40</sup>

Raporti “Vendet në tranzicion” (Freedom House 2018) evidenton një përmirësim të vogël në renditjen e demokracisë në Shqipëri, nga 4.14 në vitin 2017 to 4.11 në 2018.<sup>41</sup>

36. Shih G. Denoeux and L. Carter (2009) “Guide to the drivers of violent extremism.” f. 27. Burimi: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/Pnadt978.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf)

37. Renditja e Shqipërisë u përmirësua nga 5.91 në vitin 2016 në 5.98 në vitin 2017. Burimi: Economist Intelligence Unit Democracy Index 2017: <https://infographics.economist.com/2018/DemocracyIndex/>

38. Shih Konkluzionet e Këshillit për Zgjerimin dhe Procesin e Stabilizim-Asocimit (26 qershor 2018). Burimi: <http://www.consilium.europa.eu/media/35863/st10555-en18.pdf>

39. Qytetarët shqiptarë janë në vend të dytë për sa i përket nivelit më të lartë të mbështetjes për anëtarësim në BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me 83% që mendojnë se ky anëtarësim është një gjë e mirë për vendin sipas “Barometrit Publik të Ballkanit për vitin 2018” të Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal. Burimi: <https://www.rcc.int/seeds/results/2/balkan-public-barometer>

40. Edhe pse pritshmëritë e publikut për ndikimin pozitiv të zbatimit të reformës në drejtësi mbeten ende të larta, pritshmëri të tilla kanë pësuar rënie nga 71% në vitin 2016 kur u miratua reforma në 66% në vitin 2017. Shih raportin e IDM-së “Besimi në qeverisje 2017” (f. 25). Burimi: <http://idmalbania.org/trust-governance-opinion-poll-2017/>

41. Shih raportin e Freedom House “Vendet në tranzicion 2018” Shqipëria. Burimi: [https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018\\_Albania\\_o.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018_Albania_o.pdf)





Sipas këtij raporti, lufta kundër korrupsionit përfaqëson fushën me performancën më të dobët, me 5.25 pikë që nga viti 2013. Raporti “Liria në botë: Shqipëria” (Freedom House 2018) sugjeron se vendi mbetet ende ‘pjesërisht i lirë’ dhe se korrupsioni dhe krimi i organizuar mbeten probleme serioze pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për t’i trajtuar ato dhe se ndërthurja e interesave të bizneseve të fuqishme, të politikës dhe medias pengon zhvillimin e burimeve me të vërtetë të pavarura të lajmeve.<sup>42</sup>

Prandaj, gjetjet e këtij studimi për ndikimin e nxitësve politikë në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm nuk përbëjnë surprizë duke pasur parasysh përparimin e Shqipërisë me një ritëm tejet të ngadaltë drejt konsolidimit të shtetit ligjor, vonesat në zbatimin e reformës në gjyqësor, mungesën e dëshmimeve të qëndrueshme për ndëshkrimin me sukses të korrupsionit të nivelit të lartë dhe, së fundmi, por jo më pak të rëndësishme, tendencën e vazhdueshme të mosbesimit të publikut tek institucionet. Në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni shtjellohen gjetjet për secilin prej nxitësve politikë bazuar në burime të ndryshme parësore dhe dytësore informacioni.

### V.2.1. Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile

*Mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të nxisin besimin se dhuna është mjeti i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë qytetare e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.*

Raporti “Liria në botë” (Freedom House 2018) sugjeron se në Shqipëri respektohen liritë civile dhe të drejtat politike. Në fakt, vendi po përparon me këmbëngulje drejt konsolidimit të shtetit ligjor. Megjithatë, Shqipëria ende e gjen veten me një regjim hibrid, që ndikon në zbatimin e ligjeve dhe vënien në praktikë të standardeve evropiane të mishëruara në sistemin ligjor. Për më tepër, interesat e bizneseve të fuqishme ndërthuren me ato politike dhe shpesh janë në konflikt me interesin publik; madje edhe shtrembërojnë informimin publik, duke qenë se aktorët e fuqishëm ekonomikë kanë aftësinë për të formësuar sferën politike sepse zotërojnë mediat në vend.<sup>43</sup> Shqipëria gjendet në fund të Indeksit të Lirisë së Medias 2018 së bashku me Maqedoninë dhe Turqinë, duke i bërë ato tre vendet e para në Evropë më të cenueshme ndaj lajmeve të rreme për shkak të mediave të tyre të kontrolluara,<sup>44</sup> nivelit të ulët arsimor dhe nivelit të ulët të besimit në shoqëri.<sup>45</sup> Shqetësime të tilla dhe mungesa e vazhdueshme e besimit të publikut tek institucionet shtetërore në vend janë tregues

42. Shih raportin e Freedom House “Vendet në tranzicion 2018” Shqipëria. Burimi: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/albania>

43. Shih raportin e Freedom House “Vendet në tranzicion 2018” Shqipëria. Burimi: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/albania>

44. Sipas Monitorit të Pronësisë së Mediave në Shqipëri, mediat shqiptare kontrollohen nga një numër i vogël pronarësh të fuqishëm me lidhje të forta politike. Për shkak të presionit që vjen nga pronarët e mediave me interesa politike dhe ekonomike, shumë gazetarë në Shqipëri detyrohen të bëjnë autocensurë. Në lidhje me projektin: <http://albania.mom-rsf.org/en/>. Shih edhe “Biznes familjar - Miti i medias pluraliste në Shqipëri, raporti i prezantuar nga Reporterët pa Kufi dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative Shqipëri”. Burimi: <https://rsf.org/en/news/family-affair-myth-media-pluralism-albania-media-ownership-monitor-presented-rsf-and-birn-albania>

45. Shih “2018 Media Literacy index”, Instituti Shoqëria e Hapur Bullgari. Burimi: [http://osi.bg/downloads/File/2018/MediaLiteracyIndex2018\\_publishENG.pdf](http://osi.bg/downloads/File/2018/MediaLiteracyIndex2018_publishENG.pdf)




i një “mjedisi miqësor” për qëndrimet dhe perceptimet që shohin pak shpresë tek një sistem politik që bën si i përgjegjshëm për aparençë apo sipas dëshirës.

Në sondazhin kombëtar jepen dy pohime përmes të cilit ky studim shqyrton mohimin e të drejtave politike dhe lirive civile si nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Kështu, në këtë sondazh të anketuarit pyeten se në ç’masë pasqyrojnë qëndrimin e tyre pohimet e mëposhtme:

- Pohimi 1. Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë civile të qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.
- Pohimi 2. Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.

Potenciali i këtij nxitësi për të krijuar hapësirë për ekstremizmin e dhunshëm shqyrtohet nëpërmjet vlerësimit të perceptimeve të publikut që nuk janë aspak dakord me pohimin e parë dhe të atyre që janë plotësisht dakord me pohimin e dytë.

**Figura 32. Mbështetja për pikëpamjen se të drejtat dhe liritë civile të qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore dhe se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (%; N = 1,583)**



Siç tregohet edhe në Figurën 32, pjesa më e madhe e të anketuarve nuk janë dakord me pohimin se të drejtat dhe liritë civile të qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore dhe vetëm 15 për qind janë plotësisht dakord. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të mosbesimit tek institucionet shtetërore që ka karakterizuar Shqipërinë për shumë vite me radhë gjatë periudhës së tranzicionit, një gjetje e tillë nuk është e papritur.

Duke parë demografinë e të anketuarve që priren të mos jenë dakord (1, nuk jam aspak dakord dhe 2, nuk jam dakord) me pohimin në lidhje me të drejtat e qytetarëve dhe liritë civile, për disa kategori nuk ka dallime të konsiderueshme mes përgjigjeve nga zonat rurale dhe urbane ose nga niveli i besimit fetar. E njëjta gjë vlen edhe për nivelin arsimor të të anketuarve, me përjashtim të atyre me më pak arsim se ai tetë-






apo nëntëvjeçar, ose pa arsim, dhe atyre me diplomë pasuniversitare. Kishte më pak të anketuar në këto grupe në skajet e spektrit që treguan më pak mosdakordësi me pohimin sesa kategoritë e tjera (45% dhe mesatarisht 61%, përkatësisht).

Edhe të anketuarit e papunë dhe të vetëpunësuar shfaqën më shumë mosdakordësi me pohimin (65%) sesa ata nga kategoritë e tjera të punësimit (55%). Ndërkohë, 62.1 për qind e të anketuarve meshkuj nuk u pajtuan me pohimin e parë në krahasim me 57.3 për qind të anketuarve femra.

Një përqindje e ngjashme e të anketuarve nuk ishin dakord aspak me pohimin e parë (30.4%) dhe ishin plotësisht dakord me pohimin e dytë (27.9%).<sup>46</sup> Gjithsesi, 47.7 për qind ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin e fundit. Pjesëmarrësit në të katër fokus grupet e organizuar në këtë studim nuk binin dakord kur diskutonin për këtë gjetje. Ndonëse shumica tregoi mirëkuptim ndaj pjesëmarrësve që e perceptojnë sistemin politik si të padrejtë për shkak të dobësive në shtetin ligjor, korrupsionit dhe administrimin e drejtësisë, ata hodhën poshtë qëndrimet që mbështesnin përdorimin e dhunës.



*Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë për të gjithë, pavarësisht besimit fetar. Por kjo duhet të ndryshojë vetëm me mjete demokratike.*

*Pjesëmarrës në DFG me 18–35 vjeçarë (26 qershor 2018)*

Disa pjesëmarrës të fokus grupeve kanë ngritur shqetësime nëse të anketuarit e kanë plotësisht të qartë se ç'do të thotë sistem politik, i cili, sipas profilit të tyre (p.sh. niveli arsimor), mund të ngatërrohet, e ndoshta mund të lidhet me partinë politike - institucioni më pak i besuar në Shqipëri për vite me radhë. Për të kuptuar më mirë qëndrime të tilla, në studim shqyrtohet profili i të anketuarve që priren të jenë dakord me pohimin se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja. Analiza e demografisë së intervistuarve të sondazhit që e pranojnë pohimin (3, jam dakord; 4, plotësisht dakord) tregon se të anketuarit që nuk praktikojnë ritet fetare priren të jenë paksa më shumë dakord (3%) se ata që praktikojnë ritet fetare, afër mesatares kombëtare (përafërsisht 48% e atyre që janë dakord dhe atyre që janë plotësisht dakord).

Dallime më të mëdha në përqindje vihen re tek karakteristikat e tjera demografike, siç janë moshja, gjinia, zona e banimit dhe statusi i punësimit. Ka më shumë të anketuar që janë dakord me pohimin tek grupmosha 55-64 vjeç (55%) dhe 18-35 vjeç (48%), të intervistuarit nga zonat rurale (53%) sesa ata nga zonat urbane (43.8%) dhe të anketuarit meshkuj (50.9%), ndërsa vetëm 44 për qind e të anketuarve femra u shprehën dakord. Një përqindje më e madhe e të anketuar të vetëpunësuar dhe të papunë ishin dakord (53%) krahasuar me ata me status tjetër punësimi (42-48%). Së fundi, me këtë pohim ishin më shumë dakord të anketuarit që kanë përfunduar shkollën e mesme, shkollën tetë apo nëntëvjeçare ose që nuk kishin arsim fare (mesatarisht me 8-10%) sesa ata me diplomë universitare apo pasuniversitare.

Me pohimin e dytë ishin dakord më shumë se 50 për qind e të anketuarve në bashkitë:

46. Të dhënat e studimit të IDM-së 2015 treguan se 26% e të anketuarve ishin dakord me këtë pohim në tetë fusha të synuara që u shqyrtuan nga studimi "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri" (IDM, 2015 f. 67).



Lezhë (86.1%), Maliq (65.2%), Kurbin (61.5%) dhe Elbasan (60.5%). Përqindje të larta u vunë re edhe në disa bashki të tjera: Peqin (66.7%), Gramsh (53.3%), Bilisht (50%) dhe Përrenjas (50%), ndonëse madhësia e kampionit për këto bashki ishte relativisht e vogël (me 10-20 të intervistuar në secilën prej tyre).

Të anketuarit në disa bashki të tjera treguan mbështetje më të madhe për këtë pohim sesa mesatarja kombëtare, përfshirë Belshin (72.7%), Kamzën (64%), Kukësin (67%), Tropojën (55%) dhe Pogradecin 50%). Sidoqoftë, nga Belshi dhe Tropoja kishte vetëm njëmbëdhjetë të anketuar.

*Në përgjithësi, ka arsye për t'u shqetësuar në lidhje me potencialin që paraqet "mohimi i të drejtave politike dhe të lirive civile" si nxitës drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ndonëse shqiptarët në përgjithësi janë shumë skeptikë ndaj institucioneve gjyqësore dhe presin rezultatet e procesit të vetingut me shpresa të mëdha për vendosjen e shtetit ligjor, është ende shqetësuese se 27.9 për qind e tyre janë shprehur plotësisht dakord se "sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja". Siç tregohet edhe në analizën e mësipërme, nuk ka motive fetare prapa këtyre perceptimeve, por ka mosbesim dhe zhgënjim të madh tek publiku për shkak të historisë së gjatë të kulturës së mosndëshkimit, korrupsionit dhe drejtësisë selektive. Ky qëndrim është më i pranishëm tek të anketuarit me nivel të ulët arsimor, tek meshkujt dhe banorët e zonave rurale, tek të vetëpunësuarit ose të papunët, tek ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar dhe tek të anketuarit e moshës 55-64 vjeç ose 18-35 vjeç. Për më tepër, këtë pohim e mbështetën një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve në bashkitë Lezhë, Maliq, Kurbin, Elbasan, Kamëz, Kukës dhe Pogradec, por edhe në bashki të tjera si Peqin, Gramsh, Bilisht, Përrenjas, Belsh dhe Tropojë, ndonëse numri i të anketuarve në këto bashki ishte i vogël.*

### **V.2.2. Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut**

*Drejtësia është vlerë me rëndësi kritike në Islam. Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.*

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut është një nga prioritetet kryesore për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Raporti i KE-së 2018 konstaton se kuadri ligjor dhe politik janë përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, zbatimi në praktikë i legjisllacionit dhe standardeve evropiane është shpesh çështje shqetësuese. Raporti për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë i Departamentit të Shtetit të SHBA (2017) i referohet rasteve të abuzimit të policisë dhe të dhunës në burgje.<sup>47</sup> Mekanizmi parandalues kombëtar ka monitoruar rregullisht punën e institucioneve përmes inspektimeve të agjencive të zbatimit të ligjit, veçanërisht Policisë së Shtetit. Gjatë vitit 2017 janë trajtuar gjithsej 29 ankesa për dhunë në ambientet e policisë dhe në institucionet e riedukimit, ndërsa Avokati i Popullit ka rekomanduar fillimin e procedimit penal ndaj një oficeri të Policisë së Shtetit me akuzën për ushtrim torture.

47. Shih Raportin e të Drejtave të Njeriut, Shqipëria 2017. Burimi: <https://www.state.gov/documents/>



Shërbimi i inteligjencës dhe Policia e Shtetit kanë qenë tejet aktivë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm gjatë viteve të fundit. Në vitin 2017 u kryen pesë operacione ku u arrestuan dymbëdhjetë persona me akuzën për veprën penale të terrorizmit. Në vitin 2016, katër shtetas u arrestuan në një operacion të koordinuar rajonal kundër terrorizmit, i cili parandaloi një sulm të mundshëm në Shkodër gjatë ndeshjes së futbollit Shqipëri-Izrael. Disa shoqata myslimane kanë shprehur shqetësimin e madh se besimtarët myslimanë po bëhen shënjestër e policisë, sipas tyre, pa prova të forta.<sup>48</sup>

Ky studim synoi të vlerësonte rëndësinë e nxitësit “Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut” në kontekstin shqiptar përmes katër pohimeve që mbledhin perceptimet e të anketuarve për abuzimet e mundshme nga agjencitë e zbatimit të ligjit për shkak të besimit fetar dhe qëndrimet e të anketuarve ndaj ligjit të shariatit dhe përgjigjet ndaj mohimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet shtetërore. Në mënyrë të veçantë, në këtë sondazh të anketuarit u pyetën se deri në ç’masë reflektojnë qëndrimet e tyre pohimet e mëposhtme:

Pohimi 1.	Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.
Pohimi 2.	Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë të krishterë.
Pohimi 3.	Zbatimi i Sheriatit (Legjislacioni Islam) duhet të lejohet për besimtarët myslimanë në Shqipëri.
Pohimi 4.	Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore.

Në debatin publik në vitin 2016 u komentua gjerësisht çështja e gjykimit të nëntë të rekrutuesve të dyshuar. Dënimet e dhëna për grupin e imamëve të panjohur që rekrutonin luftëtarë të huaj nga Shqipëria konsiderohen jashtëzakonisht të ashpra krahasuar me rastet e ngjashme në vendet fqinje.<sup>49</sup> Kohët e fundit, temë debati kanë qenë edhe shqetësimet për diskriminimin dhe islamofobinë pavarësisht faktit se raste të tilla mbeten të kufizuara.<sup>50</sup> Në këtë kontekst, dy pohimet e para të mësipërme synojnë të evidentojnë perceptimet e publikut për sjelljet e mundshme abuzive nga agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht ndaj besimtarëve praktikantë fetarë (myslimanë dhe të krishterë).

Siç tregohet edhe në Figurën 33, përqindja e të anketuarve që janë plotësisht dakord me këto pohime është mjaft e vogël, por me një dallim të qartë mes pohimit të parë (ndaj myslimanëve) dhe atij të dytë (ndaj të krishterëve). Rreth 6.4 për qind e të anketuarve ishin plotësisht dakord se “Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë,” dyfishi i raportit të atyre që e besojnë plotësisht këtë për besimtarët e krishterë (3.1%).

organization/277377.pdf


48. Shih Deklaratën e Forumit Mysliman të Shqipërisë, në adresën <http://www.fmsh-al.org/al/arkivi/izrael.html>

49. Shih OraNews (Maj 2016) “Vendimi për “xhihadistët”, Zhilla: Më i ashpëri në vendet e rajonit.” Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=L7iceHUCpyY>

50. Shih Vurmo Gj. “WB Extremism Research Forum—Albania Report 2018.” Këshilli Britanik, prill 2018. Burimi: <https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/erf2oalbania2oreport202018.pdf> f. 18.



**Figura 33. Opinioni për sjelljen e institucioneve ligjzbatuese ndaj myslimanëve përkundër të krishterëve (%; N = 1,582)**



Për të dy pohimet, nga analiza e demografisë së të anketuarve evidentohet se këto pikëpamje janë të pranishme më së shumti mes besimtarëve që praktikojnë fenë, tek të anketuarit me diplomë pasuniversitare dhe tek ata që banojnë në zonat urbane. Një gjetje e tillë përkon në një farë mase me demografinë e të intervistuarve që priren ta konsiderojnë diskriminimin shoqëror për shkak të besimit fetar. Kështu, “Toleranca fetare në Shqipëri” (IDM 2018) raporton se afro 11 për qind e shqiptarëve kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast në komunitetin e tyre të diskriminimit fetar apo përjashtimit të njerëzve për shkak të përkatësisë fetare, ku shumica përbëhej nga gratë, banorët në zonat urbane dhe ata që kanë mbaruar universitetin dhe studimet pasuniversitare.<sup>51</sup>

Perceptimet se institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë janë të pranishme në përqindje më të mëdha (duke kombinuar ata që janë dakord dhe ata që janë plotësisht dakord) sesa mesatarja kombëtare në bashkitë Kukës (37%), Vlorë (31%), Krujë (28%), Durrës (22%), Gjirokastrë (19%), Kamëz (20%) dhe Korçë (19%).<sup>52</sup>


Për sa i përket Pohimit 3— Zbatimi i Sheriatit duhet të lejohet për besimtarët myslimanë në Shqipëri— shumica e të anketuarve nuk ishin dakord me këtë pohim (30%, aspak dakord; 11.2%, nuk jam dakord; të kombinuar, 41.2%), dhe vetëm 15.7 për qind janë plotësisht dakord dhe 11.3 për qind janë dakord (në total së bashku 27%). Një tjetër grup prej 28.1 për qind nuk shprehën asnjë mendim dhe 3.7 për qind e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje (që së bashku përbëjnë një grup relativisht të madh prej 31.8%). Qendra Kërkimore Pew raportoi në vitin 2013 se 12 për qind e shqiptarëve të besimit islam ishin në favor që Sheriati të bëhej ligji zyrtar i vendit. Diferenca

51. Shih “Toleranca fetare në Shqipëri” (p. 7), IDM 2018. Burimi: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albania.pdf>

52. Përqindje relativisht të larta të perceptimeve që konfirmojnë trajtim më të ashpër për besimtarë praktikantë myslimanë gjenden edhe në disa bashki më të vogla (me një kampion më të vogël në këtë sondazh) si Tropoja, Tepelena, Mallakastra dhe Bilishti. Për shkak të përqindjeve të vogla të të anketuarve që mendojnë se bëhet “trajtim më i ashpër për besimtarët praktikantë të krishterë” është e vështirë të analizohen tendencat brenda këtyre bashkive.

në përqindje mund të shpjegohet nga fakti se pohimi në studimin e IDM-së pyeti (kampionin kombëtar të) të anketuarve për të lejuar zbatimin e Sheriatit për një grup të caktuar dhe nuk sugjeronte mundësinë që Sheriati të bëhej ligji zyrtar i vendit.

**Figura 34. Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se zbatimi i Sheriatit duhet të lejohet për besimtarët myslimanë (%; N = 1,582)**



Nuk është për t'u habitur që shumica dërrmuese e të anketuarve që mbështetën pohimin (dakord dhe plotësisht dakord) përbëhej nga njerëz që praktikojnë rregullisht ritet fetare (45.7%), me përqindje më të vogël të atyre që praktikojnë vetëm ritet kryesore (25.1%) ose nuk praktikojnë asnjë rit (20.5%). Më shumë se gjysma e të anketuarve mbi 65 vjeç nuk ishin dakord me këtë pohim. Ky pohim gjeti mbështetje më të madhe tek të anketuarit nga zonat rurale, ndërsa me rritjen e nivelit arsimor niveli i mbështetjes u ul në mënyrë të qëndrueshme, nga 34 për qind tek të anketuarit me më pak se tetë ose nëntë vjet shkollë ose pa arsim fare në gati 21 për qind tek të anketuarit me diplomë pasuniversitare.


Mbështetja e kombinuar (4, plotësisht dakord; 3, dakord) për përdorimin e Sheriatit për besimtarët myslimanë është më e madhe në bashkitë Krujë (50%), Fier (44%), Kurbin (40%), Lezhë (40%), Maliq (39%), Durrës (37%), Vlorë (36%), Elbasan (31%), Korçë (29%), Pogradec (29%), Shijak (25%) dhe Berat (24%).<sup>53</sup>

Më pak se 1/5 (18.9%) e të anketuarve të këtij sondazhi ishin plotësisht dakord me Pohimin 4 "Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore."

53. Këtë pohim e mbështetën edhe 30% - 50% e të anketuarve në bashkitë Roskovec, Bilisht, Mirditë, Tropojë dhe Skrapar. Megjithatë, kampioni i studimit që mbulon këto zona është më pak se 20 të anketuar për bashki.



**Figura 35. Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore (%; N = 1,586)**



Edhe pse më shumë se gjysma e intervistuarve të sondazhit (53.5%) nuk e konsiderojnë këtë si opsion, pothuajse 36 për qind e mbështetën një qasje të tillë si përgjigje ndaj institucioneve shtetërore që u mohojnë qytetarëve të drejtat dhe liritë e tyre. Si për ironi, pavarësisht shqetësimeve për konsolidimin e shtetit ligjor dhe mirëfunksionimin e institucioneve demokratike, qëndrimet e publikut e shohin si të pajustificueshëm vetëgjyqësinë përkundër përdorimit të mjeteve demokratike. Mbështetja për këtë pohim duhet të analizohet me kujdes nga perspektiva e potencialit për mbështetjen ndaj ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm (fetare dhe jo-fetare). Për këtë arsye, ky studim shqyrtoi profilin e të anketuarve që mbështetën një qasje të tillë dhe fushat ku qëndrime të tilla janë të pranishme në nivele më të larta sesa gjetkë.

Profilin e të anketuarve që mbështetën (3, dakord; dhe 4, plotësisht dakord) Pohimin 4 janë të ngjashme me ato të të anketuarve në favor të Pohimit 3 (për ligjin e Sheriatit). Kështu, 46.1 për qind e të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare janë në favor të këtij pohimi, me një përqindje të njëjtë që ishin kundër pohimit; 40.7 për qind e të intervistuarve nga zonat rurale janë në favor, krahasuar me 32.1 për qind në zonat urbane; ekziston një nivel më i lartë mbështetjeje (46-47%) për këtë pohim nga të anketuarit që kanë përfunduar arsimin fillor (8 ose 9 vjeçar) ose më pak apo pa arsim fare krahasuar me të intervistuarit me nivel më të lartë shkollimi (37%, me shkollë të mesme, 28%, me universitet, 25%, me diplomë pasuniversitare). Të anketuarit e papunë ofrojnë nivelin më të lartë të mbështetjes, me 45.5 për qind që janë dakord ose plotësisht dakord, në krahasim me 27 për qind të të anketuarve të punësuar. Afër 40 për qind e të anketuarve nga moshë 25-34 vjeç dhe 38 për qind e atyre të moshës 55-64 vjeç evidentuan një nivel më të lartë mbështetjeje sesa grupmoshat e tjera.

Gjeografikisht për Pohimin 4 ka pasur nivele të larta mbështetjeje në bashkitë Lezhë (87%), Librazhd (71%), Kurbin (61.5%), Kamëz (57%), Kavajë (57%), Elbasan (49%), Dibër (44%), Maliq (43%), Berat (38%), Gjirokastër (38%) dhe Krujë (37.5%). Është me interes



të theksohet se të gjithë të anketuarit në Cërrik dhe Përrenjas ishin në favor të këtij opsioni, siç ishin 90% e të anketuarve në Mirditë, Belsh, Klos, Gramsh dhe Bulqizë, megjithëse në këtë rast duhet të tregohet kujdes për shkak të madhësisë relativisht të vogël të vogël të kampionit (më pak se 20 të anketuar).<sup>54</sup>

*Si anëtare e NATO-s dhe vend kandidat për në BE që shpreson të hapë negociatat e anëtarësimit vitin e ardhshëm, Shqipëria po monitorohet nga afër nga aktorë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë në përpjekjet e saj për të konsoliduar shtetin ligjor dhe standardet demokratike. Pavarësisht shqetësimeve të shprehura në këtë drejtim, represioni i qeverisë dhe shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut nuk mbahen nën vëzhgim në Shqipëri. Gjithsesi, shqiptarët i mbajnë sytë nga standardet e demokracive perëndimore. Pothuajse tre dekada që nga rënia e diktaturës, zhgënjimi dhe mungesa e besimit në funksionimin e shtetit ligjor vazhdon t'i detyrojë shqiptarët të largohen nga vendi. Edhe pse nuk raportohen sjellje abuzive të institucioneve të zbatimit të ligjit për shkak të besimit fetar, perceptimet e të anketuarve që praktikojnë fenë, veçanërisht ata të arsimuar mirë dhe banorët e zonave urbane, tregojnë për ekzistencën e sjelleve të tilla, ndonëse në përqindje shumë të vogla. Gati një e treta e të anketuarve nga bashkitë e Kukësit, Vlorës dhe Krujës besojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanëve. Perceptime të tilla nuk duhet të nënvlerësohen, pavarësisht përqindjeve të vogla të të anketuarve që janë plotësisht dakord me këtë pohim. Së fundi, ka shumë arsye për t'u shqetësuar në lidhje me Pohimin 4 “njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore.” Pothuajse 19 për qind e të anketuarve ishin plotësisht dakord me pohimin, veçanërisht ata që praktikojnë rregullisht ritet fetare, ato të grupmoshës 25-35 vjeç, banorët e zonave rurale, të papunët dhe ata me nivel të ulët arsimor ose pa arsim fare. Më shumë se gjysma e të anketuarve, të renditur sipas rënies së nivelit të mbështetjes, në Lezhë, Librazhd, Kurbin, Kamëz dhe Kavajë ishin dakord me këtë pohim së bashku me të gjithë të anketuarit në Cërrik dhe Përrenjas.*

### V.2.3. Pushtimi i huaj dhe dhunimi politik/ushtarak

**Pushtimi i huaj** —Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre.

**Dhunimi politik/ushtarak** —Ndërrhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.

Nxitësit “pushtimi i huaj” dhe “dhunimi politik/ushtarak” nuk përshkruajnë realitetin aktual të Shqipërisë. Në studimin “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM 2015) këta nxitës u shqyrtuan në tetë fusha specifike për nga perspektiva e parandalimit të fenomenit të luftëtarëve të huaj. Pas ndryshimeve të bëra në vitin 2014 në Kodin Penal që kriminalizoi pjesëmarrjen dhe rekrutimin në konflikte të armatosura jashtë vendit dhe pas miratimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit (2015), aktorët shtetërore dhe jo-shtetërore u angazhuan për marrjen e masave jashtë kontekstit të sigurisë për të parandaluar e ekstremizmin e dhunshëm dhe rekrutimin luftëtarëve të huaj.

54. Bashki të tjera me kampion të vogël (10-20 të intervistuar për bashki) por me përqindje të madhe janë edhe Mati (73%), Peqini (60%) dhe Rrogozhina (54%).



Aktorët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm kanë qenë tejet aktivë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Kjo ka sjellë rezultate pozitive, sepse raportohet që asnjë shtetas shqiptar nuk i është bashkuar konflikteve në Siri dhe Irak që nga fundi i vitit 2015. Sidoqoftë, gjatë dy viteve të fundit janë vënë re raste sporadike të përpjekjeve (të pasuksesshme) nga disa individë.<sup>55</sup> Procesi i faktorëve të dëmshëm që mundësojnë manipulimin e besimtarëve fetarë përmes mesazheve për dhunën dhe ngritjen e komuniteteve me qëndresë vazhdon.

Për të shqyrtuar këta nxitës, në këtë studim të anketuarit e sondazhit kombëtar u pyetën “Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?”.

### **Pushtimi i huaj**

Pohimi 1: Përfshirja ose nxitja e përfshirjes në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar.

Pohimi 2: Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët.

### **Dhunimi politik/ushtarak**

Pohimi 3: Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim.

Në vitin 2015, IDM vlerësoi pohimin e dytë dhe të tretë në studimin e saj “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri” (2015).<sup>56</sup> Ky studim shton një tjetër pohim (Pohimin 1) që bën të mundur vlerësimin e nivelit të mbështetjes së publikut për ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2014. Ashtu si në studimin e vitit 2015, dy pohimet e fundit synojnë të krahasojnë dy argumente të ndërlidhura që përdoren shpesh nga ekstremistët dhe rekrutuesit, të cilët nxisin besimtarët myslimanë t’i rikthejnë dinjitetin komunitetit të tyre fetar, teksa përhapin mesazhin se misionet ushtarake të Shqipërisë në vendet myslimane janë fyerje për Islamin.

#### **V.2.3.a. Nxitësi i pushtimit të huaj**

Me analizën krahasuese të dy pohimeve të kontrollit për nxitësin e parë (Pushtimi i huaj) synohet të identifikohen mospërputhjet në perceptimet e publikut mes mbështetjes së qytetarëve për misionet zyrtare ushtarake me të cilat Shqipëria ka kontribuar në vendet myslimane ose islamike dhe përqindjes së mosdakordësisë me ndalimin e qytetarëve për të marrë pjesë në konflikte të armatosura jashtë vendit me vullnetin e tyre të lirë dhe përmes rrjeteve të rekrutimit të EDH.


55. Raste të tilla iu raportuan ekipit hulumtues nga aktorë pranë komuniteteve fetare, përfshirë këtu edhe një rast që u parandalua nëpërmjet ndërmjetësimit të anëtarëve të IDM-së në mars 2018.

56. Në studimin e IDM 2015 pjesëmarrësit u pyetën nëse janë dakord apo jo me pohimin: “Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin fetar me çdo mjet brenda dhe jashtë kufijve”.





**Figura 36. Opinioni i të anketuarve për Pohimin 1 (N =1,581) dhe Pohimin 2 (N =1,580) për sa i përket pikëpamjeve për nxitësin 'Pushtimi i huaj' (%)**



Siç tregohet edhe në Figurën 36, pjesa më e madhe e shqiptarëve (71.9%) janë dakord se Përfshirja ose nxitja e përfshirjes në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar, me 15.7 për qind të të intervistuarve që nuk janë aspak dakord me pohimin. Nga ana tjetër, 58.4 për qind e të anketuarve nuk mendojnë se Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët, përkundër 13 për qind që mendojnë të kundërtën.

Janë shtatë për qind më shumë shqiptarë që nuk janë dakord me Pohimin 1, por që janë dakord me Pohimin 2. Diskutimet në fokus grupe dhanë shpjegime të ndryshme për këtë dallim, duke sjellë shpesh shembullin e krizës dhe luftës në Kosovë në vitet 1990 dhe konflikte të tjera që synonin përmirësimin e situatës për shqiptarët në vendet fqinje (Maqedoni, Serbia jugore). Në fakt, dallimi mes pohimit të parë dhe të dytë është se, ndryshe nga i pari, pohimi i fundit ka aspekt fetar, gjë që të bën të mendosh se besimtarët praktikantë fetarë do të dominonin grupin që i konsideron misionet ushtarake si fyerje (Pohimi 2), por jo domosdoshmërisht grupin që kundërshton ndalimin për të marrë pjesë në konfliktet e armatosura jashtë vendit (Pohimi 1).

Megjithatë, nuk ka dëshmi në analizën demografike të të anketuarve për përzgjedhjen e opsioneve përkatëse për të mbështetur një pretendim të tillë. Shumica e të anketuarve që nuk ishin dakord me pohimin e parë por që ishin dakord me të dytin janë të anketuarit që praktikojnë rregullisht ritet fetare ose ato kryesoret, ndërsa ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar nuk janë dakord me Pohimin 1, por janë dakord në një shkallë më të ulët me Pohimin 2. Nga të anketuarit që praktikojnë rregullisht ritet fetare, 31 për qind nuk janë dakord me pohimin e parë në kontrast me vetëm 19 për qind të atyre që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Nuk ka dallime të dukshme në kategoritë e tjera demografike (mosha, gjinia, statusi i punësimit, etj.), me përjashtim të arsimit, ku 42 për qind e të anketuarve me më pak se tetë ose nëntë vjet shkollë, ose pa arsim dhe 26 për qind e atyre që kishin përfunduar 8-9-vjeçaren nuk ishin dakord. Ndër të anketuarit që kishin përfunduar shkollën e mesme, 21 për qind nuk ishin dakord, ndërsa ata me arsim të lartë kishin përqindje edhe më të vogël (17%, të anketuarit me universitet, 12%, ata me diplomë pasuniversitare).

Dallime të vogla vihen re tek të anketuarit sipas praktikimit të besimit fetar. Në mënyrë të veçantë, 16.8 për qind e të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare dhe 13.5




për qind e atyre që praktikojnë ritet kryesore mendojnë se misionet ushtarake shqiptare në Afganistan dhe Irak janë një fyerje ndaj myslimanëve. Të njëjtin mendim kanë edhe 11.4 për qind e atyre që nuk i praktikojnë fare ritet fetare. Asnjë dallim i konsiderueshëm nuk u vu re tek të anketuarit sipas kategorive të tjera demografike (mosha, statusi i punësimit, arsimi, gjinia<sup>57</sup> e kështu me radhë).

### V.2.3.b. Nxitësi “dhunimi politik/ushtarak”

Siç u shpjegua edhe në fillim të këtij seksioni, dhunimi politik/ushtarak nuk përshkruan realitetin shqiptar. Megjithatë, studimi i IDM-së 2015 dhe ky studim analizuan perceptimet publike, veçanërisht ato të besimtarëve fetarë, me qëllim vlerësimin e mbështetjes që mund të sigurojnë mesazhet e dhunshme të mundshme me anë të nevojës së perceptuar për rikthimin e dinjitetit fetar.

Siç tregohet edhe në Figurën 37, 21.8 për qind e të anketuarve janë plotësisht dakord me pohimin “Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim.”<sup>58</sup>

**Figura 37. Perceptimi i të anketuarve për detyrën e çdo besimtari që të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim (%; N = 1,584)**



Pothuajse gjysma e të gjithë të anketuarve që praktikojnë rregullisht fenë (49%) ose praktikojnë ritet kryesore (50%) janë dakord me këtë pohim (plotësisht dakord dhe dakord) në krahasim me 30 për qind të të anketuarve që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Ndër të anketuarit nga zonat rurale 48 për qind u shprehën dakord, së bashku me 51 për qind të atyre që kishin përfunduar arsimin tetë ose nëntë vjeçar dhe 49 për qind e atyre që kishin më pak se tetë ose nëntë vjet shkollë apo pa arsim fare. Pak më shumë se gjysma (52%) e të anketuarve të papunë ishin plotësisht dakord ose dakord me Pohimin 3, ndërkohë tek grupet e tjera të punësimit niveli shkonte nga 32 për qind në maksimumin 42 për qind. Nuk kishte dallime të rëndësishme për sa i përket

57. Ndërsa përqindjet kumulative mbi jam dakort dhe nuk jam dakort janë mjaft të ngjashme midis burrave dhe grave, këto të fundit kanë një përqindje pak më të lartë (rreth 5%) të përgjigjeve nuk e di. Kjo vihet re edhe në përgjigje të tjera.

58. Edhe pse pohimi nuk thotë shprehimisht ‘mjete të dhunshme’, shprehja në shqip ‘me çdo mjet dhe çmim’ nuk i përjashton ato.



mbështetjes për këtë pohim mes grupmoshave të ndryshme dhe gjinive.

*Ndonëse asnjë nga dy nxitësit nuk e përshkruan realitetin shqiptar, analiza e mësipërme nxjerr në pah disa çështje që duhen trajtuar seriozisht në lidhje me një kërcënim të mundshëm nga mesazhet e dhunshme që përhapin keqinformim dhe ndoshta nxisin ndjenjat e rrezikimit të dinjitetit dhe vlerave fetare. Besimtarët fetarë janë padyshim në rrezik më të madh, duke pasur parasysh qëndrimin e tyre ku shprehen se nuk janë dakord me pohimin e parë “Përfshirja ose nxitja e përfshirjes në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar” dhe duke u prirur të mbështesnin dy pohimet e tjera “Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët” dhe “Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim.” Dy pohimet e fundit lidhen ngushtë me disa nga nxitësit kulturorë, për të cilët besimtarët fetarë janë mjaft të ndjeshëm dhe më të hapur ndaj mesazheve të caktuara. Niveli arsimor i të anketuarve është një tjetër faktor i rëndësishëm që mund të jetë tregues i komuniteteve në rrezik. Kështu, të anketuarit që kanë përfunduar arsimin tetë ose nëntëvjeçar ose që kanë nivel më të ulët arsimor apo janë pa arsim fare priren të mbështesin pikëpamjet që kundërshtojnë ndalimin për nxitjen dhe pjesëmarrjen në konflikte të armatosura, që i konsiderojnë misionet ushtarake si fyerje për myslimanët dhe që vlerat fetare dhe dinjiteti duhet të mbrohen me çdo mjet dhe çmim. Edhe të anketuarit nga zonat rurale dhe të papunë priren të bien dakord, në përqindje më të lartë, me pohimin e fundit.*

#### **V.2.4. Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta**

*Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet qytetar e apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i sulen elitave të pamoralshme qeverisëse.*

Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria për elitat me lidhje të forta politike dhe ekonomike kanë qenë sfidat më të mëdha të Shqipërisë për vite me radhë. Strategjia për Zgjerimin me Vendet e Ballkanit Perëndimor i Komisionit Evropian për herë të parë i referohet “elementëve të qartë të kapjes së shtetit” kur përcakton sfidat ndaj shtetit ligjor në vendet e rajonit, përfshirë këtu edhe Shqipërinë:

*Sot, shtetet tregojnë elemente të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë këtu lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe një përzierje të fortë të interesave publike me ato private. E gjithë kjo ushqen një ndjenjë mosndëshkimi dhe pabarazie.*

**Komisioni Evropian, shkurt 2018**<sup>59</sup>

Lufta kundër korrupsionit ka qenë një nga karakteristikat më performancën më të dobët të Shqipërisë gjatë dhjetë viteve të fundit, sipas raportit të Freedom House

59. “Perspektiva e besueshme e zgjerimit dhe rritja e angazhimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.” Komisioni Evropian COM(2018) 65 final, f. 3. Burimi: [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)



“Shtetet në Tranzicion”.<sup>60</sup> Ndërkohë, renditja e vendit u përkeqësua në vitin 2017, sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, nga vendi i 39-të në vitin 2016 në vendin e 38-të në vitin 2017.<sup>61</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2018) vëren se “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz”.<sup>62</sup> Lufta kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmëria mbeten përparësi dhe kusht kryesor për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Në konkluzionet e Këshillit të Evropës (qershor 2018) theksohet se “Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet e saj në të gjitha këto fusha dhe të sigurojë që edhe në luftën kundër korrupsionit të arrihen rezultate të tjera të prekshme si dhe të çmontohen rrjetet e krimit të organizuar”.<sup>63</sup> E kushtëzuar me përparimin në reformën gjyqësore dhe në luftën kundër korrupsionit, Shqipëria mund të nisë negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian nga fundi i vitit 2019.

Duke pasur parasysh një kontekst të tillë, realiteti i mosangazhimit dhe apatisë politike në Shqipëri për shumë vite nuk është i papritur. Vazhdimi i reformës gjyqësore dhe rezultatet e para të kohëve të fundit për largimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar dhe me lidhje me rrjetet kriminale përbëjnë shpresën e vetme që shqiptarët të rikthejnë besimin tek institucionet dhe shteti ligjor.<sup>64</sup> Një shpresë e tillë, po aq sa niveli i zhgënjimit deri tani, janë të pranishme gjerësisht tek shqiptarët pavarësisht gjendjes së tyre sociale, ekonomike apo tjetër. IDM (2015) vëren se “Duke pasur parasysh traditën e fortë laike të vendit, perceptimet publike për qeverisjen dhe korrupsionin nuk lidhen domosdoshmërisht me vlerat fetare.” Në fakt, një studim i kohëve të fundit për tolerancën fetare në Shqipëri (2018) tregon se rreth 70 për qind e të anketuarve pranonin se nuk kishte shumë rëndësi se çfarë besonin për sa kohë që ata bënin një jetë me moral. “Çuditërisht, kjo gjetje vllente edhe për besimtarët praktikantë; pjesa më e madhe e besimtarëve fetarë që deklaruan se luteshin/faleshin rregullisht ose me rastet e festave fetare besonin gjithashtu se morali ekzistonte edhe jashtë fesë.”<sup>65</sup>

Në këtë studim jepen dy pohime për nxitësin “korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta”, si më poshtë:

- Pohimi 1: Vendet me besim fetar të fortë kanë qeveri më pak të korruptuara.
- Pohimi 2: Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi.


Perceptimet e të anketuarve për këto dy pohime jepen në Figurën 38, ku tregohet perceptimi se me fenë lidhet më ngushtë drejtësia sesa rënia e korrupsionit. Megjithatë,

60. Shih ‘Shtetet në tranzicion 2018, Shqipëria. Burimi: [https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018\\_Albania\\_o.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018_Albania_o.pdf)
61. Shih ‘Indeksi i perceptimit të korrupsionit 2017, Transparency International. Burimi: [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2017#table](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017#table)
62. Shih Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2018, f. 6. Burimi: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>
63. Shih Këshilli i BE-së, Konkluzionet për zgjerimin dhe Procesi i Stabilizim-Asocimit (Shqipëria). Burimi: <http://www.consilium.europa.eu/media/35863/st10555-en18.pdf>
64. Balkan Insight, 25 korrik 2018 “Vetting Process Leaves Albanian Courts Unable to Work”. Burimi: <http://www.balkaninsight.com/en/article/vetting-process-leaves-albanian-courts-unable-to-work-07-18-2018>
65. Shih Vurmo Gj. et al “Toleranca fetare në Shqipëri” (IDM 2018). p. 63. Burimi: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf>



të anketuarit ndahen njësoj mes përgjigjeve “Jam dakord”, “Nuk jam dakord”, “S’ka lidhje” dhe “Nuk e di” në këto dy raste. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve mendojnë se secili prej këtyre pohimeve është pa lidhje (Pohimi 1, 18%, Pohimi 2, 22.5%) ndërsa 15 për qind (për korrupsionin) dhe 11 për qind (për drejtësinë) nuk shprehën asnjë mendim, që mes tyre përfaqësojnë mesatarisht rreth 1/3 e shqiptarëve.

**Figura 38. Opinioni i të anketuarve për Pohimin 1 (N =1,570) dhe Pohimin 2 (N =1,579) në lidhje me pikëpamjet për nxitësin ‘korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta’ (%)**



Pjesa më e madhe e të anketuarve (23.5%) besojnë se “Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi.” Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve (22.4%) nuk janë aspak dakord me pohimin e parë. Edhe pse dallimet mes përqindjeve janë fare të vogla, në përgjithësi ka më shumë shqiptarë që mbështesin pohimin e dytë (35.5%) sesa pohimin e parë (31.4%).

Në mënyrë të parashikueshme, sa më fetarë të jenë intervistuarit aq më i lartë është niveli i mbështetjes për të dy pohimet, me 54.5 për qind të të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare që janë dakord me pohimin e parë dhe 65.5 për qind që janë plotësisht dakord ose dakord me pohimin e dytë. Niveli i dakordësisë bie në rreth një të pestën tek të anketuarit që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Edhe të anketuarit femra dhe ata nga zonat urbane tregojnë nivele më të larta të dakordësisë me të dy pohimet në krahasim me të anketuarit meshkuj dhe të intervistuarit nga zonat rurale. Megjithatë, përqindja e grave që janë dakord me pohimin e parë është më e ulët se përqindja që nuk janë dakord. E njëjta gjë vihet re edhe tek të anketuarit urbanë për pohimin e parë. Të anketuarit që kanë mbaruar arsimin tetë apo nëntë vjeçar duket se besojnë më shumë tek lidhja mes besimit fetar dhe mungesës së korrupsionit në shoqëri (Pohimi 1), por edhe tek lidhja mes besimit fetar dhe drejtësisë në Shqipëri (Pohimi 2). Është interesante të evidentohet se për pohimin e parë sa më i ulët niveli arsimor i të anketuarve aq më e lartë përqindja e përgjigjeve “Nuk e di”. Megjithatë, një gjë e tillë nuk vihet re tek Pohimi 2.

Së fundi, të anketuarit e moshës 35-44 vjeç kanë përqindjen më të lartë të përgjigjeve “plotësisht dakord” dhe “dakord” me pohimin “Vendet me besim fetar të fortë kanë



qeveri më pak të korruptuara”. E njëjta grupmoshë (35-44 vjeç) si dhe të anketuarit e moshës 55-64 vjeç treguan nivel më të lartë dakrodësie me Pohimin 2.

*Performanca e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë për elitat politike, ekonomike dhe elitat e tjera me lidhje të forta konsiderohet si thembra e Akilit për shtetin ligjor në vend dhe veçanërisht për besimin e qytetarëve tek sistemi i qeverisjes, institucionet shtetërore dhe për angazhimin politik. Siç shtjellohet edhe në analizën e kontekstit për këtë nxitës, treguesit e performancës në këtë kontekst kanë qenë tradicionalisht më të dobët në rreth tre dekadat e fundit, pavarësisht përmirësimeve gjatë këtyre viteve. Ndonëse nga analiza e të dhënave të sondazhit evidentohet ndjeshmëri më e madhe mes besimtarëve fetarë kur bëhet fjalë për besimin fetar dhe gjasat për qeverisje më pak të korruptuar dhe më shumë drejtësi në Shqipëri, më shumë se gjysma e shqiptarëve ose nuk e besojnë ose e konsiderojnë si pa lidhje një paradigme të tillë. Elitat e korruptuara dhe pandëshkueshmëria janë dimension i debatuar për shumë kohë në demokracinë e Shqipërisë. Mosbesimi publik, mosangazhimi i qytetarëve, apatia dhe zhgënjimi politik janë përgjithësisht të pranishëm tek shqiptarët, pavarësisht përkatësisë fetare ose nivelit të ushtrimit të fesë, ndërkohë që shkaqet rrënjësore e faktorët si dhe zgjidhja e këtyre sfidave shkojnë shumë përtej fesë. Në fakt, institucionet fetare në Shqipëri janë institucionet më të besuara në vend - 76 për qind e shqiptarëve i besojnë ato ndërkohë që i konsiderojnë gjykatat dhe partitë politike si institucionet më të korruptuara.<sup>66</sup> Prandaj, ka shumë pak gjasa që ideologjitë ekstremiste fetare të kenë sukses në zgjerimin e bazës së mbështetësve të tyre dhe ta paraqesin veten si një alternativë e drejtë përkundër elitave qeverisëse të pamoralshme. Në fakt, niveli më i madh i rrezikut vjen nga ideologjitë politike populiste dhe ekstremiste dhe jo nga mesazhet fetare të ekstremizmit të dhunshëm.*

#### **V.2.5. Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët**

*Këto zona janë të izoluara, rajone me dendësi të ulët popullsie dhe që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Duhet të kuptohet se grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të tërhiqen drejt “shteteve me forcë të kufizuar”, në krahasim me shtetet e dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer operacionet.*

Të dhënat për luftëtarët e huaj nga Shqipëria dhe shkatërrimi i rrjetit të nëntë rekrutuesve të dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda në vitin 2016 mbështesin arsyetimin e këtij nxitësi, por vetëm deri në një farë mase. Ndonëse shumë nga luftëtarët e huaj dhe rekrutuesit e dënuar janë me origjinë nga zonat e largëta (zonat rurale të Librazhdit, Pogradecit, Dibrës, etj.) ata banonin dhe vepronin edhe në periferi të qendrave kryesore urbane, si Tiranë.

Një tjetër çështje që ishte veçanërisht e pranishme në zonat e qeverisura keq dhe të largëta në Shqipëri ishte përhapja e kultivimit të kanabisit. Gjatë tre viteve të fundit janë kryer operacione të mëdha policore kundër rrjeteve të mirëfillta kriminale në vend, shpeshherë në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit nga vendet e BE-së. Duke

66. Shih “Besimi në qeverisje 2017, (IDM mars 2018) f. 5. Burimi: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/03/IDM-OpinionPoll-2017-AL-web.pdf>






pasur parasysh presionin e lartë që vjen nga BE dhe partnerët e tjerë perëndimorë për të luftuar krimin e organizuar, përmirësimi i shërbimeve publike duket se është lënë pas dore. Ndonëse zonat e izoluara që janë të qeverisura dobët apo të paqeverisura nuk janë problem në Shqipëri, ky studim përpiket të shqyrtojë rëndësinë dhe shtrirjen e dominimit të “shtetit si autoritet për zbatimin e ligjit” kundrejt “shtetit si ofrues shërbimi” në perceptimet e shqiptarëve. Qëllimi i kësaj zgjedhjeje është shqyrtimi i rreziqeve nga mesazhet e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm por edhe i hapësirës për grupet të tilla për të mbushur çdo boshllëk në ofrimin e shërbimeve publike cilësore në zona të caktuara. Përveç kësaj, studimi shqyrton praninë e shtetit në zonat rurale si dhe perceptimet e publikut për nevojën për të monitoruar aktivitetet fetare në Shqipëri.

Kështu, të anketuarit e këtij sondazhi mbarëkombëtar u pyetën se sa ishin dakord me pohimet e mëposhtme:

Pohimi 1:	Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.
Pohimi 2:	Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezencë e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët.
Pohimi 3:	Prezencë e “shtetit” si ligjzbatues dhe ofrues i shërbimeve publike është më e ulët në fshat sesa në qytete.

Të anketuarit janë të ndarë në pohimin e parë. Një numër pak më i madh i të anketuarve nuk ishin aspak dakord (28%) krahasuar me ata që ishin plotësisht dakord se aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti (27%) dhe një përqindje pak më e madhe ishin dakord ose plotësisht dakord (45%) sesa ata që nuk ishin dakord ose aspak dakord (43%). Rreth 9 për qind e të anketuarve nuk dhanë mendim për këtë pohim dhe 3 për qind mendojnë se pohimi “s’ka lidhje”. Me këtë pohim ishin dakord më shumë të anketuar që praktikojnë fenë, ata të moshës 18-35 vjeç dhe të anketuarit mbi 65 vjeç, të intervistuarit që jetojnë në zonat urbane dhe të papunët.

**Figura 39. Opinioni i të anketuarve nëse aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti (%; N = 1,576)**





Edhe pse sondazhi nuk dha përgjigje përfundimtare për këtë pohim, në diskutimet në fokus grupe u dhanë më shumë mendime për monitorimin e aktiviteteve fetare në Shqipëri. Pjesëmarrësit në këto diskutime ishin përgjithësisht në favor të një monitorimi më nga afër të aktiviteteve fetare në vend edhe pse nuk binin dakord se kush duhet të ngarkohej me këtë detyrë. Një temë tjetër që shkaktoi debat mes pjesëmarrësve të fokus grupeve ishte përkufizimi i aktiviteteve fetare. Shumë prej pjesëmarrësve ngritën shqetësime në lidhje me trajnimet, kampet verore, aktivitetet kulturore dhe aktivitete të tjera argëtimi të organizuara nga organizatat fetare<sup>67</sup> që synojnë të rinj duke filluar nga një moshë shumë e re (13-14 vjeç) e që shërbejnë si pikë takimi me fenë.<sup>68</sup> Nga ana tjetër, një zyrtar i një komuniteti fetar pohoi se: “Autoritetet zyrtare fetare marrin përgjegjësinë e plotë për aktivitetet që organizojnë vetë ato, por nuk e kemi të gjithë informacionin për aktivitetet e organizuara nga organizatat bamirëse fetare dhe organizata të tjera.” Në përgjithësi, pjesëmarrësit e diskutimeve në fokus grupe mendonin se monitorimi i veprimtarive të organizatave bamirëse dhe organizatave fetare duhet të kryhet kryesisht nga autoritetet fetare të regjistruara, duke qenë se këto të fundit kanë kapacitete më të mira sesa autoritetet shtetërore për monitorimin e cilësisë së aktiviteteve fetare. Nga ana tjetër, disa pjesëmarrës në fokus grupin me besimtarët fetarë ngritën shqetësime për monitorimin nga institucionet e sigurisë dhe policia.

Prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese duke e lënë funksionin e tij si ofrues i shërbimeve publike u konfirmua nga një shumicë mjaft e madhe (rreth 70%) e të anketuarve.<sup>69</sup> Nuk u vunë re dallime të konsiderueshme mes grupeve të ndryshme për sa i përket dakordësisë me pohimin me përjashtim të të papunëve dhe të anketuarve nga zonat rurale, ndër të cilët ka pasur një përqindje më të lartë mbështetjeje sesa te nënkategoritë e tjera.

---


67. Pjesëmarrësit e fokus grupeve shpesh iu referuan Dëshmitarëve të Jehovait si dhe organizatave të tjera bamirëse, të krishtera apo myslimane.

68. Ky informacion u konfirmua nga pjesëmarrësit në dy fokus grupe: me besimtarë praktikantë (2 korrik 2018) dhe me të rinj (26 qershor 2018).

69. Një perceptim i tillë ishte i pranishëm në pjesën më të madhe të bashkive të vogla e mesatare, ndërkohë që bashkitë e tjera të mëdha janë nën mesataren kombëtare.




**Figura 40. Opinioni i të anketuarve për prezencën e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët (%; N = 1,581)**



Një përqindje edhe më e lartë e të anketuarve vunë re se shteti është shumë më pak i pranishëm në zonat rurale se në qytete të vogla apo të mëdha (Pohimi 3).

**Figura 41. Opinioni i të anketuarve për praninë e shtetit në zonat rurale krahasuar me qytetet (%; N = 1,579)**



Ashtu si në rastin e Pohimit 2, të anketuarit që treguan një nivel më të lartë dakordësie ishin ata nga zonat rurale dhe të papunët, ndërkohë që dallimet në kategoritë e tjera demografike (gjinia, praktikimi i riteve fetare, mosha, arsimi, etj.) ishin të pakonsiderueshme.

*Lidhja e nxitësit “Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët” me ekstremizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm është e paqartë. Nga njëra anë është e vërtetë se organizata*



*bamirëse dhe shoqata të dyshimta fetare kanë përdorur në të kaluarën mungesën e shërbimeve publike në zona të largëta për të synuar të rinjtë dhe qytetarët që kanë probleme social-ekonomike. Të anketuarit në këtë studim tërhoqën vëmendjen tek nevoja për monitorimin e aktiviteteve fetare ku përfshihen të rinj, veçanërisht kur organizohen nga organizata bamirëse jashtë autoritetit të bashkësive fetare zyrtare. Edhe pse Shqipëria në vitet e fundit ka ndërmarrë hapa drejt përmirësimit të shërbimeve publike, është e rëndësishme të theksohet se po merr gjithnjë e më shumë rëndësi cilësia dhe jo thjesht ekzistenca e shërbimeve publike. Arsimi cilësor për të rinjtë është çështje që përbën shqetësim më të madh në zonat rurale dhe sigurisht për njerëzit që përballen me probleme ekonomike, që të marra së bashku nxjerrin më në pah pabarazitë ekzistuese dhe krijojnë kushte për t'i trashëguar ato tek brezat e rinj (nga familjet me të ardhura të ulëta, zonat rurale, etj.). Institucionet shtetërore, kryesisht në sektorin e sigurisë, monitorojnë aktivitetet fetare, veçanërisht ato të komunitetit dhe organizatave islamike. Vetë pjesëmarrësit besimtarë praktikantë të një fokus grupi e mirëpritën monitorimin që do të përmirësonte cilësinë e shërbimeve, performancën dhe informacionin fetar të ofruar nga organet përkatëse. Përkundër kësaj nevojë, mbikëqyrja dhe monitorimi nga institucionet e sigurisë pa përpjekje nga aktorë të tjerë shtetërorë (jo të sigurisë) për t'iu përgjigjur shqetësimeve të besimtarëve fetarë do të përkeqësonte perceptimet e diskriminimit. Kjo shpjegon në një farë mase rezistencën e të anketuarve të sondazhit që praktikojnë fenë për të rënë dakord me monitorimin shtetëror të aktiviteteve fetare.*

#### **V.2.6. Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm**

*Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre.*

Nxitësi i frikësimit apo kërcënimit nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm nuk përkrahen realitetin shqiptar. Përvoja e viteve të fundit e rekrutimit të luftëtarëve të huaj në vend tregon se procesi ka qenë i fshehtë por, gjithsesi, jo detyrues. Megjithatë, nuk është kërcënimi i hapur, por format e fshehta të shtrëngimit ose edhe presioni i bashkëmoshatarëve që mund ta detyrojë një person të bashkohet ose të tolerojë ideologji radikale apo të ekstremizmit të dhunshëm në kontekstin e komuniteteve të mbyllura ose të izoluar. Po ashtu, Denoeux dhe Carter (2009) sugjerojnë se “niveli i presionit bashkëshoqëron ofrimin e disa shërbimeve të caktuara, përfitimeve ekonomike apo mundësive për punësim, dhe/ose aftësinë për të siguruar një shkallë të caktuar legjitimiteti duke e identifikuar vetveten me kauza popullore.”<sup>70</sup> Siç u shqyrtua për kategoritë e nxitësve social-ekonomikë (nevoja të papërmbyshura sociale dhe ekonomike), afërsisht 15 për qind e intervistuarve të sondazhit ishin plotësisht dakord se në komunitetet e tyre ekzistojnë grupe fetare që ofrojnë përfitime dhe privilegje ekonomike për anëtarët e tyre që praktikojnë fenë.

Për të vlerësuar këtë nxitës në kontekstin shqiptar, në këtë sondazh u synua të sigurohej përvojë personale e të anketuarve për të evidentuar nëse ata kanë vënë re: (1) ekstremistët fetarë në komunitetin e tyre dhe (2) presione ndaj besimtarëve fetarë që t'i bashkohen kauzave ekstremiste. Së fundi, në studim shqyrtohet prania dhe shkalla

70. Guilain Denoeux dhe Lynn Carter “Development Assistance and Counter-Extremism: A Guide to Programming.” (tetor 2009), f. 28.




e “kulturës së heshtjes” mes besimtarëve fetarë. Kështu, në sondazh iu kërkohet të anketuarve të tregonin se sa dakord ishin me pohimet e mëposhtme:

Pohimi 1:	Në zonën ku jetoj ka individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm me baza fetare.
Pohimi 2:	Në zonën ku banoj ka individë radikalë që u bëjnë presion besimtarëve t’i bashkohen kauzave ekstremiste.
Pohimi 3:	Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.

Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk ishin aspak dakord me pohimet e mësipërme, ndërkohë që 7-8 për qind ishin plotësisht dakord (Figura 42).


**Figura 42. Përqindja e përgjigjeve ‘plotësisht dakord’ dhe ‘aspak dakord’ tek të anketuarit për pohimet 1-3 të nxitësit “Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm”**



Rreth 65 për qind e të intervistuarve nuk e konfirmuan praninë e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në komunitetin e tyre, ndërkohë që 14.2 për qind ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim, ndërkohë që një tjetër 19 për qind nuk dha mendim për këtë pohim (Figura 43).



**Figura 43. Opinioni i të anketuarve për praninë e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në komunitetin e tyre (%; N = 1,580)**



Pavarësisht faktit nëse praktikojnë rite fetare dhe sa rregullisht, të anketuarit raportuan një prani jo të vogël (14%) të individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në komunitetin e tyre në të njëjtat përqindje, duke evidentuar kështu nivelin e ndërgjegjësimit tek shqiptarët. Gjithsesi, sa më praktikantë të jenë besimtarët, aq më shumë janë përgjigjet “nuk jam dakord” apo “aspak dakord” me këtë pohim. Nuk u konstatuan dallime të konsiderueshme në përqindjet e përgjigjeve “aspak dakord” apo “dakord” mes grupmohave të ndryshme. Megjithatë, përqindja e përgjigjeve “nuk jam dakord” apo “aspak dakord” me këtë pohim rritej me rritjen e moshës së të intervistuarve (nga 59% për 18–24 vjeçarët, tek 77% të atyre të moshës mbi 65 vjeç). Me këtë pohim nuk ishin dakord një numër më i madh të anketuarish nga zonat rurale, meshkuj, ata me arsim tetë apo nëntëvjeçar ose më pak si dhe të papunët krahasuar me grupet e tjera të përgjigjedhënësve.


Prania e më shumë individëve të tillë (me përgjigjet “jam dakord” dhe “plotësisht dakord”) u raportua nga të anketuarit në bashkitë Elbasan (38%), Shijak (35%), Kamëz (34%), Vlorë (31%), Kavajë (22%), Pogradec (22%), Durrës (19%) dhe Tiranë (16%).<sup>71</sup>

Pa ndonjë paragjykim për praninë ose jo të individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm me bazë fetare, më pak të anketuar (11.5%) mendonin se besimtarë radikalë ushtrojnë presion tek shokët e tyre për t’iu bashkuar kauzave ekstremiste.

71. Prani e lartë konfirmohet edhe në bashki të tjera me një numër më të vogël të anketuarish për bashki në këtë sondazh, si Klos (50%), Selenicë (33%) apo Vorë (36%).



**Figura 44. Opinioni i të anketuarve për praninë e presionit ndaj besimtarëve që t'i bashkohen kauzave ekstremiste (%; N = 1,580)**




Të anketuarit nga zonat rurale, meshkujt, ata me tetë ose nëntë vjet arsimit apo më pak, besimtarë praktikantë fetarë dhe të anketuarit e papunë prireshin të mos ishin dakord me këtë pohim krahasuar me të tjerët.

Një numër më i madh të anketuarish konfirmuan (me përgjigje “jam dakord” ose “plotësisht dakord”) një presion të tillë mbi besimtarët fetarë në bashkitë Shijak (40%), Vorë (36%), Elbasan (36%), Vlorë (34%), Krujë (29%), Kavajë (22%), Kamëz (16%) dhe Tiranë (12%).

Së fundi, mbi 70 për qind e të anketuarve nuk ishin dakord me Pohimin 3 përkundër afro 13 për qind që ishin dakord se një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare. Është me interes të evidentohet se përqindja e përgjigjeve “nuk e di” ishte vetëm 10 për qind në krahasim me gati 20 për qind për dy pohimet e para.

**Figura 45. Opinioni i të anketuarve për gatishmërinë e besimtarëve të denjë për të denoncuar anëtarët e komunitetit të tyre që kanë bindje ekstremiste fetare (%; N = 1,582)**



Kishte një përqindje më të lartë të përgjigjeve “dakord” dhe “plotësisht dakord” mes të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare, ata të moshës 35-44 vjeç, me diplomë pasuniversitare, të vetëpunësuar ose të papunë. Këto grupe duket se mendojnë se anëtarët e komunitetit të tyre fetare nuk duhet të denoncohen nëse kanë pikëpamjet ekstremiste fetare. Për kategoritë e tjera demografike (gjinia, vendbanimi) dallimet janë të parëndësishme.

Në analizën e nxitësit të diskriminimit shoqëror (nxitësi social-ekonomik V.1.3) u konstatua se rreth 30 për qind e shqiptarëve priren ta konsiderojnë mjekrën (për burrat) dhe shamitë/burkën (për gratë) si shenjë ekstremizmi. Nga një konstatim i tillë do të lindnin dyshime serioze se sa është përqindja e shqiptarëve që konfirmojnë praninë e ekstremistëve fetarë (Pohimi 1) dhe presionin ndaj besimtarëve fetarë (Pohimi 2). Megjithatë, demografia e të anketuarve që konfirmojnë këtë prani ndryshon nga ajo e të anketuarve që deklarojnë se mjekra ose mbulimi me shami është tregues i ekstremizmit fetar. Prania e ekstremistëve fetarë (Pohimi 1) konfirmohet njëjloj si nga të anketuarit që praktikojnë fenë ashtu edhe nga ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar, ndërkohë që presioni ndaj besimtarëve fetarë (Pohimi 2) konfirmohet kryesisht nga të anketuarit që nuk e njohin apo nuk e pranojnë ushtrimin e besimit fetar.

*Nga analiza e nxitësit “Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm” dalin çështje serioze në lidhje me praninë e individëve ekstremistë dhe përpjekjet e tyre për të ushtruar presion ndaj besimtarëve fetarë, siç dëshmohet nga të anketuar që janë të vetëdijshëm për ritet fetare dhe i praktikojnë rregullisht ato. Prania e të dy nxitësve (individëve dhe presionit) është në nivel më të lartë se mesatarja kombëtare në bashkitë Shijak, Vorë, Elbasan, Vlorë, Krujë, Durrës, Kavajë, Kamëz dhe Tiranë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, me përjashtim të Elbasanit dhe Tiranës, bashkitë e tjera nuk kanë qenë të përfshira në kuadër të veprimtarive për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në mënyrë të strukturuar në nisma të institucioneve shtetërore apo të shoqërisë civile në tre vitet e fundit. Trajtimi i shqetësimeve të tilla për praninë e individëve ekstremistë dhe të presionit ndaj besimtarëve fetarë nuk do të jetë i lehtë dhe nuk duhet të kryhet pa rolin drejtues të autoriteteve zyrtare fetare. Kjo faktin se shumica e atyre që besojnë se anëtarët ekstremistë të bashkësive fetare nuk duhet të denoncohen janë besimtarë fetarë që praktikojnë rregullisht ritet fetare. Autoritetet zyrtare fetare janë jo vetëm kontakti i besueshëm për të komunikuar me këta besimtarë fetarë, por ato janë edhe më të afta për të luftuar ndikimin dhe presionin me anë të argumenteve fetare.*

#### **V.2.7. Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane**

*Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ngatërrohet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit.*

Gjatë dy viteve të fundit, reforma gjyqësore në Shqipëri, e nxitur fuqimisht nga BE dhe SHBA, është sulmuar vazhdimisht nga elitat me lidhje të forta politike, ekonomike dhe me median që ndihen të kërcënuar nga kjo reformë. Gjithsesi, qëndrimi pozitiv i shqiptarëve ndaj “ndërkombëtarëve” mbetet përgjithësisht i paprekur. Shqipëria është





një nga vendet më pro-amerikane në botë<sup>72</sup> dhe shqiptarët e konsiderojnë BE-në, së bashku me OKB-në dhe NATO-n si institucionet ndërkombëtare më të besuara.<sup>73</sup> Në fakt, vlerësimi i besimit dhe miratimi i shqiptarëve për këto institucione qëndron shumë më lartë se besimi i tyre tek institucionet kombëtare.

Toleranca fetare në Shqipëri konsiderohet nga më shumë se 90 për qind e qytetarëve në vend si vlerë themelore e shoqërisë e rrenjosur thellësisht në traditën dhe vlerat qytetare të vendit.<sup>74</sup> Megjithatë, rritja e populizmit në mbarë botën dhe paragjykimet në vendet e BE-së, veçanërisht ndaj refugjatëve nga vendet myslimane, kanë arritur tek publiku në vend dhe kanë ndikuar tek opinionet e tyre. Në një kontekst të tillë, mesazhet e mundshme të ekstremistëve fetarë që e portretizojnë sistemin ndërkombëtar dhe Perëndimin si armik të botës islame mund të jenë një faktor tërheqës i fuqishëm. Për të shqyrtuar këtë nxitës, në këtë studim shqyrtohen perceptimet e shqiptarëve ndaj sistemit ndërkombëtar dhe Perëndimit, si në nivel global ashtu edhe në rajonin e Ballkanit, përfshirë këtu edhe perceptimet lidhur me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë sondazh të intervistuarit u pyetën sa dakord janë me pohimet e mëposhtme:

- |           |   |
|-----------|---|
| Pohimi 1: | Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame.  |
| Pohimi 2: | Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.                                   |
| Pohimi 3: | Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina & Maqedonia). |
| Pohimi 4: | SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina & Maqedonia).              |

Ndonëse shqiptarët priren të mos jenë dakord me “idetë e konspiracionit global”, ata duket se janë më pak skeptikë për ato lokale.


72. Sipas një ankete të Gallup International në vitin 2018, ShBA kishin miratim shumicë në vetëm tre vende të Evropës në 2017: Kosovë, që është në vend të parë në rajon dhe në botë për mbështetjen e udhëheqjes së ShBA-së; Shqipëria, që renditet e dyta në botë në këtë drejtim; dhe Polonia. Shih Balkan Insight “Kosovo Leads World in Cheering for Trump, Poll Shows.” (Kosova e para në botë për mbështetjen për Trumpin, thotë anketa) 18 janar 2018. Burimi: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-shows-highest-support-for-us-leadership-in-europe-poll-01-18-2018>

73. Shih “Besimi në qeverisje 2017, (IDM mars 2018) f. 5. Burimi: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/03/IDM-OpinionPoll-2017-AL-web.pdf>

74. Shih Vurmo Gj. at al. “Toleranca fetare në Shqipëri” (2018). Burimi: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/pressreleases/2018/04/25/undp-albania-study-on-religious-tolerance-reveals-that-religious-tolerance-is-broadly-valued-and-supported-by-albanian-citizens.html>




**Figura 46. Përqindja e përgjigjeve “plotësisht dakord” dhe “aspak dakord” tek të anketuarit për Pohimin 1 dhe Pohimin 2 të nxitësit “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane”**



Vetëm një në dhjetë të anketuar janë plotësisht dakord se strukturat globale janë një shpikje e Perëndimit për të sunduar vendet myslimane. Kjo shifër është pothuajse dyfishi i përqindjes që mendon se Perëndimi i trajton vendet ballkanike me shumicë të krishterë në mënyrë preferenciale.

Siç tregohet në Figurën 47, më shumë se gjysma e shqiptarëve priren të mos jenë dakord ose aspak dakord me pohimin e parë, ndërsa gati një e treta nuk kanë një mendim apo e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje.

**Figura 47. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se strukturat globale janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet myslimane (%; N = 1,579)**




Nga analizat e mëtejshme konstatohet se, në përgjithësi, dallimet kryesore mes demografisë së nënkategorive të ndryshme të të anketuarve janë në përgjigjet “nuk e di”. I vetmi dallim i rëndësishëm është mes të anketuarve që praktikojnë ritet fetare dhe



atyre që nuk praktikojnë rite. Edhe pse të dy grupet u shprehën “nuk jam dakord” në të njëjtin nivel (51-52%), ata që praktikojnë ritet fetare ranë dakord në përqindje më të lartë (21-24%) sesa ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (15%). Të anketuarit e moshës 18-24 vjeç, ose nga zonat rurale, femra, të papunë, që kishin përfunduar arsimin tetë apo nëntë vjeçar apo më pak vite arsim ose nuk kishin arsim fare, kishin përqindje më të lartë të përgjigjeve “nuk e di”. Dallimet mes nënkategorive që ishin dakord me këtë pohim janë më pak se pesë për qind.

Nga ana tjetër, më shumë se një e treta e të anketuarve (34.5%) ishin dakord me Pohimin 2: Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare. Përqindja e të anketuarve që nuk ishin dakord me këtë pohim ishte 42.7 për qind, që është më e ulët krahasuar me 51.5 për qind për pohimin e parë, që lidhet me Perëndimin dhe strukturat globale.

**Figura 48. Përqindja e mendimit të të anketuarve që vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare (%; N = 1,584)**




Nga ata që praktikojnë ritet kryesore fetare, 40 për qind janë dakord me pohimin, 5 për qind më shumë se ata që praktikojnë rregullisht dhe 9 për qind më shumë se ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Kategori të tjera me mbështetje të madhe për këtë pohim janë edhe ata të moshës mbi 65 vjeç, meshkujt, të vetëpunësuarit dhe të anketuarit me nivel arsimor më të ulët se 8-9 vjet apo pa arsim fare. Ndonëse të anketuarit meshkuj dhe femra dhanë përgjigjen “nuk jam dakord” në të njëjtën përqindje, tek të anketuarat femra u konstatuan përqindje më të vogla dakordësie (30%) me këtë pohim krahasuar me meshkujt (39%). Kjo është në sajë të faktit se ka më shumë femra se meshkuj për përgjigjen “nuk e di”.

Perceptimi publik në Shqipëri e identifikon Perëndimin me BE-në, me shtetet e saj anëtare dhe SHBA-të. Tradicionalisht, shqiptarët kanë idealizuar demokracitë e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të BE-së dhe mbështetja e tyre për BE-në dhe SHBA-në mbetet mjaft e lartë. Ndonëse BE dhe shtetet e saj anëtare kryesore kanë luajtur një rol mjaft aktiv në rajon gjatë dekadës së fundit, veçanërisht duke i nxitur vendet të kapërcejnë mosmarrëveshjet dypalëshe dhe të vendosin marrëdhënie miqësore, shqiptarët shfaqin më shumë mbështetje për SHBA-në, më të paktën për shkak të rolit të tyre gjatë viteve të përgjakshme 1990.




Figura 49 është ilustrim i këtij konteksti. Ka një numër më të madh shqiptarësh që nuk janë dakord me Pohimin 4 se SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina & Maqedonia) – krahasuar me ata që nuk janë aspak dakord me pohimin se BE ka qenë e padrejtë.

**Figura 49. Përqindja e të anketuarve që janë plotësisht dakord dhe aspak dakord për padrejtësinë në Ballkan nga BE dhe ShBA (%)**



Të marrë së bashku, afro 28 për qind e të anketuarve janë dakord me Pohimin 3 (Figura 50), ndërsa rreth 50 për qind nuk ishin dakord me këtë pohim, 8.3 për qind e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe një tjetër grup prej 14.4 për qind u përgjigjën “nuk e di”.


**Figura 50. Perceptimet e të anketuarve se Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (%; N = 1,586)**



Të anketuarit që praktikojnë fenë (rregullisht apo ritet kryesore), të rinjtë (18-24 vjeç) dhe të anketuarit me më pak se tetë apo nëntë vjet arsimim ose pa arsim fare, ishin më shumë dakord me këtë pohim sesa ato nga nënkategoritë e tjera

Përqindja e të intervistuarve që nuk ishin dakord se kishte trajtim të padrejtë ishte më e madhe në rastin e Pohimit 4 –SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane– sesa për Pohimin 3 (BE): rreth 56 për qind e të anketuarve nuk ishin dakord, ndërsa 21.6 për qind ishin dakord me pohimin.

**Figura 51. Perceptimet e të anketuarve SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (%; N = 1,587)**



Në kontrast me nivelin e padrejtësisë së perceptuar të BE-së, të anketuarit që praktikojnë rregullisht ritet fetare kanë përqindjen më të lartë të përgjigjeve “nuk jam aspak dakord” dhe “nuk jam dakord” (58%), kur u pyetën për trajtimin e padrejtë nga SHBA-të, krahasuar me nivelin prej 56 për qind të atyre që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Të anketuarit që praktikojnë ritet kryesore fetare priren të japin mbështetje për këtë pohim si dhe të anketuarit të moshës mbi 65 vjeç, ata nga zonat rurale dhe ata me më pak se tetë apo nëntë vjet shkollë ose pa arsim fare.

*Mes 10 dhe 18 për qind e shqiptarëve janë plotësisht dakord me pohimet e kontrollit të këtij sondazhi, duke bërë që të shqyrtohet edhe më tej nxitësi “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane”. Tendencat për të mbështetur perceptime të tilla bëhet më e fortë kur të anketuarit u pyetën në lidhje me kontekstin rajonal (Ballkanin) në vend të atij global (Pohimi 1) si dhe edhe më e fortë ndaj BE-së sesa ShBA-ve. Të anketuarit nga zonat rurale, ata që nuk i praktikojnë rregullisht ritet fetare dhe ata me më pak se tetë apo nëntë vjet arsim, janë më të prirur ta perceptojnë Perëndimin si të padrejtë. Mesazhet e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm rreth padrejtësisë së BE-së në kontekst Ballkani përbëjnë rrezik më të madh sesa mesazhet në kontekst global apo ato kundër ShBA-ve.*

### **V.2.8. Konkluzione për nxitësit politikë**

Nga tetë nxitës të analizuar në kategorinë e nxitësve politikë të ekstremizmit të



dhunshëm, gjashtë duket se përbëjnë kërcënim për kontekstin shqiptar.<sup>75</sup> Katër nxitës politikë të ekstremizmit të dhunshëm e vënë në pozicion tejte të rrezikshëm komunitetin e besimtarëve praktikantë fetarë: (1) Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut; (2) Pushtimi i huaj; (3) Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm; dhe (4) Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane. Dy nxitës të tjerë nga kjo kategori përbëjnë rrezik në kontekstin kombëtar: (1) Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile; dhe (2) Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta. Kërcënimi që shoqërohet me nxitësit politikë lind, në të shumtën e rasteve, nga argumente jo-fetare. Siç tregon edhe analiza, mosbesimi dhe zhgënjimi i publikut në përgjithësi si pasojë e kulturës së vazhdueshme të pandëshkueshmërisë, korrupsionit dhe drejtësisë selektive nxisin qëndrimet radikale tek shqiptarët pavarësisht devocionit të tyre fetar.

Nga analiza e profilit të të anketuarve që shfaqin qëndrime shumë shqetësuese për nxitësit politikë konstatohet se të anketuarit janë më së shumti nga zonat rurale, me nivel të ulët arsimor (fillor, më pak se 8 ose 9 vjet arsim, ose pa arsim), meshkuj, të papunë dhe ata të moshës 35 vjeç. Disa pohime kontrolli me fokus të veçantë në çështje të ndjeshme fetare (p.sh. diskriminimi) shpesh priren të gjejnë mbështetje edhe tek kategoritë e tjera të të anketuarve, si ata të grupmoshës 35-44 vjeç ose më të vjetër se 55 vjeç, ata me arsim të lartë dhe të vetëpunësuarit. Është interesant fakti se nuk ka dallime të konsiderueshme mes të anketuarve meshkuj dhe femra në shumë prej nxitësve politikë me dy përjashtime. Së pari, ndryshimin e sistemit politik me dhunë e refuzojnë më shumë gratë se burrat. Gjithsesi, gratë japin të njëjtën mbështetje si burrat për mundësinë e vetëgjyqësisë kur njerëzve u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore. Dallimi i dytë në perceptimet dhe qëndrimet e të anketuarve meshkuj dhe femra qëndron në faktin se një numër më i madh femrash zgjedhin përgjigjen “nuk e di” për një sërë pohimesh të ndjeshme siç janë: prania e individëve që nxisin ose mbështesin ekstremizmin fetar në zonën e tyre; Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame; komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politike dhe institucione shtetërore e kështu me radhë.

Duke pasur parasysh sfidat e shtetit ligjor dhe të qeverisjes demokratike në Shqipëri, ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm mund të materializohen, por mund të mos jenë domosdoshmërisht fetare. Prania e ekstremistëve dhe individëve fetarë që ushtrojnë presion ndaj besimtarëve fetarë për t’iu bashkuar kauzave ekstremiste konfirmohet në bashkitë Shijak, Vorë, Elbasan, Vlorë, Krujë, Durrës, Kavajë, Kamëz dhe Tiranë. Në shumë prej këtyre zonave (por edhe në bashkitë e tjera si Lezhë, Kukës, Kurbin, Përrenjas, Peqin, Pogradec, Bilisht, Librazhd) në studim identifikohen përqindje të konsiderueshme të të anketuarve që shfaqin qëndrime problematike dhe prire për të mbështetur mesazhet fetare dhe jo-fetare të ekstremizmit të dhunshëm.

Nxitësit politikë paraqesin kërcënime të mëdha, veçanërisht në lidhje me rreziqet që vijnë nga ideologjitë jo-fetare të ekstremizmit të dhunshëm, të tilla si politika populiste dhe politika të tjera ekstremiste. Edhe pse nuk ka gjasa që ideologjitë ekstremiste fetare të kenë sukses në zgjerimin e bazës së mbështetësve të tyre nëpërmjet përcimit të mesazheve që bazohen vetëm në nxitës politikë, ndërthurja e tyre me mesazhet fetare, si perceptimi i diskriminimit apo përjashtimi dhe keqtrajtimi për shkak të përkatësisë fetare, mund të vë në rrezik kategori të caktuara të besimtarëve fetarë.

75. Edhe pse ka çështje për t’u shqetësuar për dy nxitësit e tjerë, analiza i konsideron ato si kërcënime me rrezik të ulët për ekstremizmin e dhunshëm.



### V.3. Nxitësit kulturorë

Në shoqëritë laike të Evropës Perëndimore, ku feja ka humbur shumë nga ndikimi i saj në jetën e individëve, vihet re një prirje e “kulturalizimit të fesë”, me të cilin nënkuptohet vendimi i shteteve për të ruajtur norma dhe simbole të caktuara fetare (si p.sh. kryqëzimi) në sferën publike në emër të mbrojtjes së kulturës kombëtare ose kulturës së shumicës në shoqëri.<sup>76</sup> Pikëpamja e grupeve ekstremiste islamike përqendrohet në perceptimet e “islamit nën rrethim”, ose në perceptimin e diskriminimit të myslimanëve në vendet evropiane. Është e qartë se personat fetarë, pavarësisht se janë me lidhje të forta në komunitetet lokale, e konsiderojnë veten si pjesë të një bashkësie më të madhe besimtarësh dhe ndajnë kështu shqetësimet e bashkëbesimtarëve të tjerë. Në përgjithësi, identifikimi mbikombëtar i myslimanëve në Ballkan është mjaft i dobët, i lidhur më shumë me përvojat e ndryshme të formimit të kombit, modernizimit dhe laicizmi që kanë vazhduar në komb-shtete, si gjatë periudhës së komunizmit dhe ashtu edhe gjatë tranzicionit. Pas rënies së komunizmit, komunitetet myslimane në Ballkan u transformuan në masë të konsiderueshme, në forma të ndryshme, dhe kanë ri-negociuar pozicionet e tyre institucionale në shtetet përkatëse. Përfaqësimi i Islamit nga ana e tyre është i larmishëm dhe nxjerr në pah ndikimin e traditave lokale dhe kombëtare, proceset e evropianizimit si dhe rrymat globale. Komunitetet myslimane në Ballkan kanë pak lidhje transnacionale, kryesisht të përcaktuara nga etnia ose kombësia e përbashkët dhe nuk i përmbahen vizionit të Islamit “universalist”: “Burimi i umma-s (xhematit) si formë e identitetit politik ka qenë sporadik e jo sistematik dhe nuk u shndërrua kurrë në program ideologjik.”<sup>77</sup>

Megjithatë, në një botë globale, identitetet kulturore mbikombëtare mund të jenë tërheqëse për individët pavarësisht kontekstit vendor dhe kombëtar. Sipas Roy (2013),<sup>78</sup> brenda feve të mëdha botërore ekzistojnë lëvizje fundamentaliste dhe radikale që synojnë të shkëpusin fenë nga rrënjët e saj kulturore, duke e formatuar atë si “fe të pastër” dhe pastaj për të përhapur tek njerëzit dhe për t'i konvertuar ata, duke i shkëputur nga kultura e tyre origjinale dhe nga kulturat e huaja. Me fjalë të tjera, fundamentalizmi është një formë e dekulturizuar dhe deterritorializuar e fesë që i përshtatet globalizimit. Duke e paraqitur veten si rimishërim i idealit të një kalifati botëror, Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë u shndërrua në një pikë tërheqjeje për shumë myslimanë të radikalizuar nga e gjithë bota që besonin se po zhvillohej një xhihad botëror kundër Perëndimit. Për këtë arsye, në këtë studim përfshimë një seksion për nxitësit kulturorë për të vlerësuar perceptimet e të anketuarve për kërcënimet e mundshme ndaj identiteteve dhe stilit të jetesës. Pyetjet u bazuan në studimin e Denoux dhe Carter (2009), të cilët theksuan tre lloje nxitësish kulturorë që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare, si vijon: (1) perceptime të sulmeve dhe padrejtësive të vazhdueshme nga vendet perëndimore ndaj kulturës dhe vendeve myslimane; (2) perceptime të pushtimit dhe asimilimit të kulturës tradicionale të një vendi nga influenca të huaja moderniste, dhe (3) përpjekje proaktive të grupeve radikale për imponimin dhe përhapjen e nën-kulturës dhe rrymës së tyre të rreptë të Islamit mbi traditat dhe kulturat e tjera.<sup>79</sup>

76. Joppke, C. (2018) “Culturalizing Religion in Western Europe: Patterns and Puzzles.” *Social Compass*, vol. 65, nr. 2, f. 234–246.

77. Merdjanova, I. (2013) *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*. Oxford: Oxford University Press, p. 58.

78. Roy, O. (2013) *Holy Ignorance: When Religion and Culture Part Ways*. Oxford: Oxford University Press.

79. Denoux, G. dhe Carter L. (2009) “Development Assistance and Counter Extremism: A Guide to Programming”, United States Agency for International Development.





**Tabela 4. Nxitësit kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm**

NXITËSI	PËRSHKRIMI
<b>Islami nën rrethim</b>	<p>Ekziston një lidhje e fortë mes suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon Islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera.</p> <p>Shënim. Kjo duplikon dhe përforcon një nga nxitësit politikë, d.m.th., “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është krejtësisht i padrejtë dhe armiqësor ndaj shoqërive/popujve myslimanë”.</p>
<b>Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës</b>	<p>Popullata mund të perceptojë një kërcënim të përgjithshëm kulturor ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit personal dhe kolektiv.</p>
<b>Agjendat “Proaktive” fetare</b>	<p>Grupet që nxisin agjendat e tyre do të tentojnë të imponojnë versionin e tyre të Islamit, xhihadit, etj., tek popullatat vendase, duke dobësuar kështu strukturat dhe praktikat më të moderuara e më tolerante fetare. Kjo krijon kushtet për ekstremizmin e dhunshëm.</p>

Burimi: Denoeux dhe Carter (2009)

### V.3.1. Perceptimet e Islamit nën rrethim

*Ekziston një lidhje e fortë mes suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon Islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera.*

Ky nxitës kulturor lidhet me perceptimet se Islami dhe myslimanët sulmohen nga Perëndimi. Për shkak të konflikteve ku përfshihen myslimanë, në vende si Palestina, Siria, Iraku, Afganistani dhe gjetkë, teoritë ekstremiste të konspiracionit pretendojnë se fuqitë perëndimore po kërkojnë të nënshtrojnë dhe të poshtërojnë vetë Islamin. Këto perceptime rreth një komploti të vazhdueshëm perëndimor kundër Islamit dhe shoqërive myslimane janë të përhapura në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore (LMAV) për shkak të disa faktorëve, siç janë përvojat e kaluara të kolonializmit, konflikti izraelito-palestinez dhe dështimi i regjimeve arabe laike dhe nacionaliste për të realizuar zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve të tyre. Diktaturat dhe regjimet autokratike në rajonin e LMAV-së për të larguar përgjegjësinë e tyre dhe për të fajësuar të huajt për problemet sociale dhe për të ndërtuar legjitimitet përhapin perceptimet e sulmeve perëndimore ndaj myslimanëve.<sup>80</sup> Sipas disa rrymave fundamentaliste dhe

80. Gray, M. (2011) “Political Culture, Political Dynamics, and Conspiracism in the Arab Middle East”, in Graf, A, S. Fathi and L. Paul (eds.), *Orientalism and Conspiracy: Politics and Conspiracy Theories in the Islamic World*, London and New York, I. B. Tauris. f. 105–127.




xhihadiste, Islami kërcënohet jo vetëm nga Perëndimi, por edhe nga myslimanët tjerë që e kanë braktisur besimin dhe po veprojnë si agentë të Perëndimit në shoqëritë islamike. Indoktrinimi afatgjatë me ide të tilla mund të sjellë si rezultat sjellje ekstremiste, si bashkimi me luftëtarët xhihadistë në zonat e konfliktit.

Në studimin e IDM-së për ekstremizmin e dhunshëm (2015) raportohen raste të imamëve të vetëshpallur që predikonin urrejtje ndaj myslimanëve të tjerë shqiptarë, duke i quajtur hipokritë apo edhe qafirë (të pafe) dhe duke i akuzuar ata si bashkëpunëtorë me politikën e Perëndimit kundër Islamit. Ata predikojnë urrejtje ndaj feve të tjera si dhe kundër demokracisë, sepse sipas mendimit të tyre krijon iluzionin se qeniet njerëzore janë nën kontrollin e politikës, ndërkohë që është Zoti ai që vendos për çdo gjë.<sup>81</sup> Në këtë studimin i paraqitëm kampionit kombëtar të të anketuarve tre pohime për të vlerësuar rëndësinë e ndjenjave të “islamit nën rrethim”, si më poshtë:

Pohimi 1:	Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame.
Pohimi 2:	Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame.
Pohimi 3:	Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë.

Përgjigja pozitive për secilën nga dy pohimet e para mund të konsiderohet si mbështetje për idenë se shqiptarët e perceptojnë Perëndimin si agresor kundër kulturës islamike dhe se modeli i shoqërisë laike në Shqipëri diskriminon besimtarët e devotshëm fetarë që ushtrojnë fenë e tyre.

**Figura 52. Opinioni i të anketuarve nëse Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame (%; N = 1,585)**



Edhe pse pjesa më e madhe e të anketuarve nuk ishin dakord me Pohimin 1, gjithsesi, 25.6 për qind ishin dakord ose plotësisht dakord se shtetet dhe kultura islamike janë nën sulm nga Perëndimi. Analiza demografike e përgjigjeve nuk tregon ndonjë


81. IDM (2015) “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri.” Tiranë. f. 89–90.



ndryshim të rëndësishëm në përqindjen e të anketuarve që ishin dakord me pohimin. Megjithatë, vërehet një ndryshim në përqindjen e të anketuarve që nuk ishin dakord me pohimin, veçanërisht të intervistuarit e moshës mbi 55 vjeç, të intervistuarit nga zonat urbane, ata që kishin mbaruar vetëm shkollën e mesme dhe ata me status punësimit “tjetër” (kryesisht pensionistë). Dallimet mes kategorive të tjera demografike ishin më të vogla se pesë për qind. Dakordësia me deklaratën në përqindje mbi mesataren kombëtare u evidentua në këto bashki: Kavajë (61%), Shijak (40%), Kamëz (34%), Kukës (33%), Gjirokastrë (33%), Tiranë (31%), Divjakë (30%) dhe Durrës (27%).

Për pjesën më të madhe të të intervistuarve, të jesh besimtar fetar në Shqipëri nuk është e vështirë. Pavarësisht përqindjeve të vogla, ka një dallim mes përgjigjeve në lidhje me besimtarët myslimanë dhe të krishterë që praktikojnë fenë, me 10.3 për qind të të anketuarve që ishin dakord me Pohimin 2 dhe vetëm 5 për qind me Pohimin 3.

**Figura 53. Opinioni i të anketuarve (%) se në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman (N = 1,583) apo i krishterë (N = 1,581)**



Duke pasur parasysh përqindjet e vogla të përgjigjeve “plotësisht dakord” apo “dakord” me secilën nga dy pohimet e mësipërme, dallimet mes kategorive të ndryshme demografike janë të vogla. Sipër krahasim, duket se të jesh besimtar praktikant i fesë Islame në Shqipëri perceptohet të jetë më e vështirë se të jesh besimtar praktikant i fesë së krishterë. Nga intervistat e fokus grupeve me besimtarët fetarë u konstatua se gratë myslimane përjetojnë më shumë vështirësi në jetën e përditshme. Studimi i IDM për tolerancën fetare (2018) raporton raste të diskriminimit ose përjashtimit social të myslimanëve që praktikojnë besimin e tyre, por në përqindje të vogla,<sup>82</sup> që përputhen me një numër të vogël të anketuarish në këtë studim, të cilët ishin dakord se sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant.

*Përgjigjet për pohimin e nxitësit “Islami nën rrethim” tregojnë se identifikimi fetar në Shqipëri, përfshirë edhe fenë Islame, nuk lidhet me armiqësinë kundër Perëndimit. Pjesa më e madhe e besimtarëve nuk mendojnë se është e vështirë për ta të ushtrorjnë fenë e tyre, edhe*

82. IDM (2018) “Toleranca fetare në Shqipëri”, f. 7 “Afro 11 për qind e shqiptarëve kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast në komunitetin e tyre të diskriminimit fetar apo përjashtimit të njerëzve për shkak të përkatësisë fetare.” Burimi: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/04/Religious-tolerance-in-albania.pdf>

*pse raportohen raste sporadike të diskriminimit fetar. Megjithatë, pothuajse një e katërta e intervistuarve të sondazhit ishin dakord se Perëndimi po sulmon vazhdimisht Islamin. Ky qëndrim është më i fortë se mesatarja kombëtare prej 25.6 për qind, sidomos në bashkitë Kavajë (61%), Shijak (40%), Kamëz (34%), Kukës (33%), Gjirokastrë (33%) dhe Tiranë (31%).*

### V.3.2. Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës

*Popullata mund të perceptojë një kërcënim të përgjithshëm kulturor ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit personal dhe kolektiv.*

Kërcënimi kulturor perceptohet në formën e zbehjes së traditave “autentike” dhe gërryerjes së solidaritetit të grupit nga ndikimet kulturore që vijnë nga jashtë. Ringjallja e fesë në Shqipërinë postkomuniste u shoqërua me dyndjen e misionarëve dhe fondacioneve fetare të huaja që përpiqeshin t’i kthenin “ateistët” shqiptarë në fenë “e vërtetë” ose t’u mësonin atyre versionin e saktë të fesë përkatëse. Që në fillim të viteve 1990, në Shqipëri u ngritën shqetësime se në vend po prezantoheshin mësim dhe norma fetare që ishin të huaja për traditat fetare të vendit. Myslimanët shqiptarë, në veçanti, ndjenë presion që nga njëra anë që të respektonin rreptësisht rite dhe veshje të caktuara islame, siç kërkohej nga misionarët e huaj dhe, nga ana tjetër, të ruanin traditën islamike “vendase”. Në vitet 1990, më shumë se 90 për qind e buxhetit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) vinte nga burime të jashtme, kryesisht ndihmë nga organizatat islamike, të cilat shpesh këmbëngulnin të mësonin “islamin” e pastër tek besimtarët shqiptarë, të pastruar nga “ndotësit”. Përgjigja e KMSH-së ishte se dëshironte një traditë islame specifike për Shqipërinë apo Ballkanin që të ishte në harmoni me identitetin kombëtar, tolerancën fetare, modernizimin, demokracinë dhe integrimin evropian. Siç e tha edhe zëvendëskryetari i atëhershëm i KMSH-së: “Nuk kemi nevojë që të tjerët të na mësojnë besimin ... kemi nevojë për ndihmë për traditën tonë të besimit.”<sup>83</sup> Në nivelin komuniteti vendor, ndjenja e kërcënimit kulturor shprehet shpesh në debatin për ruajtjen e tolerancës dhe traditës fetare vendase nga ndikimet e formave fundamentaliste të Islamit. Për shembull, sipas një studimi etnografik në qytetin e Shkodrës, myslimanët lokalë i referoheshin besimit të tyre si “të qetë”, epitete që ia vunë qasjeve të përditshme pragmatike dhe të negociuara të fesë, ndërkohë që i quajtën “fanatike” dhe “të pakëndshme” manifestimet e huaja të besimit, të cilat i identifikuan si Islami “arab”.<sup>84</sup>

Në këtë studim, për të matur perceptimet për kërcënimet e formave tradicionale të praktikimit të fesë islame në Shqipëri, të anketuarit u prezantuan me pohimet e mëposhtme:

- |           |  |
|-----------|--|
| Pohimi 1: | Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator. |
| Pohimi 2: | Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe                          |

83. Elbasani, A. (2016) “State-organized Religion and Muslims’ Commitment to Democracy in Albania.” *Europe-Asia Studies*, vol. 68, issue 2, p. 262.

84. Tošić, J. (2015) “The Loudspeaker of Faith in the ‘Calm’ City”, in Elbasani, A. and O. Roy (eds.) *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*, Basingstoke, Palgrave Macmillan. pp. 95-97.




ekstremiste fetare në vend.

Pohimi 3: Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare jashtë vendit.

Pohimi 4: Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm.

Të anketuarit e këtij sondazhi duket se janë të ndarë në opinionet e tyre për pohimin e parë, me 38.2 për qind që janë dakord ose plotësisht dakord se besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator, me 33.2 për qind që ose nuk janë dakord ose aspak dakord me këtë pohim dhe 25 për qind që nuk dinë se si t'i përgjigjen këtij pohimi.

**Figura 54. Opinioni i të anketuarve nëse myslimanët në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator (%; N = 1,576)**




Të anketuarit më fetarë dhanë më shumë përgjigje “nuk jam dakord” krahasuar me ata më pak fetarë dhe laikë. Edhe pse në përqindje të njëjtë ose pak më të vogël se mesatarja kombëtare, perceptimet e të anketuarve që praktikojnë të gjitha ritet kryesore fetare ose ato kryesore janë të një rëndësie të veçantë duke qenë se ata janë në kontakt të përditshëm me pjesëtarët e bashkësive fetare dhe mundësi ndikimi. Prania e ndikimeve të tilla konfirmohet nga 28 për qind e të anketuarve që praktikojnë rregullisht dhe 36 për qind që praktikojnë ritet kryesore. Nga ana tjetër, 49 për qind dhe 39 për qind e këtyre të anketuarve, përkatësisht, shprehën mendim të kundërt.

Rritja e nivelit të arsimit ka korrelacion pozitiv me rritjen e nivelit të dakordësisë me pohimin, që do të thotë se të anketuarit më të arsimuar konfirmojnë në përqindje më të lartë ndikimet e huaja fetare tek myslimanët shqiptarë. Kur përgjigjet analizohen sipas statusit të punësimit, përqindja më e lartë e dakordësisë (37.1%) evidentohet mes të vetëpunësuarve dhe përqindja më e lartë e mosdakordësisë (41.2%) tek të papunët.

Pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk ishin dakord se Islami tradicional në Shqipëri po sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare në vend dhe jashtë vendit. Megjithatë, rreth 1/4 e të intervistuarve të këtij sondazhi ishin dakord ose plotësisht dakord me këto pohime. Kështu, 26.7 për qind konfirmuan sulmet nga grupet ekstremiste të huaja dhe 23.3 për qind sulmet nga grupet ekstremiste brenda vendit.



**Figura 55. Opinioni i të anketuarve (%) nëse Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare në vend (N = 1,575) dhe jashtë vendit (N = 1,574)**




Dallime të vogla vihen re mes nivelit të dakordësisë dhe mosdakordësisë për të dy pohimet sipas rregullsisë së praktikimit të riteve fetare të të intervistuarve të sondazhit, me përjashtim të nivelit të mosdakordësisë me pohimin e dytë (ndikimi i huaj) për të cilën të anketuarit që praktikojnë të gjithë ritet fetare priren të mos jenë dakord me përqindje më të lartë se ata që praktikojnë ritet kryesore ose që nuk praktikojnë asnjë rit fetar.

Nivel më i lartë i përgjigjeve “dakord” me pohimet 2 dhe 3 evidentohet tek të anketuarit nga zonat urbane sesa ata të zonave rurale, nga të anketuarit meshkuj më tepër se të anketuarit femra, nga atë më të arsimuar se sa të anketuarit më pak të arsimuar, të vetëpunësuar dhe studentë. Në një intervistë në fokus grupe (DFG4), një besimtar mysliman fajësoi rrymat e ndryshme fetare që vinin nga Turqia dhe Lindja e Mesme për kontradiktat që kanë me njëri-tjetrin myslimanët shqiptarë: “Secila prej këtyre rrymave vinte këtu me një ndjenjë superioriteti ndaj rrymave të tjera. Ata na hoqën traditat tona dhe na vunë rite të tjera në vend të tyre, rite që tani i kuptojmë se janë të gabuara.”

Njëzet për qind e të anketuarve mendonin se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm, ndonëse shumica dërrmuese - 62.1 për qind - nuk kanë të njëjtin mendim. Perceptimi i një kërcënimi ndaj komunitetit fetar është më i fortë mes të anketuarve që praktikojnë rregullisht rregullat dhe ritet fetare (25.6%) dhe të intervistuarit e moshës 35-44 vjeç (24.4%).



**Figura 56. Përgjigjet e të anketuarve për mendimin se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm (%; N = 1,575)**



Në përgjithësi, shumica e shqiptarëve nuk perceptojnë se ka kërcënime apo sulme të përgjithshme kulturore ndaj feve që praktikohen në vend. Kjo nuk do të thotë se ata nuk janë në dijeni të ekzistencës së ndikimeve negative nga jashtë mbi besimin islam në veçanti. Në mënyrë të veçantë mes të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet dhe rregullat fetare, ka mendime se feja e tyre, siç praktikohet tradicionalisht, sulmohet nga grupet ekstremiste brenda dhe jashtë vendit. Përveç kësaj, dy nga dhjetë shqiptarë besojnë se besimi, tradita dhe dinjiteti i bashkësisë së tyre fetare janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. Një pikëpamje e tillë është e pranishme më shumë mes besimtarëve që praktikojnë rregullisht ritet fetare.

### V.3.3. Agjendat “Proaktive” fetare

*Grupet që nxisin agjendat e tyre do të tentojnë të imponojnë versionin e tyre të Islamit, xihadit, etj., tek popullatat vendase, duke dobësuar kështu strukturat dhe praktikat më të moderuara e më tolerante fetare. Kjo krijon kushtet për ekstremizmin e dhunshëm.*

Kur flasim për marrëdhënien midis fesë dhe kulturës në kohët moderne, Roy (2015) bën dallimin mes dy qëndrimeve: akomodimizmi dhe fundamentalizmi. Grupet besimtare të akomodimizmit mendojnë se feja është e ngulitur në kulturë dhe se kultura e përbashkët është parakusht për ekzistencën e fesë. Për akomodimizmin, besimtari i një feje mund të ketë të njëjtën kulturë me një jobesimtar dhe besimtarë të feve të tjera. Fundamentalizmi kërkon ndarjen e fesë nga kultura. Në fakt, versioni fundamentalist i një feje të caktuar i kthehet kundër kulturës që e rrethon, e cila tashmë nuk konsiderohet më si laike, por si pagane. Nuk ka ma variacione mes besimtarit dhe jobesimtarit. Ndonëse është e mundur të flasim nga pikëpamja e të krishterëve apo myslimanëve agonistikë, laikë apo kulturorë, nuk mund të ketë Pentekostalistë, Salafistë apo Dëshmitarë të Jehovait agonistikë, laikë apo kulturorë. Fundamentalistët synojnë pastërtinë fetare, që do të thotë një version i fesë i pastruar nga gjurmët kulturore, pra e dukulturalizuar dhe rrjedhimisht e përbërë nga një grup rregullash dhe ritesh që duhet të jenë të vlefshme në çdo kulturë dhe në çdo situatë. Kështu,



interpretimi fundamentalist i fesë do të thotë fe e eksportueshme në një botë globale dhe të deterritorializuar. Dekulturalizimi i fesë krijon barriera mes besimtarit dhe jobesimtarit. Në sytë e besimtarit fundamentalist, këta pasues nominalë apo njerëzit laikë që ende e identifikojnë veten me një fe të caktuar janë në fakt jobesimtarë ose paganë; për jobesimtarin, besimtari paraqitet si fanatik.<sup>85</sup>

Në një studim për rrymat islamike në Shqipëri, Endresen (2015) argumenton se etiketimet akomodimist dhe fundamentalist i aplikohen pak a shumë formave tradicionale përkundër atyre salafiste të Islamit. Tradicionalistët e paraqesin veten si patriotë, properëndimorë dhe mbështetës të integritetit evropian. Ata e shoqërojnë Islamit me modernitetin dhe theksojnë përputhshmërinë e tij me demokracinë dhe vlerat evropiane. Salafistët aktualisht e gjejnë legjimitetin e tij tek njohuritë e teksteve autentike islamike dhe argumentojnë se myslimanët duhet të ndjekin rregullat e shkruara në shkrimet e shenjta dhe jo moralin shoqëror dhe traditën kulturore. Salafistët frymëzohen nga imamët sauditë që favorizojnë respektimin e rreptë të parimeve islame. Edhe pse salafistët i udhëzojnë besimtarët t'i binden shtetit dhe ligjeve të tij dhe mbështesin vlerat e familjes, ata janë kundër vlerave liberale, laicizmit dhe lirive të individit, duke i konsideruar ato si shpikje të Perëndimit dhe që janë të huaja për besimin islam. Salafistët e konsiderojnë kulturën shqiptare jo si anti-islamike, por si aset të vlefshëm, gjithsesi të ngrirë tek vlerat konservative dhe patriarkale. Ata e vënë theksin tek shpëtimi i individit me anë të respektimit të rreptë të besimit fetar në sjelljen e përditshme, si lutja, ushqimi dhe veshja. Ata janë të mprehtë për ta dalluar veten nga praktika të caktuara të "tradicionalistëve", si qëndrimi liberal ndaj riteve fetare, adhurimi i varreve të mjeshtërve sufistë apo njerëzve të mirë bektashi, konsumimin e ushqimit haram, etj.<sup>86</sup>

Edhe pse salafizmi nuk duhet të barazohet me sjelljen dhe dhunën ekstremiste, është e qartë se indoktrinimi i një versioni të ngurtë besimi që shkëput besimtarin nga kultura dhe shoqëria përreth mund t'i çojë individët dhe grupet drejt ekstremizmit fetar. Mundësia dhe kërcënimi i individëve dhe grupeve radikale që angazhohen në axhendë proaktive fetare në Shqipëri vlerësohen në këtë studim duke i paraqitur kampionit kombëtar të të anketuarve disa pohime, si më poshtë:

Pohimi 1:	Predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshtaten me tendencat moderne e perëndimore të vendit.
Pohimi 2:	Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë Islame.
Pohimi 3:	Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë se krishterë.

Edhe pse mosdakordësia me pohimin e parë nuk do të thotë domosdoshmërisht tokë pjellore për agjendën ekstremiste fetare, përgjigja "aspak dakord" është tregues i një komuniteti fetar disi konservator. Nga ana tjetër, përgjigjet pozitive ndaj pohimit të dytë dhe të tretë janë konfirmime të hapura të pranisë së grupeve që mbështesin

85. Roy, O. (2013) *Holy Ignorance: When Religion and Culture Part Ways*. Oxford: Oxford University Press. f. 7–8.


86. Endresen, C. (2015) "Faith, Fatherland or Both? Accommodationist and Neo-Fundamentalist Islamic Discourses in Albania", in Elbasani, A. and O. Roy (eds.) *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*, Basingstoke, Palgrave Macmillan. f. 222–241.



ekstremizmin e dhunshëm me bazë fetare.

Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.2%) ishin dakord me pohimin se predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshtaten me tendencat moderne e perëndimore të vendit. Megjithatë, pothuajse një e treta e të anketuarve nuk ishin dakord (13%) ose aspak dakord (18.2%) me këtë pohim, që do të thotë se ata nuk mendojnë se predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshtaten me tendencat moderne e perëndimore të vendit.

**Figura 57. Opinioni i të anketuarve se predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshtaten me tendencat moderne e perëndimore të vendit (%; N = 1,569)**




Ashtu siç pritej, të anketuarit fetarë treguan një nivel më të lartë mosdakordësie (37.9%) me pohimin sesa të intervistuarit më laikë, që nuk praktikojnë rite fetare (25.1%). Megjithatë, opinioni mbizotërues mes të anketuarve që praktikonin të gjitha ritet fetare (45%) ose ritet kryesore fetare (46%) ishte për dakordësi me pohimin. Gjatë intervistave të grupeve të fokusit disa besimtarë myslimanë thanë se ka kufizime për sa i përket përshtatjes së Islamit me prirjet perëndimore. Për shembull, predikimi në xhami duhet të kryhet në arabisht dhe jo në ndonjë gjuhë tjetër. Një mysliman tha se nuk kishte kuptim të flitej për përshtatjen e Islamit me Perëndimin, sepse Islami është një fe universale dhe është në përputhje me çdo kulturë. Prandaj, “Nëse nuk shkelen parimet e fesë, duhet ta përjetojmë Islamin sipas traditave dhe kulturës sonë dhe jo domosdoshmërisht të përshtatur me tendencat perëndimore.” Megjithatë, një mysliman tjetër (në DFG4) pranoi se “Islami në Shqipëri po ndryshon, duke marrë një pamje perëndimore dhe se praktikatat e tij fetare nuk janë dëmtuar.”

Të anketuarit më pak të arsimuar që nuk e kanë përfunduar ciklin tetë ose nëntëvjeçar prireshin më shumë të jepnin përgjigjen “nuk jam dakord” sesa “jam dakord” me pohimin (44.1% përkundër 35.6%), gjë që ishte përjashtim nga tendenca e përgjithshme në të gjitha nënkategoritë. Ky rezultat mund të shpjegohet me anë të qëndrimit më liberal që tregohet ndaj fesë nga njerëzit më të arsimuar.

Shumica e të anketuarve ose ishin dakord me ekzistencën e grupeve ekstremiste fetare, ose nuk kishin dijeni për këtë fenomen. Nga të anketuarit, 26 për qind pranuan ekzistencën e grupeve ekstremiste islamike dhe 18.8 për qind praninë e grupeve ekstremiste të krishtera. Megjithatë, përqindja që hodhi poshtë praninë e grupeve të krishtera me program ekstremist është disi më e lartë se ata që hodhën poshtë prezencën e grupeve ekstremiste islamike (46.9% dhe 42.2%, përkatësisht).



**Figura 58. Opinioni i të anketuarve për praninë e grupeve myslimane (N = 1,567) apo të krishtera (N = 1,575) që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë (%)**



Të anketuarit që praktikojnë ritet fetare tregojnë përqindje më të lartë të dakordësisë dhe mosdakordësisë me të dy pohimet krahasuar me ata të anketuar që kanë një qëndrim më liberal ndaj fesë. Të anketuarit që jetojnë në zonat urbane janë më shumë dakord se ata që jetojnë në zonat rurale. Të anketuarit meshkuj priren të jenë më shumë dakord se të anketuarit femra në lidhje me praninë e grupeve islamike me agjendë ekstremiste (28.7% dhe 23.2%, përkatësisht), ndërsa për grupet e krishtera ka më pak dallim mes opinionëve të dy gjinive. Të anketuarit me nivelin më të ulët arsimor priren të mos jenë dakord me të dy pohimet (67.8% për pohimin e dytë dhe 66.7% për të tretin), ndërsa përqindja është shumë më e ulët për të intervistuarit që kanë përfunduar arsimin tetë ose nëntëvjeçar (43.4% për Pohimin 2 dhe 46.1% për Pohimin 3), që nënkupton se grupi i fundit shprehet më shumë “jam dakord” me ekzistencën e grupeve fetare që bëjnë interpretime ekstremiste. Një tjetër gjetje interesante është se mes të anketuarve që kanë mbaruar arsimin pasuniversitar, përgjigja “nuk e di” mbizotëron për të dy pohimet (39.3% dhe 41.7%), ndërsa kampet e “jam dakord” dhe “nuk jam dakord” janë të ngjashme (27.4% dhe 27.4%, përkatësisht, për pohimin e dytë dhe 21.4% dhe 28.6% për të tretin).

Gjatë një interviste në fokus grupe (DFG3), kur u pyetën për ekstremistët fetarë, një besimtar mysliman tha se: “Ata veprojnë brenda xhamive, janë radikalë që flasin me zë të lartë dhe madje [për të bindur të tjerët] bërtasin në emër të Zotit. Por, në fenë tonë, ai që bërtet pa pasur nevojë nuk i përket fesë sonë. Ky dallim duhet të bëhet nga institucionet tona fetare, sepse kjo është çështje e brendshme. Kur dikush shkon në ekstreme brenda xhamisë - duke folur për dhunë dhe vrasje, diçka që është kundër fesë sonë - ai nuk na takon neve dhe ne duhet të distancohemi prej tij.” Gjatë intervistave, si besimtarët ashtu edhe të tjerët shprehën shqetësimin se ish luftëtarët që janë kthyer nga lufta në Siri mund të jenë ekstremistë, ndonëse të intervistuarit ranë dakord që atyre t’u jepet mundësia për t’u rehabilituar dhe riintegruar dhe që institucionet shtetërore të sigurisë duhet të punojnë ngushtë me institucionet dhe komunitetet fetare për ta realizuar këtë (DFGI-4).

*Shumica e të anketuarve duket se favorizojnë një qëndrim akomodimist ndaj fesë, sepse e konsiderojnë atë si pjesë të një kulture të gjallë shqiptare që po kalon një proces*



*të perëndimizimit (ose evropianizimit). Shumë të anketuar mendojnë se është diçka e natyrshëm që predikimi fetar në vend të ndjekë të njëjtën prirje, deri në një farë mase. Të anketuarit më të arsimuar janë në favor të këtij trendi krahasuar me ata më pak të arsimuar. Pjesa më e madhe e të anketuarve ose nuk janë dakord ose nuk kanë dijeni për ekzistencën e grupeve të organizuara që propagandojnë interpretimin ekstremist të besimit të krishterë ose islamik. Sidoqoftë, një propagandë e tillë konfirmohet nga një përqindje jo e vogël e të anketuarve (rreth 19% për besimin e krishterë dhe 26% për besimin islam).*

#### **V.3.4. Konkluzione për nxitësit kulturorë**

Edhe pse nxitësit kulturorë duket se janë pa lidhje për pjesën më të madhe të shqiptarëve dhe për një shoqëri përgjithësisht laike që me të vërtetë respekton vlerat e tolerancës fetare, propaganda radikale apo ekstremiste fetare u konfirmua nga rreth 1/4 e të anketuarve të sondazhit tonë. Rreziqet nga një propagandë e tillë, që ka si shënjestër veçanërisht besimtarët fetarë, nuk duhet të lihet jashtë vëmendjes. Ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm mund të depërtojnë veçanërisht tek besimtarët e rinj apo tek individët në fazat e para të besimit, të cilët mendojnë se feja e tyre sulmohet nga Perëndimi dhe ndjejnë se dinjiteti dhe traditat e tyre fetare janë nën kërcënimin e vazhdueshëm të modernizimit, evropianizimit dhe shekullarizimit. Shumica e besimtarëve fetarë, pavarësisht nëse praktikojnë rregullisht ose rrallë ritet fetare, tregojnë një shkallë të lartë qëndrese. Gjithsesi, në kampionin tonë vihen re disa nga shqetësime dhe “grupe në rrezik”, që mund të shfrytëzohen nga ekstremistët: 25 për qind e atyre që praktikojnë rregullisht ritet fetare dhe gati 25 për qind e të anketuarve në grupmoshës 35-44 vjeç kanë perceptimin se komuniteti, tradita dhe dinjiteti i tyre fetar janë nën kërcënim të vazhdueshëm. Pothuajse një e katërta e intervistuarve të sondazhit ishin dakord se Perëndimi po sulmon vazhdimisht Islamin. Një qëndrim i tillë është më i theksuar në bashkitë e Kavajës, Shijakut, Kamzës, Kukësit, Gjirokastrës dhe Tiranës.

Gjetjet në lidhje me nxitësit kulturorë paraqesin sfida të rëndësishme për udhëheqësit dhe përfaqësuesit fetarë shqiptarë për të kultivuar tek besimtarët frymën e vlerave shoqërore shqiptare dhe traditave vendase të praktikimit të fesë. Një detyrë e tillë kërkon aftësi të shëndosha të komuniteteve fetare dhe mbështetje nga aktorët e shoqërisë ku dhe sfida bëhet edhe më e rëndësishme në kontekstin e ndikimeve dhe presionit që vijnë nga ideologjitë më konservatore. Kështu, 38.2 për qind e të anketuarve mendojnë se Islami në Shqipëri po përballet me ndikime të huaja nga Islami konservator, ndërsa rreth një e katërta e kampionit kombëtar ka përshtypjen se Islami tradicional sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste brenda dhe jashtë vendit. Edhe pse mbizotëron perceptimi se besimtarët fetarë në përgjithësi nuk përjetojnë vështirësi, një në dhjetë shqiptarë besojnë se sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i Islamit (me 5% që e besojnë këtë gjë për besimtarët që praktikojnë besimin e krishterë). Trajtimi i një perceptimi të tillë kërkon më shumë se kundërmesazhe: kërkon veprim, mbështetje dhe angazhim nga të gjithë aktorët e shoqërisë.

#### **V.4. Çështje specifike për Shqipërinë**

Në botimin “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM 2015) përshkruhen një sërë faktorësh specifikë për Shqipërinë që duket se kanë bërë të mundur një mjedis të përshtatshëm për rekrutimin e luftëtarëve të huaj. Lufta e brendshme për pushtetin brenda Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, funksionimi



i xhamive të paligjshme dhe shqetësimet për kapacitetet dhe autoritetin e klerikëve fetarë u analizuan me detaje në bazë të perceptimeve dhe qëndrimeve të të anketuarve dhe të kontributit nga pjesëmarrësit e fokus grupeve dhe të intervistuarve.

Gjatë tre viteve të fundit, KMSH dhe autoritetet shtetërore kanë ndërmarrë një sërë masash për të trajtuar çështjen e xhamive të paligjshme. Vetë Komuniteti ka bërë përpjekje për të përmirësuar kapacitetet e klerikëve fetarë edhe pse shqetësimet në këtë drejtim ende vazhdojnë. Ndërkohë, institucionet fetare kanë parë një rritje të jashtëzakonshme të besimit të publikut tek to, nga 44 për qind e shqiptarëve në 2014, në 76 për qind një vit më parë (2017).<sup>87</sup> Për më tepër, institucionet fetare kryesojnë listën e institucioneve më të besueshme në Shqipëri dhe janë vetëm 9 për qind poshtë institucioneve më të besuara, si BE dhe OKB. Ky ndryshim është kryesisht për shkak të hapjes së komuniteteve fetare, angazhimit të tyre proaktiv në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, dhe pa dyshim, pranisë së një publiku shumë të ndjeshëm që respekton vlerën e tolerancës fetare në vend. Si komuniteti më i madh fetar në Shqipëri, meritën për këtë arritje duhet të marrë në mënyrë të veçantë KMSH. Sfidat për këtë të fundit ende vazhdojnë, pasi vitet e fundit autoriteti i tij qendror është kontestuar nga faktorë të jashtëm<sup>88</sup> dhe vazhdon të sfidohet nga njerëz të lidhur me xhamitë që më parë njiheshin si “xhami të paligjshme”,<sup>89</sup> teksa ndonjëherë në debatin publik është përfshirë edhe tema e Gulenistëve kundër Erdoganistëve.<sup>90</sup>

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj dhe shkëputja nga ideologjitë fetare të ekstremizmit të dhunshëm janë një temë tjetër me interes të madh për aktorët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend. Shqipëria duhet të nisë punën për hapjen e programeve të riintegritimit dhe rehabilitimit, ndërkohë që punonjësit e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm bëjnë thirrje për qasje sa më realiste në këtë kontekst.

Ky studim i ka rishikuar faktorët e analizuar në vlerësimin e IDM-së (2015) dhe shtoi pyetje specifike kërkimore që lidhen me debatin aktual të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (KEDH) të paraqitur më sipër. Qëllimi kryesor i këtij seksioni është të ofrojë dëshmi empirike për çështjet me interes për aktorët e KEDH në mënyrë që të mundësojë një debat sa më realist publik dhe politik si dhe masa më efikase dhe të qëndrueshme të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Në studim përpunohen më tej çështjet që bëjnë pjesë në autoritetin fetar, duke pasur parasysh potencialin e tyre për të ndikuar në qëndresën e komuniteteve kundër presionit dhe ideologjive të EDH.

87. Shih “Besimi në qeverisje 2017” (IDM 2018). Burimi: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/03/IDM-OpinionPoll-2017-AL-web.pdf>

88. Shih “Erdogan steps up pressure on Albania’s PM Edi Rama to get rid of all Gülen assets in the country” (<http://balkanspost.com/article/79/erdogan-g%C3%BClen-albania>); Zëri i Amerikës “Turkey on Diplomatic Push to Close Schools Linked to Influential Cleric” (<https://www.voanews.com/a/turkey-erdogan-gulen-schools/4010073.html>); Balkaninsight “Turkey Presses Albania To Extradite Key ‘Gülenist’ Suspect” (<http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-to-face-turkish-request-to-extradite-gulen-supporter-10-13-2017>)

89. Shih “Imam Armand Aliu krahason kryetarin e KMSH-se me Nikolla Çausheksun” (nëntor 2017). Burimi: <http://gazetaimpakt.com/imam-armand-aliu-krahason-kryetarin-e-kms-h-se-nikolla-causheskun/>

90. Shih JavaNews “Lorenc Vangjeli: Erdogan e ka shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i madh i lëvizjes gyleniste” (prill 2018). Burimi: <http://www.javanews.al/lorenc-vangjeli-erdogan-e-ka-shpetuar-shqiperine-nga-rreziku-madh-levizjes-gyleniste/>



### **V.4.I. Autoriteti fetar**

Klerikët dhe përfaqësuesit zyrtarë të komuniteteve fetare duhet të luajnë një rol kryesor në luftën kundër ekstremizmit dhe përpjekjet për të ndërtuar qëndresën e komuniteteve lokale kundër formave dhe ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm. Besimi i besimtarëve fetarë dhe përkrahja nga të gjithë aktorët e komunitetit kanë rëndësi tepër të madhe që roli i këtyre përfaqësuesve të jetë efektiv. Ekzistojnë një sërë faktorësh që kushtëzojnë marrëdhëniet mes klerikëve fetarë, bashkësive të besimtarëve dhe komuniteteve më të gjera lokale në përgjithësi. Edhe pse lista nuk është shteruese, ky studim rishikon grupin e faktorëve të analizuar nga IDM (2015), të cilët së bashku janë në qendër të realizimit me sukses të autoritetit fetar: si perceptohen nga anëtarët e tyre klerikët fetarë, niveli i përgatitjes së klerikëve dhe legjitimiteti dhe mosmarrëveshjet për autoritetin fetar.

Të anketuarit u pyetën sa dakord ishin me pohimet e mëposhtme:


- |           |  |
|-----------|--|
| Pohimi 1: | Objektet e kultit (kisha, xhamia, etj.) të ngritura pa lejen e komunitetit fetar përkatës duhen ndaluar.             |
| Pohimi 2: | Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj. |
| Pohimi 3: | Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.                                     |
| Pohimi 4: | Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin/formimin e duhur fetar.   |

#### **V.4.I.a. Qëndrimet ndaj objekteve të paligjshme fetare**

Marrëveshjet e shtetit me secilën prej bashkësive fetare në Shqipëri ku përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet palëve kanë qenë tejet të dobishme në vitet e fundit për sa i përket ndërgjegjësimit publik për ekstremizmin e dhunshëm. Shumica e shqiptarëve priren të japin mbështetje për statusin e rregulluar me ligj të objekteve fetare, të tilla si kisha dhe xhami. Pasoja të objekteve të tilla që operohen sipas dëshirës, pa kontrollin e duhur apo ndonjë kontrolli tjetër nga autoritetet përkatëse, kanë mundësuar rrjetin e imamëve të vetëdeklaruar që radikalizojnë dhe rekrutojnë shtetas shqiptarë si luftëtarë të huaj. Këto pasoja dhe dënimi i fundit i dhënë për grupin e nëntë rekrutuesve kanë gjasa të rrisin edhe më tej ndërgjegjësimin e publikut dhe qëndrimin e tij për të refuzuar institucionet e paligjshme fetare.



**Figura 59. Qëndrimi i të anketuarve për ndalimin e objekteve të paligjshme fetare (%; N = 1,580)**




Mes të anketuarve të pyetësorit, 63 për qind mbështetën Pohimin 1, ndërsa më pak se një në pesë nuk ishte dakord. Një qëndrim i tillë është i pranishëm tek të gjitha kategoritë demografike me një shumicë të madhe, që variojnë nga 50 deri në 70 për qind. Përveç kësaj, mes të anketuarve që praktikojnë në nivele të ndryshme ritet fetare u evidentua një përqindje pothuajse identike (64%) në mbështetje të ndalimit të objekteve të paligjshme fetare.

#### **V.4.1.b. Autoriteti i padiskutuar qendror fetar**

Në një studim të kryer nga IDM në vitin 2017, raportohej se dy të tretat e shqiptarëve kanë besim tek institucionet fetare. Ky studim konfirmon besimin e përgjithshëm tek autoritetet fetare, ndonëse në përqindje më të vogël (55%).

Më pak se 7 për qind e të anketuarve të këtij sondazhi nuk janë aspak dakord me pohimin “Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj.” Siç tregohet në Figurën 60, më shumë se 1/4 e të anketuarve nuk kishte një përgjigje përfundimtare.

**Figura 60. Qëndrimet e të anketuarve nëse qëndrimet e kreut të komunitetit të tyre fetar gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve (%; N = 1,577)**






Është e kuptueshme që besimtarët praktikantë fetarë tregojnë nivel më të lartë mbështetjeje për këtë pohim, me më pak se gjysmën e të anketuarve që nuk praktikojnë ritet fetare që u shprehën dakord (44%). Është interesante se sa më i madh në moshë i intervistuari, aq më e fortë është prirja e tij që të pranojë se qëndrimi i kryetarit të komunitetit të tij fetar gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve në zonën e tij. Më shumë të anketuar nga zonat rurale ishin dakord (59%) me pohimin krahasuar me ata të zonave urbane (52%), ndërsa ata me diplomë pasuniversitare treguan nivelin më të ulët të dakordësisë (39%).

#### V.4.1.c. Klerikë fetarë lokalë me ndikim?

Ndërkohë që më shumë se gjysma e shqiptarëve priren t'i mbështesin klerikët fetarë të nivelit kombëtar, një numër më i vogël i tyre mendojnë se klerikët vendorë kanë ndikim të mjaftueshëm tek komunitetet vendore (43.3%). Përqindja e të anketuarve që nuk janë dakord u rrit nga 17 për qind për klerikët e nivelit kombëtar në rreth 26 për qind për klerikët fetarë lokalë për Pohimin 3— Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.

**Figura 6i. Opinioni i të anketuarve nëse klerikët lokalë janë me influencë (%; N = 1,579)**



Ndonëse të anketuarit që praktikojnë ritet fetare priren të jenë më shumë dakord me këtë pohim krahasuar me ata që nuk praktikojnë asnjë rit, tendenca është më e dobët sesa niveli i mbështetjes për krerët fetarë të nivelit qendror. D.m.th., 69 për qind e të anketuarve që praktikojnë fenë rregullisht dhe 47 për qind e atyre që praktikojnë ritet kryesore fetare priren të jenë dakord se klerikët fetarë lokalë kanë ndikim të madh tek besimtarët e tyre (krahasuar me 67 dhe 65 për qind, përkatësisht për klerikët në nivel kombëtar).


Kur analizojmë demografinë e të anketuarve të këtij sondazhi, si urban apo rural, dhe moshën, për Pohimin 3 evidentohet e njëjta prirje si për Pohimin 2. Të anketuarit nga zonat rurale priren të jenë dakord ose plotësisht dakord më shumë sesa ata në zonat urbane dhe sa më të mëdhenj në moshë të anketuarit, aq më shumë dakord janë ata. Së fundi, më pak mbështetje vihet re tek të anketuarit me diplomë pasuniversitare (32%) dhe diplomën universitare (37%).



**V.4.1.d. Klerikët lokalë pa arsimin e duhur fetar**

Rreth 1/4 e të anketuarve (24%) besojnë se ka klerikë pa arsimin e duhur fetar. Megjithatë, më shumë se 1/3 (34%) e konsiderojnë këtë gjë si të pavërtetë, ndërsa shumica (40%) nuk kanë asnjë mendim për këtë pohim.

**Figura 62. Qëndrimet e të anketuarve nëse klerikët kanë arsimin e duhur fetar (%; N = 1,577)**



Me këtë pohim ranë dakord përqindje pothuajse identike të të anketuarve që praktikojnë të gjitha ose ritet kryesore dhe atyre që nuk praktikojnë asnjë rit (22-25%). Gjysma (51%) e atyre që praktikojnë rregullisht dhe 36 për qind e atyre që praktikojnë ritet kryesore nuk janë dakord, ndërsa vetëm 26 për qind e atyre që nuk praktikojnë asnjë rit kanë këtë mendim. Përqindjet më të larta të përgjigjeve “nuk di” vihen re mes të anketuarve që praktikojnë ritet kryesore (41%) dhe ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (46%). Për këtë pohim është konstatuar një korrelacion mes moshës dhe përqindjes së mosdakordësisë. Megjithatë, nuk evidentohen dallime të mëdha në lidhje me përgjigjet “janë plotësisht dakord” ose “janë dakord” nga të anketuarit e grupmoshave të ndryshme (21-26%).


Të anketuarit me nivel më të lartë arsimit kishin një përqindje më të madhe të përgjigjeve “nuk e di” (47%, 60%, me diplomë pasuniversitare) dhe përqindje më të vogël të dakordësisë (22%, me diplomë universitare, 15%, me diplomë pasuniversitare) ose mosdakordësi (28%, me diplomë universitare, 23%, me diplomë pasuniversitare). Gjysma (51%) e të anketuarve me më pak se tetë ose nëntë vjet arsim apo pa arsim fare nuk ishin dakord me pohimin.

*Shqiptarët tregojnë mbështetje masive për tolerancën fetare si vlerë dhe traditë e shoqërisë shqiptare dhe i konsiderojnë institucionet fetare si institucionet kombëtare më të besuara. Roli i shtetit dhe, në veçanti, ai i përfaqësuesve fetarë janë shumë të rëndësishëm për larminë fetare, kulturën e bashkekzistencës paqësore dhe dialogut ndërfaqet në një shoqëri që duket se është më pak fetare sesa vendet fqinje. Pjesa më e madhe e shqiptarëve tregojnë nivel të lartë besimi në autoritetin fetar nga kreu e poshtë, edhe pse janë më skeptikë për aftësitë e autoritetit fetar dhe ndikimit të tij në nivel vendor. Në figurën 63 tregohet një prirje në rënie e autoritetit fetar nga klerikët kombëtarë tek ata lokalë, ndërsa mbështetja e shqiptarëve për masat që përforcojnë autoritetin zyrtar fetar (duke*



ndaluar institucionet e paligjshme fetare) qëndron pa dyshim shumë më lart. Pavarësisht ndikimit të konsiderueshëm dhe rezultateve pozitive në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për ekstremizmin e dhunshëm, institucionet fetare kanë një rrugë të gjatë për të bërë drejt përmirësimit të kapaciteteve dhe forcimit të rolit të tyre në nivel vendor. Klerikët fetarë në këtë nivel, ndikimi dhe kapacitetet e tyre, janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për krijimin e komuniteteve me qëndrëse dhe luftën kundër ndikimit dhe autoritetit të paligjshëm fetar që kërkojnë të krijojnë një bazë mbështetjeje për ideologjitë ekstremiste fetare.

**Figura 63. Përqindja e të anketuarve që konfirmojnë praninë e objekteve të paligjshme fetare, mbështetjen e drejtuesve të komunitetit fetar, ndikimin e perceptuar dhe kapacitetet e klerikëve lokalë (pohimet 1–4)**



#### V.4.2. Forcimi i tolerancës fetare—Më shumë apo më pak njohuri fetare?


Para dy vitesh qeveria shqiptare shpalli përfshirjen e njohurive fetare si lëndë me zgjedhje, me qëllim që të përdoren si instrument për të forcuar tolerancën fetare dhe për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Në debatet publike është prekur shpesh ky instrument dhe komunitetet fetare janë treguar të kujdesshëm duke e mirëpritur këtë nismë. Të anketuarit e studimit të IDM-së (2015) “Toleranca fetare në Shqipëri” ngritën shqetësime për zbatimin në praktikë të kësaj nisme si dhe për kapacitetin e mësuesve.<sup>91</sup> Të njëjtat shqetësime u shprehën në diskutimet në fokus grupe të këtij studimi edhe nga pjesëmarrësit me diplomë universitare ose pasuniversitare.<sup>92</sup> Megjithatë, të anketuarit e këtij studimi duken përgjithësisht pozitivë për kurrikulën fetare si masë që do të forconte tolerancën fetare. Kështu, 32.1 për qind e të anketuarve janë plotësisht dakord se kurrikula fetare do të forconte tolerancën fetare.

91. Shih faqen 71 të studimit, në adresën <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albania.pdf>.

92. Diskutimi i fokus grupit të mbajtur në 25 qershor 2018.

**Pyetja:** Cili është qëndrimi juaj personal lidhur me pohimin e mëposhtëm — Përfshirja e njohurive fetare si lëndë me zgjedhje në shkolla do të forconte tolerancën fetare në Shqipëri?

**Figura 64.** Opinioni i të anketuarve që njohuritë fetare si lëndë me zgjedhje në shkolla do të forconin tolerancën fetare në Shqipëri (%; N = 1,577)



Në total, 47 për qind e intervistuarve të sondazhit e mbështetën (plotësisht dakord ose dakord) këtë pohim, ndërsa rreth 39 për qind nuk ishin dakord. Më shumë të anketuar që praktikojnë rregullisht ritet fetare u shprehën dakord (64%) krahasuar me ata që praktikojnë më pak (48%) ose që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (40%). Po ashtu, sa më i lartë niveli i shkollimit, aq më i ulët është miratimi për këtë pohim. Së fundi, gati 50 për qind e të anketuarve nga zonat rurale ishin dakord me këtë pohim, në krahasim me 45 për qind të atyre që vijnë nga zonat urbane. Arsyet për një mbështetje të tillë të kujdesshme mund të gjenden në faktin se shqiptarët e konsiderojnë tolerancën fetare një traditë tashmë të vendosur dhe vlerë të shoqërisë. Prandaj, siç theksohet edhe nga studimi i IDM-së, “Toleranca fetare në Shqipëri” (2018), shqiptarët i konsiderojnë themelet e tolerancës fetare si të rrënjosura thellë në traditat kombëtare dhe jo në argumentet fetare. Përveç kësaj, ky konstatim sugjeron se shqiptarët shohin kufizime tek ndikimi i njohurive fetare: ndonëse kjo gjë mund të jetë faktor i dobishëm për komunitetet e besimtarëve fetarë, rritja e njohurive fetare mund të mos ndikojë domosdoshmërisht tek perceptimet e një shoqërie përgjithësisht jofetare.

#### V.4.3. Shkëputja

Studimet bashkëkohore e konsiderojnë radikalizimin e dhunshëm si proces të vazhdueshëm dhe gradual të ndërveprimit mes një individi dhe faktorëve të jashtëm, si idetë ekstremiste, grupet e ngushta të izoluara nga shoqëria në përgjithësi, predikuesit karizmatikë dhe rekrutuesit. Ndikime të tilla të jashtme ndërveprojnë me mendësinë e individëve të caktuar, mendësi që është formësuar nga ndikimet e prejardhjes familjare, përvoja e privimit, ndërjegjësimi për padrejtësitë në botë, përballja me korrupsionin e elitës politike, paaftësia e integritimit në shoqëri, diskriminimi i bashkëbesimtarëve në vende të tjera, ndër të tjera. Në këtë linjë analize, trajektoret individuale lidhen me kontekstin social përmes rrjeteve dhe mjediseve radikale që shërbejnë si “mjedise



të mikro-mobilizimit”.<sup>93</sup> Kështu, ekziston një marrëdhënie dialektike mes afinitetit ideologjik me fundamentalizmin fetar dhe idetë ekstremiste nga njëra anë dhe lidhjeve personale të formuara në grupe dhe rrjete radikale nga ana tjetër. Individit mund të prezantohet me pikëpamjet radikale dhe ekstremiste nga të afërmit, miqtë dhe mentorët, që tashmë i mbështesin këto pikëpamje. Për më tepër, shoqërimi i tij apo saj me grupet dhe rrjetet radikale mbështetet nga brendësimi i pikëpamjeve ekstremiste, ndërkohë që izolimi relativ nga shoqëria në përgjithësi përforcon më tej besimet dhe vendosmërinë brenda grupit. Me përkrahje nga grupi radikal dhe identiteti i sapo gjetur, individët e radikalizuar mund të marrin pjesë në aktivitete me risk të ulët në lëvizjet sociale që me kalimin e kohës i hapin rrugën për veprimeve me rrezik të lartë ku mund të përfshihen dhuna dhe terrorizmi. Edhe tërheqja emocionale dhe kodi i nderit i shqiptarëve duket se luan një rol.<sup>94</sup>

Shkëputja nga ideologjia e ekstremizmit të dhunshëm është një nga çështjet më të debatuar mes studiuesve dhe punonjësve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (KEDH) në të gjithë botën. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të dhunshëm dhe Plani i Veprimit i Shqipërisë i referohet masave që synojnë rehabilitimin (dhe riintegrimin) e të dënuarve për ekstremizëm të dhunshëm. Punonjësit e KEDH dhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare kanë ngritur shpesh nevojën për hartimin e programeve të përshtatshme të shkëputjes apo de-radikalizimit. Sfidat për krijimin e programeve të tilla mbeten të shumëfishta dhe përfshijnë jo vetëm shqetësimet për mangësitë ligjore për të balancuar masat represive me ato që synojnë rehabilitimin (e shkelësve) dhe parandalimin (për shkelësit e mundshëm), por edhe mungesën e qartësisë për sa i përket radikalizimit, ekstremizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ndërkohë, perceptimet e publikut nuk arrijnë të bëjnë një dallim të qartë mes termave të tilla si ideologji radikale, të dhunshme dhe ekstremiste.

Ky studim përdor termin “shkëputje” (përkundër termit “de-radikalizim”) dhe fokusohet tek dallimet në perceptimet e publikut për sa i përket ideologjive radikale dhe besimtarëve të radikalizuar fetarë nga njëra anë dhe ideologjive ekstremiste dhe ekstremistëve të dhunshëm nga ana tjetër. Kështu, në sondazhin kombëtar të anketuarit u pyetën sa dakord ishin me pohimet e mëposhtme:

- Pohimi 1: Është e pamundur që besimtarët e radikalizuar të shkëputen nga ideologjia radikale fetare.
- Pohimi 2: Është e pamundur që ekstremistët e dhunshëm të shkëputen nga ideologjia ekstremiste fetare.


Siç tregohet në Figurën 65, shqiptarët mbeten në përgjithësi skeptikë për shkëputjen e radikalëve fetarë apo ekstremistëve të dhunshëm. Pothuajse gjysma e tyre ishte dakord me secilin pohim.

93. Stefan Malthaner (2017) “Radicalization: The Evolution of an Analytical Paradigm”, *European Journal of Sociology*, vol. 58 (3), f. 376.

94. Jamie Barlett & Carl Miller, “The Edge of Violence...”, f. 13–17.



**Figura 65. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se besimtarët e radikalizuar mund të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare (N = 1,579) dhe ekstremistët e dhunshëm mund të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste fetare (N = 1,577)**



Analiza demografike e përgjigjeve nxjerr në pah disa dallime të konsiderueshme në qëndrimet e të anketuarve, me disa përjashtime. Të anketuarit e moshës 35-44 vjeç prireshin më shumë të mos ishin dakord me Pohimin 1 se sa grupmoshat e tjera. Edhe të anketuarit nga zonat urbane dhe ata që kanë përfunduar studimet pasuniversitare nuk ishin dakord me pohimin. Përqindja e të intervistuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare që nuk ishin dakord me pohimin (36.7%) ishte më e lartë se e atyre që praktikojnë rrallë (31.5%) apo e atyre që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (27.8%). Grupi i fundit nga këta kishte një përqindje më të lartë të përgjigjeve “nuk e di”. Ndër të tre kategoritë e të anketuarve (që praktikojnë rregullisht ritet fetare, që praktikojnë ato kryesore apo që nuk praktikojnë fare) ka pasur një përqindje më të lartë të dakordësisë me pohimin (46.7%, 50.2% dhe 49.7%, përkatësisht) krahasuar me ata që nuk ishin dakord me të.

Mes të anketuarve nga kategoritë e ndryshme demografike u vu re më shumë uniformitet për pohimin e dytë (diferencat <5%) me përjashtim të të anketuarve me më pak se 8 po 9 vite arsim apo pa arsim fare, që dhanë më shumë përgjigje “nuk e di” (22%) në kurriz të një niveli më të ulët të dakordësisë me pohimin (42.2%) krahasuar me përgjigjet nga të anketuarit e kategorive të tjera të arsimit (nga 47-56%). Është me interes të evidentohet se hendeuku mes të anketuarve që ishin dakord me ata që nuk ishin dakord është shumë më i madh sipas kategorisë së praktikimit fetar krahasuar me pohimin e parë. Kështu, tek të tre kategoritë e të anketuarve (që praktikojnë rregullisht ritet fetare, që praktikojnë ato kryesore apo që nuk praktikojnë fare) kishte përqindje më të larta të përgjigjeve “dakord” me pohimin (52.3%, 55.9% dhe 52.3%, përkatësisht) krahasuar me përgjigjet “nuk janë dakord” (30.3%, 26.8% dhe 26%, përkatësisht).

Me sa duket, shkëputja nga ideologjia radikale apo e ekstremizmit të dhunshëm diskutohet fare pak në debatin publik në Shqipëri që të bëjë të mundur informimin e perceptimeve apo qëndrimeve të publikut. Në fakt, debati i duhur për shkëputjen në Shqipëri nuk po bëhet as nga komuniteti i punonjësve të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe as nga aktorë të tjerë të fushës. Rezultatet e mësipërme tregojnë se publiku në përgjithësi priret të jetë mosbesues për mundësitë e shkëputjes nga



ideologjitë radikale apo ekstremiste fetare. Të anketuarit që janë të familjarizuar me praktikat fetare dhe, rrjedhimisht, me procesin e të bërit besimtar fetar, duket se kanë të njëjtin opinion si publiku i gjerë. Gjithsesi, ata janë më pak pesimistë për shkëputjen e besimtarëve të radikalizuar në krahasim me shkëputjen e ekstremistëve të dhunshëm.

*Shkëputja nga ideologjia radikale apo e ekstremizmit të dhunshëm është debat i vazhdueshëm në shumë vende. Në të gjithë botën po vihen re një sërë praktikash më të mira dhe përvoja të vërtetuara, përfshirë këtu ato në vendet e BE-së, për programet e shkëputjes nga ideologjitë e EDH, si fetare ashtu edhe jo-fetare. Ka ardhur koha që Shqipëria të nisë debate të strukturuar dhe masa konkrete për mbështetjen e krijimit të programeve të shkëputjes, jo vetëm për ideologjitë ekstremiste fetare, por edhe për ideologji dhe forma të tjera të ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht mes të rinjve.<sup>95</sup>*


#### V.4.4. Riintegrimi i ish luftëtarëve të huaj dhe i të rikthyerve

Të anketuarit u pyetën për masat e mundshme me të cilat trajtohen pasojat e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, ata u pyetën për riintegrimin e ish luftëtarëve të huaj dhe të rikthyerve.

**Pohimi:** Rikthimi i shtetasve shqiptarë që kanë qenë pjesë aktive e luftës në Siri përbën kërcënim për shoqërinë.

Rreth 48 për qind e shqiptarëve e perceptojnë si kërcënim për shoqërinë rikthimin e shtetasve shqiptarë që kanë marrë pjesë aktivisht në konfliktin në Siri. Ndërkohë, 36.2 për qind kanë mendim të kundërt, ndërsa 5.2 për qind e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje dhe një tjetër 10.8 për qind dhanë përgjigjen “nuk e di”.

**Figura 66. Opinioni i të anketuarve nëse rikthimi i luftëtarëve të huaj është kërcënim për shoqërinë (%; N = 1,576)**



95. Media ka raportuar raste të dhunës mes të rinjve që kanë rezultuar fatale. Shih raportet e mediave për vrasjen në Durrës (mars 2018) <http://www.faktor.al/2018/03/02/durres-vritet-me-thike-ne-zemer-16-vjecari-anxhelo-gjokazaj/> dhe rastin më të fundit në Mamurras <http://www.tiranapost.al/mbreme-u-vra-thike-14-vjecari-ne-mengjes-nje-tjeter-vrasje-ne-mamurras/> (shtator 2018).




Me këtë pohim ishin plotësisht dakord një përqindje me e lartë e të anketuarve (29.3%) krahasuar me ata që nuk ishin aspak dakord (22%). Dallime të mëdha në përgjigjet ndaj kësaj pyetjeje vihen re mes kategorive të ndryshme demografike. Pjesa më e madhe e të intervistuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare nuk ishin dakord me pohimin (46.4%) përkundër vetëm 40.1% që ishin dakord. Kishte më pak të anketuar që praktikojnë ritet kryesore fetare apo që nuk praktikojnë asnjë rit dhe që nuk ishin dakord (37.3% dhe 31.9%, përkatësisht) dhe përqindje më të larta të atyre që ishin dakord (47.2% dhe 51.5%, përkatësisht).

Përqindje e njëjtë mbështetjeje dhe mosdakordësie u vu re në lidhje me pohimin tjetër të sondazhit: Organet shtetërore duhet të riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime.

Mes të anketuarve të sondazhit, 36 për qind nuk mbështetën një qasje të diferencuar në lidhje me riintegrimin e ish luftëtarëve të huaj. Është interesante se kjo përqindje është e njëjtë me atë të të anketuarve që ishin dakord me pohimin e parë, se rikthimi i luftëtarëve të huaj përbën kërcënim për shoqërinë. Kjo ko incidencë vihet re edhe për opinionin e kundërt. Kështu, 49.2 për qind e të intervistuarve ishin dakord se Shqipëria duhet të riintegrojë vetëm ata shtetas që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por nuk kanë kryer krime, me një për qind më shumë se grupi i të anketuarve që mendonin se rikthimi i luftëtarëve të huaj shqiptarë përbën kërcënim për shoqërinë, në pohimin e mëparshëm (48%).

**Figura 67. Opinioni i të anketuarve që vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por nuk kanë kryer krime duhet të riintegrohen (%; N = 1,574)**




Gjithsesi, shqiptarët duket se përgjigjen më pak “nuk jam dakord” kur pyeten për angazhimin e organeve shtetërore për të ndihmuar në rikthimin dhe riintegrimin e të gjithë shtetasve shqiptarë të angazhuar në konfliktet jashtë vendit. Sipas burimeve zyrtare, gati gjysma e shtetasve shqiptarë që lanë vendin dhe iu bashkuan konfliktit sirian gjatë viteve 2012-2015 janë ende në zonat e konfliktit. Kështu, 18 luftëtarë shqiptarë dhe 55 familjarë të tyre kanë mbetur ende në Siri dhe Irak, ndërsa 45 shtetas të tjerë janë kthyer dhe 26 vetë janë vrarë në këto vitet e fundit.<sup>96</sup> Institucionet

96. Komisioni Evropian. “Raporti për Shqipërinë 2018”. p. 36. Burimi: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>



shtetërore shqiptare po punojnë me vendet partnere për të siguruar rikthimin e luftëtarëve shqiptarë dhe familjarëve të tyre nga zonat e konfliktit. Përprjekje të tilla duket se kanë gjetur mbështetje të madhe tek publiku sipas të anketuarve të këtij studimi, edhe pse gati gjysma e tyre (48%) mendojnë se rikthimi i luftëtarëve të huaj përbën kërcënim për shoqërinë.

**Figura 68. Opinioni i të anketuarve se organet shtetërore duhet të angazhohen për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit (%; N = 1,575)**



Nga të anketuarit, 61.5 për qind ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “organet shtetërore duhet të angazhohen për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit”, ndërkohë që më pak se gjysma e kësaj përqindjeje (27%) kishte mendim të kundërt. Një përqindje më e lartë e të anketuarve që praktikojnë rregullisht ritet fetare (70%), ose që praktikojnë ritet kryesore fetare (62%) treguan mbështetje për këtë pohim krahasuar me ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (58%). Po ashtu, mbështetja ishte më e ulët mes të anketuarve me më pak se 8-9 vite shkollë apo pa arsim fare (42%), ndërkohë që për kategoritë e tjera të të anketuarve, niveli i dakordësisë ishte 60-63,5%.

*Shumica e shqiptarëve nuk kanë asnjë dyshim se institucionet shtetërore duhet të bëjnë përprjekje për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të angazhuar në konfliktet jashtë vendit, ndonëse gati gjysma e të anketuarve mendojnë se luftëtarët e huaj dhe shtetasit e rikthyer përbënin kërcënim për shoqërinë. Në linjë të njëjtë me perceptimet mbizotëruese për shkëputjen, pothuajse gjysma e shqiptarëve besojnë se institucionet shtetërore duhet të integrojnë vetëm luftëtarët e huaj dhe të rikthyerit që nuk janë përfshirë në dhunë. Të anketuarit që praktikojnë ritet fetare treguan një nivel më të lartë mbështetjeje për riintegrimin. Kështu, programet e riintegritimit në Shqipëri kanë një mbështetje përgjithësisht pozitive nga publiku, ndonëse me mungesë debati të informuar mes aktorëve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.*

## VI. Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri —Perceptime, praktika dhe realiteti

Shqipëria është e njohur për traditën e saj të tolerancës fetare teksa aktet e dhunshme me motive fetare kanë munguar pothuajse plotësisht në vend. Sidoqoftë, bashkëjetesa paqësore e komuniteteve fetare në Shqipëri nuk do të thotë që radikalizmi dhe ekstremizmi fetar mungojnë tërësisht.<sup>97</sup> Radikalizimi është një fenomen me të vërtetë shumëdimensional që lind nga ndërveprimi i ideologjive radikale me dinamikën shoqërore dhe formësohet nga faktorë më të mëdhenj strukturorë. Një mësim kryesor që del gjatë gjithë angazhimit thuajse katërvjeçar (2014-2018) të IDM-së në shqyrtimin e tendencave, në projektimin e qasjeve dhe në zbatimin e platformave të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm është se parandalimi është një proces i vazhdueshëm ku përfshihen shumë aktorë, proces që duhet të bëjë bashkë përpjekjet në nivel komuniteti. Nevojiten strategji me përfshirjen e shumë aktorëve për të trajtuar në mënyrë graduale kontekstin e gjerë social, ekonomik dhe kulturor që nxit sjellje ekstremiste dhe të dhunshme, veçanërisht tek të rinjtë. Për parandalimin duhet të ndërthuren nismat që vijnë nga komuniteti lokal, qeverisja vendore, institucionet publike, komunitetet fetare, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të shoqërisë.

Në këtë studim të anketuarve iu bënë disa pyetje për të marrë mendimet e tyre në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, për faktorët e qëndrësës dhe se cilët janë aktorët më të rëndësishëm me role specifike për ekstremizmin e dhunshëm. Për të kuptuar më mirë qëndrimet e tyre ndaj këtyre pyetjeve, të intervistuarve iu kërkua të rendisnin tre arsytet më të rëndësishme që krijojnë apo nxisin radikalizimin fetar të individëve në Shqipëri.

Në Tabelën 5 jepen tre arsytet kryesore të renditura nga të anketuarit e këtij sondazhi, ku përfshihen niveli i ulët arsimor (67%), arsyet ekonomike (61.6%), dhe niveli i ulët i njohurive fetare (40.7%). Kjo gjetje është tregues se shumica dërrmuese e shqiptarëve e perceptojnë mungesë e njohurive, qoftë ato arsimore apo informacionin fetar, si arsyen më të rëndësishme që e bëjnë një njeri të marrë rrugën e radikalizimit fetar. Ndonëse arsyet ekonomike ishin faktori i dytë më i përmendur nga shqiptarët, të anketuarit e këtij sondazhi e vunë theksin edhe tek roli i izolimit shoqëror (36.2%) dhe ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë (27%).

**Tabela 5. Opinioni i të anketuarve për arsytet kryesore që krijojnë apo nxisin radikalizimin fetar tek individët**

Faktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Niveli i ulët arsimor	1,030	67.0

97. Për një studim të kohëve të fundit për tolerancën fetare në Shqipëri shih "Toleranca fetare në Shqipëri." Tiranë, PNUD dhe IDM, 2018.



Arsyet ekonomike	947	61.6
Niveli i ulët i njohurive fetare	626	40.7
Izolimi shoqëror	557	36.2
Ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë	415	27.0
E shkuara kriminale	365	23.7
Paaftësia e institucioneve shtetërore	285	18.5
Paaftësia e klerikëve fetarë	230	15.0

*Shënim: Kjo është pyetje me shumë zgjedhje si përgjigje. Përqindjet nuk plotësojnë kuotën 100%. Numri i rasteve = 4,455. Numri i përgjigjeve = 1,538.*

Është me interes të evidentohet se edhe pse shqiptarët e rendisin të fundit përgjigjen “paaftësia e klerikëve fetarë”, ky është një faktor i besueshëm që mund të kontribuojë në rrugën e individit drejt radikalizimit dhe më shpesh mendojnë se aktorët fetarë (institucionet dhe klerikët lokalë) si aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri. Tre aktorët të përmendur më shpesh nga të anketuarit shqiptarë (Tabela 6) janë drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare (41%), media (37.3%) dhe klerikët lokalë (33%). Ky grup aktorësh pasohet menjëherë nga pushteti qendror (26%) dhe shoqëria civile (25.8%).

**Pyetja:** *Sipas jush, cilët janë TRE aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri??*

**Tabela 6. Opinioni i të anketuarve për aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri**

Aktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare	635	41.0
Media	578	37.3
Klerikët lokalë	511	33.0
Pushteti qendror (Qeveria, ministritë)	403	26.0
Shoqëria civile	400	25.8
Shërbimet e ndihmës sociale	370	23.9
Institucionet ligjzbatuese (policia, prokuroria, gjykatat)	368	23.8
Besimtarët fetarë	357	23.1
Shkollat	339	21.9
Pushteti vendor	336	21.7
Të rinjtë	196	12.7
Gratë	56	3.6
Tjetër	13	0.8

*Shënim: Kjo është pyetje me shumë zgjedhje si përgjigje. Përqindjet nuk plotësojnë kuotën 100%. Numri i rasteve = 4,562. Numri i përgjigjeve = 1,548.*



Pesë aktorët më shpesh të përmendur nga shqiptarët pasqyrojnë më së miri realitetin e rritjes së ndërgjegjësimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend gjatë tre viteve të fundit, të trajtuar më shpesh nga përfaqësuesit fetarë, mediat (përmes raportimit), qeveria qendrore dhe shoqëria civile. Kjo shpjegon edhe thirrjen që bëhet shpesh nga aktorët dhe ekspertët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri se është koha për të kaluar nga niveli kombëtar (me qendër në Tiranë), me veprime të drejtuara nga qendra, drejt nivelit të komunitetit dhe masave të drejtuara nga komuniteti. Për këtë ndryshim dhe tek veprimet që duhet të kryhen në këtë nivel duhet të përfshihen të gjithë aktorët vendorë, veçanërisht ato në fund të Tabelës 6 – të rinjtë, gratë, pushteti vendor, shkollat dhe komuniteti i gjerë i besimtarëve fetarë – së bashku me shoqërinë civile, institucionet, median, shërbimin e mirëqenies sociale dhe organet e tjera të qeverisë qendrore në nivel vendor dhe qarku. Në këtë kontekst, institucionet ligjzbatuese kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur, por sipas renditjes së Tabelës 6, roli i tyre parandalues duhet të realizohet në partneritet me aktorët lokalë.

Së fundi, në këtë studim të anketuarve të sondazhit iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për të ashtuquajturit faktorët e qëndresës. Siç raportohet në Tabelën 7, faktorët kryesorë që bëjnë që individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste janë të ndërlidhura me faktorët e radikalizimit, siç perceptohet nga shumica e shqiptarëve (shih më sipër).

**Pyetja:** *Sipas jush, cilët janë TRE faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë fetare ekstremiste?*

**Tabela 7. Faktorët e qëndresës ndaj ekstremizmit të dhunshëm**

<b>Faktori</b>	<b>Nr. i përgjigjeve</b>	<b>Përqindja e rasteve</b>
Kultura dhe tradita shqiptare e tolerancës fetare	515	44.8
Marrëdhëniet e ngushta shoqërore, familja dhe ndikimi i komunitetit	506	44.0
Arsimi	447	38.9
Gjendja e mirë ekonomike dhe financiare	311	27.0
Shteti (institucionet, reformat, veprimet)	126	11.0
Frika nga pasojat	118	10.3
Përgatitja e klerikëve fetarë	88	7.7
Media	75	6.5
Ateizmi ose indiferenca fetare	59	5.1
Ndërgjegjësimi dhe informacioni i saktë	53	4.6

*Shënim: Kjo është pyetje me shumë zgjedhje si përgjigje. Përqindjet nuk plotësojnë kuotën 100%. Numri i rasteve = 2,298. Numri total i përgjigjeve = 1,150.*

Shumica e të anketuarve të këtij studimi besojnë se faktorët e shoqërisë, si normat, marrëdhëniet ndërkomunitare dhe traditat, mund të kenë ndikim po aq të fortë sa edhe faktorët e qëndresës ndaj ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm. Arsimi (cilësia, të menduarit kritik) renditen në listë si faktori i tretë që mund të minojë shtrirjen dhe ndikimin e ekstremistëve fetarë. Edhe pse arsyet ekonomike renditen të dytët si faktori më i raportuar që mundëson ose nxit radikalizimin fetar të individëve, gjendja e mirë



financiare dhe ekonomike për shqiptarët si faktor qëndrese renditet e katërta (27%) dhe shumë më përpara se roli i institucioneve shtetërore (11%). Konsideratat fetare, qoftë në formën e ndikimit të klerikëve fetarë lokalë apo të indiferencës së perceptuar fetare, raportohen më pak nga të anketuarit e këtij sondazhi.

*Ndryshe nga perspektiva e “trajtimit të pasojave” me anë të shkëputjes dhe riintegritimit, që duket se janë pak të njohura për publikun dhe të trajtuara fare pak nga aktorët e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, shqiptarët në përgjithësi duket se janë më të ndërgjegjësuar dhe të informuar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, për faktorët që çojnë në radikalizim, faktorët e qëndresës dhe për aktorët që duhet të marrin përsipër një rol më të madh. Kështu, edhe pse arsytet ekonomike konsiderohen ende si faktor i rëndësishëm, pjesa më e madhe e të anketuarve të këtij studimi i vënë theksin nivelit të ulët arsimor dhe nivelit të ulët të njohurive për fenë si faktorë që mundësojnë radikalizimin, së bashku me izolimin shoqëror dhe ndikimin e grupeve të huaja të radikalëve fetarë. Institucionet fetare perceptohen si aktori më i rëndësishëm kur vjen puna tek parandalimi i ekstremizmit fetar. Të intervistuarit rendisin më shpesh edhe median, institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile si aktorë të luftës/parandalimit të EDH. Aktorët në nivel komuniteti, si pushteti vendor, gratë dhe të rinjtë, duket se nuk ia kanë dalë të konsiderohen nga publiku në përgjithësi si aktorë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, duke reflektuar kështu në një farë mase edhe tipologjinë e aksioneve parandaluese të ekstremizmit të dhunshëm të ndërmarra deri tani, të drejtuara kryesisht nga aktorët me qendër në Tiranë, qofshin këta shtetërorë apo joshtetërorë. Së fundi, faktorët e qëndresës identifikohen në mjedisin e shoqërisë nga shumica e shqiptarëve, përfshirë këtu faktorë të tillë si tradita e tolerancën fetare, marrëdhëniet e ngushta në komunitet dhe familje, të cilat ende ushtrojnë presion dhe ndikim. Janë përsëri arsimit dhe gjendja e mirë ekonomike që besohet se forcojnë qëndresën ndaj ideologjive ekstremiste. Për t’u habitur është konstatimi se faktorët e lidhur me fenë raportohen më pak si faktorë qëndrese. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë se shqiptarët e shohin të kufizuar rolin e institucioneve fetare dhe të njohurive fetare në një shoqëri që predominojnë jobesimtarët. Kjo do të thotë se edhe pse kapacitetet e duhura të klerikëve dhe informacioni i bollshëm fetar mund të shihen si faktorë kryesorë qëndrese për komunitetin e besimtarëve fetarë, mund të mos jetë gjithnjë kështu për shoqërinë në përgjithësi. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se përgatitja e klerikëve lokalë ka më pak rëndësi duke pasur parasysh faktin se niveli i ulët i njohurive fetare konsiderohet si faktor kyç drejt radikalizimit.*



## VII. Përfundime dhe rekomandime

### VII.1. Çfarë e nxit ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?

Zhënjimi, qeverisja e dobët dhe dobësia e shtetit ligjor, mungesa e mundësive social-ekonomike dhe marginalizimi janë disa nga faktorët strukturorë që konsiderohen se mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, të hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, që iu paraqit Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në janar të vitit 2016. Plani i OKB-së dhe praktika e fundit botërore për masat e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm i referohen edhe faktorëve dhe proceseve individuale që luajnë rol kyç në shndërrimin e zhgënjimeve në veprime ekstremiste të dhunshme, të tilla si konteksti dhe motivet individuale, zhgënjimet kolektive dhe viktimizimi, shtrembërimi dhe abuzimi me besimet ose me udhëheqjen dhe rrjetet sociale.<sup>98</sup>

Ky studim konstaton se gjendja e demokracisë në Shqipëri dhe niveli aktual i zhvillimit social-ekonomik ngrenë shqetësime dhe sfida që, të ndërthurur me faktorë të tjerë, mund të kërcënojnë grupe të veçanta në shoqëri nëpërmjet fuqisë së manipulimit të ideologjive ekstremiste. Ekstremizmi i dhunshëm mundësohet, nxitet dhe formohet nga një larmi faktorësh dhe nxitësish, të cilët veprojnë në një kontekst të veçantë të vendit si në nivelin makro (në nivel shoqërie) ashtu edhe në atë mikro (individ ose grup).<sup>99</sup> Nga kombinimi i faktorëve strukturorë dhe individualë dhe i variablave të tjerë specifike për vendin, siç është edhe roli i klerikëve lokalë dhe aftësitë e tyre, krijohen një sërë rrugësh dhe procesesh individuale drejt radikalizimit. Ky studim ka vlerësuar potencialin dhe shtrirjen e nxitësve social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm dhe ndërveprimin e tyre brenda dhe mes kategorive, si dhe me çështje të tjera specifike të kontekstit që përshkruajnë ose sfidojnë realitetin aktual shqiptar.

**NXITËSIT SOCIAL-EKONOMIKË** – Shqipëria ofron një mjedis mundësues për ideologjitë ekstremiste dhe grupet e ekstremizmit të dhunshëm për të depërtuar tek komunitetet lokale dhe për të rekrutuar pasues. Kjo është veçanërisht e vërtetë për zonat e pazhvilluara dhe periferitë e qendrave kryesore urbane ku janë vendosur shumë banorë nga pjesë të ndryshme të vendit në këtë çerekshkull. Në këto zona, mungesa e komuniteteve kohezive është faktor që bën që të rinjtë si dhe individët me probleme të theksuara social-ekonomike të bien pre e kumarit, drogave dhe sjelljes së rrezikshme, etj. Kur ndërthuren me informalitetin, papunësinë, me shërbimet publike të cilësisë së dobët dhe zhgënjimin e të rinjve, këto probleme të shoqërisë përbëjnë disa nga tiparet më të zakonshme të zonave në Shqipëri ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të gjejnë një mjedis mundësues. Nxitësit social-ekonomikë në veçanti janë kërcënim për grupe të marginalizuara, siç janë të papunët ose të rinjtë, të cilët përballen me përjashtim të vërtetë apo të perceptuar nga mundësitë e zhvillimit ekonomik. Mesazhet e ekstremizmit fetar kanë më pak gjasa të prodhojnë forma të ekstremizmit të dhunshëm të bazuar vetëm te nxitësit social-ekonomikë. Ky studim konstaton se besimi fetar i individëve dhe ekzistenca e një tradite të shëndoshë familjare në ushtrimin e besimit mund të shoqërohen me qëndresë më të madhe ndaj ndikimit

98. Plani i Veprimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm, A/70/674 (24 dhjetor 2015). Burimi: <http://undocs.org/en/A/70/674>

99. Shih "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri" (IDM 2015, f. 110–111).





të disa prej nxitësve social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm. Po ashtu, ato mund të pakësojnë shanset për përfaqimin e ideologjive ekstremiste fetare që janë në kontrast me vlerat e mjedisit rrethues të individit fetar: familjen, rrethin shoqëror dhe komunitetin. Vlera të tilla bëhen pengesë për ekstremistët fetarë në mbjelljen e farave të ideologjive që përplasen me traditën (liberale) të ushtrimit të besimit në Shqipëri, me kulturën e tolerancës dhe bashkëjetesën e mishëruar thellë në marrëdhëniet shoqërore dhe bashkëveprimet për shekuj vëmë radhë.

Ashtu si në shumë vende të tjera, grupet radikale apo ekstremiste që premtojnë përfitime materiale për ndjekësit e tyre kanë më shumë gjasa të rekrutojnë të rinj që udhëhiqen nga lakmia. Ekzistenca e individëve apo grupeve që nxisin ekstremizmin fetar konfirmohet nga përqindje më të mëdha se mesatarja kombëtare, veçanërisht në bashkitë Krujë, Elbasan, Shijak, Durrës, Bilisht dhe Kamëz.

Në Shqipëri, nxitësit social-ekonomikë janë kërcënim i mundshëm për ekstremizmin e dhunshëm duke u kthyer kështu në shqetësim për vendin. Gjithsesi, ato nuk kanë gjasa të bëhen bazë mbështetëse për ideologjitë e EDH dhe të prodhojnë akte të këtij ekstremizmi pa faktorë të tjerë në lojë.

**NXITËSIT POLITIKË** – Kjo kategori e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm na paraqitet më kërcënuese se nxitësit social-ekonomikë, veçanërisht për shkak të përhapjes së zhgënjimit të njerëzve me qeverisjen dhe gjyqësorin. Po ashtu, edhe pse është mendim në minorancë tek shqiptarët, ka një perceptim për diskriminimin me bazë fetare të artikuluar më fuqishëm nga besimtarët praktikantë sesa nga jo-besimtarët. Korrupsioni, pandëshkueshmëria dhe besimi dominues se sistemi politik kontrollohet dhe i shërben vetëm elitave me lidhje të forta ushqejnë mospërfillje të madhe e të përhapur mes shqiptarëve pavarësisht besimit të tyre fetar. Shumica e shqiptarëve, veçanërisht ata që nuk besojnë, nuk raportojnë diskriminim apo keqtrajtim fetar nga institucionet shtetërore për shkak të përkatësisë fetare të qytetarëve. Duke pasur parasysh sfidat e shtetit ligjor dhe qeverisjes demokratike në Shqipëri, ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm mund të depërtojnë tek komunitetet lokale dhe mesazhet e tyre mund të mos jenë domosdoshmërisht vetëm fetare. Prania e ekstremistëve dhe individëve fetarë që ushtrojnë presion ndaj besimtarëve fetarë për t'iu bashkuar kauzave ekstremiste është konfirmuar veçanërisht në bashkitë Shijak, Vorë, Elbasan, Vlorë, Krujë, Durrës, Kavajë dhe Kamëz. Në shumë nga këto zona, dhe në bashki të tjera si Lezhë, Kukës, Kurbin, Përrenjas, Peqin, Pogradec, Bilisht dhe Librazhd, studimi konstatoi përqindje të konsiderueshme të të anketuarve, si fetarë dhe jofetarë, që tregojnë prirje për të favorizuar veprime radikale apo mesazhe të tjera ekstremiste.

Shqiptarët priren të mos jenë dakord me idetë e konspiracionit botëror, me mesazhe si “Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame”. Gjithsesi, ata duken se janë më pak skeptikë për rritjen e trajtimit preferencial në rajon, për shembull që vendet me shumicë të krishterë në Ballkan gëzojnë më shumë mbështetje nga Perëndimi sesa vendet me shumicë myslimane. Edhe pse këto nuk janë qëndrime që dominojnë tek shqiptarët, përfshirë këtu edhe të anketuarit fetarë, perceptime të tilla janë më të pranishme tek besimtarët praktikantë. Kjo gjë sugjeron se mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm për diskriminimin dhe kërcënimet globale kanë më pak gjasa të gjejnë vend mes besimtarëve fetarë shqiptarë sesa ato që ndërtohen mbi realitetet më konkrete në Ballkan. Ka dy herë më shumë shqiptarë (13%) që besojnë se organet ligjzbatuese janë më të ashpër me myslimanët praktikantë sesa me të krishterët praktikantë (7%). Më shumë se 1/3 e shqiptarëve do të justifikonin vetëgjyqësinë nëse të drejtat dhe liritë e tyre mohohen nga institucionet shtetërore. Të gjithë të anketuarit në Cërrik dhe



Përrenjas dhe më shumë se gjysma e të anketuarve në Lezhë, Librazhd, Kurbin, Kamëz dhe Kavajë, ishin dakord me këtë pohim. Profilet e të anketuarve që shfaqin qëndrime tepër shqetësuese për nxitësit politikë janë më së shumti nga zonat rurale, me nivel më të ulët arsimor (arsim fillor ose më pak), meshkuj, të papunë dhe të moshës deri në 35 vjeç. Nga analiza e nxitësve politikë të ekstremizmit të dhunshëm konstatohet një terren pjellor për mesazhet politike jo-fetare (p.sh., populiste apo antiestablishment), të cilat mund të përfitojnë nga mosangazhimi i publikut dhe mosbesimi në përgjithësi tek një sistem qeverisës që perceptohet se i shërben vetëm elitave me lidhje të forta. Kombinimi i mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm që vijnë nga nxitësit politikë me ato që manipulojnë ndjenjat fetare apo i fryjnë perceptimeve të përjashtimit, diskriminimit dhe keqtrajtimit për shkak të përkatësisë fetare përbëjnë kërcënime më të mëdha për besimtarët fetarë.

**NXITËSIT KULTURORË** – Kjo kategori nxitësish ngre shqetësime për komunitetin e besimtarëve fetarë. Edhe pse shumica e shqiptarëve nuk i njohin çështjet që mesazhet ekstremiste pretendojnë se vlejnë edhe për Shqipërinë, disa nga këto mesazhe mund të justifikohen nga një përqindje jo e pakonsiderueshme besimtarësh dhe të intervistuarish fetarë të moshës 30 deri në 40 vjeç. Perceptimet se “Perëndimi po sulmon vazhdimisht Islamin” janë të pranishëm në përqindje të larta në bashkitë Kavajë (61%), Shijak (40%) dhe Kamëz (34%). Për më tepër, një në pesë shqiptarë besojnë se besimi dhe dinjiteti i tyre fetar janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. Kombinimi i këtyre rezultateve me nxitësit politikë, siç është perceptimi për diskriminimin apo keqtrajtimi nga organet ligjzbatuese, tregon se ato mund të përforcojnë njëra-tjetrën, duke e kthyer komunitetin e besimtarëve fetarë në shënjestër të lehtë për ekstremizmin e dhunshëm. Edhe sinergjitë e mundshme mes nxitësve kulturorë dhe social-ekonomikë mund të çojnë në radikalizim. Ky studim tregon se disa kategori, si të rinjtë dhe anëtarët e familjeve me vështirësi ekonomike, mund të jenë të bien pre e ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht kur sapo janë prezantuar me besimin fetar ose vijnë nga familje më pak fetare. Këta njerëz nuk janë në gjendje të kontekstualizojnë pretendimet e grupeve fetare të ekstremizmit të dhunshëm, për shembull, sepse ata janë më pak të informuar dhe u mungon tradita solide e ushtrimit të besimit.

**ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR KONTEKSTIN** – Shqiptarët nuk janë edhe aq fetarë për sa i përket ushtrimit të fesë. Ata tregojnë mbështetje masive për tolerancën ndërfetare si vlerë e shoqërisë dhe për bashkekzistencën fetare si traditë të konsoliduar mes tyre. Ky studim konfirmon mbështetjen e pabesueshme për tolerancën fetare, duke qenë se më pak se një për qind e shqiptarëve e përshkruajnë vendin sot si të dominuar nga urrejtja fetare. Institucionet fetare janë institucionet kombëtare më të besuara sipas publikut shqiptar. Shumica tregojnë nivel të lartë besimi në artikullimin e autoritetit fetar nga kreu në bazë, edhe pse ata shprehin perceptime më skeptike të kapaciteteve dhe ndikimit të klerikëve lokalë.

Publiku i gjerë është pak i informuar rreth çështjeve që lidhen me shkëputjen dhe riintegrimin e ish ekstremistëve, luftëtarëve të huaj ose personave të radikalizuar. Shumica e shqiptarëve duken pesimistë për shkëputjen nga ideologjitë radikale apo ekstremiste fetare, ndërsa pothuajse gjysma i konsiderojnë të rikthyerit si kërcënim për shoqërinë. Gjithsesi, shumica besojnë se institucionet shtetërore duhet të punojnë për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të angazhuar në konfliktet jashtë vendit. Mungesa e një debati të informuar mes aktorëve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe mungesa e veprimeve konkrete për programet e shkëputjes (rehabilitimit) dhe riintegrimin në vend e mban publikun të painformuar



dhe shpeshherë në dilemë. Kjo nuk ndodh kur bëhet fjalë për faktorët e përgjithshëm, aktorët dhe masat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Shumica e shqiptarëve e konsiderojnë arsimin e dobët dhe mungesën e njohurive fetare si dy nga faktorët kryesorë që mundësojnë radikalizimin, së bashku me problemet ekonomike. Ata janë të informuar për aktorët e parandalimit të EDH dhe identifikojnë faktorët e qëndresës në mjedisin shoqëror, si toleranca fetare, arsimi dhe tradita e besimit.

**FAKTORËT E QËNDRESËS** – Ndonëse studimi ka përcaktuar një sërë nxitësish që mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin shqiptar, ai ka evidentuar edhe faktorët që krijojnë qëndresën dhe që mund të luftojnë efektet dhe rreziqet që vijnë nga kategori të ndryshme nxitësish. Së pari, komunitetet vigjilente dhe të lidhura kanë më shumë gjasa të kundërveprojnë ndaj nxitësve social-ekonomikë. Edhe tradita familjare në praktikimin e fesë dhe besimi fetar mund të jenë faktorë qëndresë ndaj disa prej efekteve negative të mjedisit social-ekonomik. Së dyti, arsimimi duket se është një nga faktorët kryesorë të qëndresës ndaj nxitësve politikë. Së treti, komunitetet më të hapura që luftojnë paragjykimet dhe ndikohen më pak nga konceptimet e gabuara për sa i përket praktikimit të fesë përbëjnë një tjetër mundësi për forcimin e qëndresës ndaj nxitësve politikë, por edhe atyre kulturorë, të ekstremizmit të dhunshëm. Për krijimin e komuniteteve të tilla një rol kryesor duhet të luajnë jo vetëm institucionet shtetërore dhe ato fetare, por edhe shoqëria civile, sistemi arsimor dhe media. Edhe pse në perceptimin e publikut të rinjtë dhe gratë nuk lidhen fort me rolin e një aktori të rëndësishëm për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel komuniteti, angazhimi i tyre duhet të kthehet përparësi në rritje në Shqipëri.


Për pjesën më të madhe të çështjeve të analizuara në këtë studim, nuk u vunë re dallime të mëdha mes qëndrimeve dhe perceptimeve të burrave dhe grave, me disa përjashtime. Së pari, gratë priren të tregojnë më shumë rezistencë se burrat ndaj qëndrimeve që justifikojnë dhunën ose veprime të tjera të paligjshme, ndërkohë që një numër më i madh grave krahasuar me burrat refuzojnë aktivitetet e paligjshme për hir të mbijetesës së përditshme. Po ashtu, përqindja e grave që përkrahin përdorimin e dhunës për të ndryshuar një sistem politik që perceptohet si i padrejtë është më e vogël se e burrave. Së dyti, për disa pohime të ndjeshme (p.sh. Perëndimi sulmon vazhdimisht vendet islamike; prania e individëve ose grupeve të ekstremizmit të dhunshëm në zonën e tyre) numri i grave që japin përgjigjen “nuk e di” është më i madh se ai i burrave. Ky konstatim tregon se roli i grave në këtë kontekst përbën një mundësi dhe një sfidë në të njëjtën kohë. Nga njëra anë ato tregojnë një shkallë më të lartë qëndrese ndaj ekstremizmit të dhunshëm, por nga ana tjetër ata priren të mos komentojnë çështje të ndjeshme, përfshirë këtu edhe denoncimin e individëve ekstremistë në zonat e tyre.



## VII.2. Shtrirja e ekstremizmit fetar në Shqipëri

Gjetjet e këtij studimi sugjerojnë se fenomeni i ekstremizmit fetar është i izoluar në Shqipëri, ndonëse ende i pranishëm dhe potencialisht kërcënues. Në mënyrë specifike, një në dhjetë shqiptarë konfirmojnë praninë e individëve ekstremistë në zonën ku jetojnë, që nxisin ekstremizmin e krishterë apo islamik, që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar, ose që u bëjnë presion besimtarëve fetarë t'i bashkohen kauzave ekstremiste.

**Figura 69. Opinioni i të anketuarve për praninë e individëve ekstremistë fetarë në Shqipëri (%)**



Prania e këtyre individëve konfirmohet nga përqindje afërsisht e ngjashme shqiptarësh që praktikojnë të gjitha ritet fetare, që praktikojnë ritet kryesore fetare dhe ata që nuk praktikojnë asnjë rit fetar. Me sa duket, veprimet dhe përpjekjet e mëdha të kryera nga aktorët shqiptarë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm gjatë tre viteve të fundit kanë penguar përhapjen e fenomenit dhe të disa prej formave në të shfaqej ai, siç janë luftëtarët e huaj. Megjithatë, shtrirja dhe potenciali për t'u rishfaqur janë ende të pranishme, sepse nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm fetar ende paraqesin kërcënim për disa zona të vendit, ndërkohë që mesazhet që frymëzojnë një fenomen të tillë duket se përçohen mes linjave radikale dhe ekstremiste.

## VII.3. Besimi fetar, ekstremizmi fetar dhe potenciali për ekstremizmin jofetar


Shqiptarët në përgjithësi bëjnë një jetë laike dhe kanë pak informacion për fetë. Vetëm rreth dy në dhjetë shqiptarë praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare dhe luten/falen rregullisht çdo ditë ose javë. Në përgjithësi, përkatësia fetare nuk është e rëndësishme për krijimin e marrëdhënieve më të ngushta. Megjithatë, gati një në dhjetë shqiptarë do të kundërshtonin martesën ndërfaqetare të një anëtarë të familjes. Gjatë viteve të fundit, në diskutimet dhe veprimet e shumë prej aktorëve institucionalë, punonjësve dhe hulumtuesve është trajtuar kryesisht ekstremizmi fetar duke u fokusuar veçanërisht



në keqinterpretimin fetare ose ideologjitë ekstremiste fetare. Me fare pak veprime apo fokus tek format e tjera të ideologjive (jofetare) që mund të frymëzojnë ekstremizmin e dhunshëm, ndonjëherë në perceptimet e publikut besimi i devotshëm fetar identifikohet gabimisht si rrezik apo shenjë ekstremizmi. Fakti që gati 30 për qind e shqiptarëve besojnë se mbajtja e mjekrës nga meshkujt apo mbulimi me shami nga gratë janë shenja me të cilat identifikohen ekstremistët fetarë është një shembull i qartë.

Studimi hedh dritë edhe tek potenciali i ekstremizmit të dhunshëm jofetar i lënë jashtë vëmendjes. Shqipëria përballlet me sfida edhe më të mëdha në këtë drejtim. Potenciali për mesazhe anti-establishment dhe populiste që mund të nxisin lindjen e ekstremizmit të tillë jofetar mbështetet kryesisht tek nxitësit social-ekonomikë dhe, veçanërisht, tek ata politikë. Mes 1/3 dhe 1/2 e shqiptarëve do të justifikonin veprimet që kapërcejnë kufijtë e ligjit. Gati gjysma mendojnë se sistemi politik në vend është i padrejtë dhe duhet të ndryshohet, madje edhe me dhunë nëse është e nevojshme. Më shumë se 1/3 do të justifikonin vetëgjyqësinë kur shteti u mohon të drejtat dhe liritë. Një përqindje e ngjashme të anketuarish do të justifikonin çdo aktivitet, edhe të paligjshëm, për hir të mbijetesës së përditshme. Këto të dhëna flasin për potencialin që kanë mesazhet anti-establishment, populist dhe mesazhet e tjera politike për të qenë të suksesshme në kontekstin shqiptar për shkak të mosbesimit shumëvjeçar dhe humbjes së shpresave se qeverisja dhe shteti ligjor në Shqipëri do t'ia dalin mbanë. Siç tregohet edhe në Figurën 70, premtimet e ekstremizmit jofetar kanë më shumë potencial sesa prania e konfirmuar e elementëve ekstremistë fetarë në Shqipërinë e sotme.

**Figura 70. Prania e konfirmuar e ekstremizmit të dhunshëm fetar dhe potenciali për mesazhet ekstremiste jofetare (%)**



### VII.4. Rruga përpara

Në këto tre vitet e fundit Shqipëria ka punuar mirë në luftën dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare dhe përhapjen e mesazheve ekstremiste



në nivel vendor e kombëtar. Largimi i më shumë se 100 shqiptarëve nxiti reagimin e menjëhershëm të autoriteteve. Në vitin 2014 u hartua dhe u vu në zbatim një plan veprimi për luftën dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, me anë të të cilit u bashkërenduan përpjekjet e institucioneve shtetërore në nivel qendror, të komuniteteve fetare dhe shoqërisë civile. Megjithatë, ekstremizmi fetar mbetet një fenomen në vend dhe përbën rrezik potencial, veçanërisht duke qenë se në nivel vendor duhet të ndërmerren më shumë masa për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ky studim ofron njohuri të rëndësishme për të bërë të mundur që të kuptohen sa më mirë nxitësit të ekstremizmit të dhunshëm, faktorët specifikë për kontekstin dhe komunitetet në rrezik, aktorët dhe faktorët që potencialisht mund të shndërrohen në instrumente të forta për të forcuar qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Një në dhjetë shqiptarë kanë raportuar praninë e individëve apo grupeve që mbështesin ose nxisin ekstremizmin fetar në zonën e tyre. Sipas këtij studimi, nxitësit më të rrezikshëm të ekstremizmit të dhunshëm që mund të përdoren nga ekstremistët fetarë për të radikalizuar besimtarët janë ato që i bëjnë jehonë diskriminimit, përjashtimit, paragjyqimeve ose mesazheve të tjera fetare që kundërshtojnë vlerat e lirisë fetare, bashkëjetesës, barazisë dhe përfshirjes. Mesazhet ekstremiste fetare mund të gjejnë më shumë hapësirë për të promovuar axhendën e tyre duke ndërthurur nxitësit politikë dhe kulturorë. Manipulimi i ndjenjave fetare të besimtarëve duke përdorur vetëm nxitësit social-ekonomikë ka më pak të ngjarë të jetë i suksesshëm, ndonëse nuk duhet përjashtuar ai në një mjedis shoqëror të perceptuar nga disa besimtarë fetarë si diskriminues ndaj tyre.

Ky studim konstaton se Shqipëria nuk i ka kushtuar rëndësi potencialit të ekstremizmit jofetar në vend dhe është fokusuar më shumë tek ekstremizmi fetar. Gati një e treta e shqiptarëve do të justifikonin mjetet e paligjshme për hir të mbijetesës. Po e njëjta përqindje do të justifikonin vetëgjyqësinë kur shteti u mohon të drejtat dhe liritë. Pothuajse gjysma e shqiptarëve (47.7%) do të justifikonin dhunën për të ndryshuar një sistem politik që perceptohet aktualisht si i padrejtë dhe që i shërben vetëm elitave me lidhje të forta. Duke pasur parasysh pakënaqësinë e shumë shqiptarëve, grupet anti-establishment, radikale dhe të tjera populiste mund të gjejnë terren të përshtatshëm për të përhapur mesazhet e tyre ekstremiste tek njerëzit, pavarësisht besimit të tyre fetar, dhe veçanërisht nëse ia arrijnë të vendosin lidhjen me nxitësit politikë dhe social-ekonomikë.

Edhe pse lista e mëposhtme për masat prioritare nuk është shteruese, në të përfshihen nevojat më urgjente për ta shndërruar platformën aktuale të veprimit të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm që fokusohet tek ekstremizmi i dhunshëm fetar në vend në një kuadër të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial për qëndresën e komunitetit ndaj të formave dhe ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm, qofshin ato fetare apo jofetare:

1. Vendimmarrësit kombëtarë duhet të shqyrtojnë strategjinë aktuale KEDH dhe të zgjerojnë objektin e planit të saj të veprimit për të përfshirë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm.
2. Autoritetet shtetërore, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm duhet të rrisin fokusin e tyre tek qëndresa e komunitetit. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të asistohen në punën e tyre për përshtatjen e planeve të qëndresës së komunitetit me qëllim që të trajtohen problematikat e komunitetit. Këto plane të mbështeten në përfshirjen e aktorëve publikë, privatë dhe shoqërorë në nivel vendor.





3. Strategjitë sektoriale që mbulojnë çështje të caktuara ku trajtohen të gjithë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm duhet të përfshijnë edhe masa që trajtojnë problematikat, nevojat dhe përparësitë që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.
4. Masat që merren me synim parandalimin duhet të përshtaten për grupe të caktuara që janë në rrezik. Në vend që të punohet me metodën “një numër bën për të gjithë”, në veprimet e parandalimit duhet të merren parasysh larmia e grupeve në rrezik dhe numri i madh i nxitësve. Për shembull, besimtarët janë më në rrezik nga mesazhet ekstremiste fetare që synojnë të manipulojnë faktorë të ndryshëm të nxitësve kulturorë dhe politikë të ekstremizmit të dhunshëm. Besimtarët fetarë tregojnë më shumë rezistencë se grupet e tjera ndaj nxitësve social-ekonomikë. Po ashtu, ky studim tregon se femrat i refuzojnë mesazhet ekstremiste që justifikojnë dhunën, por ato duhet të fuqizohen për të ngritur më shumë zërin kundër mesazheve të tjera ekstremiste.
5. Duhet t’u jepet përparësi zonave gjeografike me rrezik të lartë dhe mesazheve ekstremiste që nuk iu është kushtua vëmendja e duhur. Rreziku që vjen nga ekstremizmi jofetar, i lënë pas dore për një kohë të gjatë, kërkon marrjen e masave urgjente për rikthimin e besimit tek qeverisja dhe shteti ligjor në Shqipëri, shoqëruar me përmirësimin e analizës dhe rritjen e njohurive në hartimin e strategjive më afatgjate kundër alternativave politike populiste dhe të tjera radikale.
6. Edhe pse toleranca fetare është vlerë me bazë të fortë në shoqërinë shqiptare, është me rëndësi të vazhdohet me promovimin e pranimit dhe përfshirjes së besimtarëve praktikantë. Pa këtë, besimtarët mund të ndjehen të lënë pas dore dhe mund të bëhen më të vëmendshëm ndaj mesazheve ekstremiste fetare. Investimi në kapacitetet e autoriteteve fetare dhe inkurajimi i hapjes së tyre, dialogut dhe veprimeve do të ishin një qasje efektive për parandalimin e ekstremizmit fetar, duke qenë se këto autoritete gëzojnë besim të madh tek shqiptarët.
7. Nuk duhet të lihet më jashtë vëmendjes hapja e programeve të rehabilitimit dhe riintegritimit. Shumica e shqiptarëve mbështesin rikthimin dhe riintegrimin e ish luftëtarëve. Megjithatë, mungesa e një debati të informuar dhe e veprimeve konkrete nga ana e aktorëve kryesorë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm kontribuon në konfuzionin e përgjithshëm që ekziston në lidhje me të rikthyerit dhe përbën një mundësi të humbur për riintegrimin e tyre konstruktiv.
8. Aktorëve komunitarë duhet t’u jepet mundësia t’u dëgjohet më shumë zëri dhe t’u sigurohen kapacitete dhe mjete për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me qëllim që të rritet vigjilenca dhe të mundësohen komunitete kohezive në nivel vendor. Duhet të promovohen qasje dhe modele me përfshirjen e shumë aktorëve, ku të bëhen bashkë dhe të koordinohen veprimet e qeverisë qendrore dhe pushteti vendor, shoqërisë civile, komuniteteve fetare, medias, botës akademike, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë.





## VIII. Shtojca


### VIII.I. Shpërndarja e kampionit të sondazhit

Qarku	Bashkia	Numri i të anketuarve
Berat	Berat	37
	Kuçovë	18
	Skrapar	10
	Ura Vajgurore	15
Dibër	Bulqizë	17
	Dibër	34
	Klos	10
	Mat	15
Durrës	Durrës	102
	Krujë	34
	Shijak	20
Elbasan	Belsh	11
	Cërrik	16
	Elbasan	81
	Gramsh	13
	Librazhd	18
	Peqin	15
	Përrenjas	14
	Fier	20
Fier	Divjakë	20
	Fier	69
	Lushnje	47
	Mallakastër	15
	Patos	13
	Roskovec	12
	Gjirokastrë	21
Gjirokastrë	Tepelenë	10
	Korçë	15
Korçë	Korçë	49
	Maliq	23
	Pogradec	36
	Kukës	10
Kukës	Has	10
	Kukës	27
	Tropojë	11



■ EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË SHQIPËRI

Lezhë	Kurbini	26
	Lezhë	38
	Mirditë	12
Shkodër	Malësi e Madhe	17
	Pukë	10
	Shkodër	77
	Vau i Dejës	18
Tiranë	Kamzë	61
	Kavajë	23
	Rrogozhinë	13
	Tiranë	332
	Vorë	15
Vlorë	Finiq	6
	Konispol	5
	Sarandë	12
	Selenicë	10
	Vlorë	67
<b>12 qarqe</b>	<b>50 bashki</b>	<b>Gjithsej, 1,600</b>



## VIII.2. Pyetësi i sondazhit



**Institute for Democracy and Mediation**  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim**

### **PYETËSOR**

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Ambasadës së ShBA në Shqipëri është duke zhvilluar një hulumtim mbi komunitetet fetare dhe shoqërinë në Shqipëri, në kuadër të të cilit po zbatohet ky sondazh me qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Qëllimi i sondazhit është të analizojë perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve të anketuar lidhur me besimin fetar, marrëdhëniet brenda dhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare si edhe qëndrimet e shoqërisë dhe institucioneve ndaj tyre.

Gjetjet e studimit do të informojnë politikë-bërjen në vend për të nxitur harmoninë fetare si një vlerë të shoqërisë shqiptare dhe për të parandaluar faktorët dhe tendenca të ndryshme që dëmtojnë bashkëjetesën fetare. Individëve që marrin pjesë në këtë studim nuk u ofrohen përfitime materiale.

Ju mund të vendosni të mos merrni pjesë në anketim, ose mund të më bëni me dije që preferoni të mos i përgjigjeni një pyetjeje specifike dhe unë do ta kapërcej atë pyetje. Nuk është e nevojshme që t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëjnë të ndiheni jo-komod si edhe duhet të keni parasysh që nuk ka përgjigje të drejta apo të gabuara. Nëse dëshironi, ju mund ta mbyllni intervistën në çdo kohë dhe kjo nuk do të ndikojë në marrëdhënien tuaj me IDM-në apo me financuesit e projektit.

Në garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësi do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj. Të vetmit njerëz që do të kenë akses mbi këtë informacion janë hulumtuesit e studimit. Kur të paraqesim rezultatet e studimit, në nuk do t'i bëjmë lidhje emrit tuaj/të dhënave personale me gjithçka që ju shprehët.

Për çdo pyetje rreth studimit, ose nëse shfaqen probleme, ju mund të kontaktoni IDM-në në adresën email: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org) ose në numrin e telefonit: 04 24 00 241.

#### PËR ANKETUESIN: SHËNO TË DHËNAT E INTERVISTËS

Anketues	Intervista nr.	Bashkia	Qyteti	Fshati



## I. SEKSIONI 1: DEMOGRAFIA

### 1. SHËNO GJININË E TË ANKETUARIT:

Mashkull	I
Femër	2

### 2. Mosha \_\_\_\_\_ (në vite)

### 3. Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni kryer?

Pa arsim/Më pak se arsim 8-vjeçar	I
Arsim 8/9-vjeçar	2
Arsim i mesëm	3
Arsim i lartë	4
Arsim pasuniversitar	5
Refuzim	99

### 4. Statusi civil

I/E martuar	I
I/E pamartuar por në bashkëjetesë	2
Beqar/e	3
I/E divorcuar	4
I/e ve	5
Refuzim	99

### 5. Statusi i punësimit

I/E punësuar	I
I/E vetëpunësuar	2
I/E papunë	3
Student/e	4
Tjetër (Specifiko _____)	5
Refuzim	99

### 6. Sa janë të ardhurat (neto) tuaja personale mujore?

Pa të ardhura personale	I
Deri në 20.000 lekë	2
20.001- 40.000 lekë	3
40.001- 60.000 lekë	4
60.001 – 100.000 lekë	5
+100.000 lekë	6
Refuzim	99



7. Cila është përkatësia fetare e familjes suaj të origjinës?

Myslimane	1
Ortodokse	2
Katolike	3
Bektashi	4
Protestante	5
E përzier	6
Tjetër _____	7
Nuk e di/ Nuk jam i/e sigurt	88
Refuzim	99

8. Besimi juaj fetar është i njëjtë me atë të prindërve tuaj?

Po, të dy prindërit e mi kanë të njëjtën përkatësi fetare si unë	1
Po, me njërin prej prindërve	2
Jo	3
Nuk e di/Refuzim	99

9. Ju personalisht, a jeni praktikant/e i/e rregullt i/e fesë?

Po, i praktikoj rregullisht ritet dhe rregullat fetare	1
Kryesisht PO, praktikoj ritet kryesore fetare	2
Jo, jam besimtar/e por nuk i praktikoj fare ritet fetare	3
<u>Jo, jam ateist</u>	4
<u>KALO TEK SEKSIONI 2</u>	
Refuzim	99

10. Mund të më thoni se sa shpesh luteni/faleni:

Rregullisht (çdo ditë/ javë)	Në festa fetare përgjatë gjithë vitit	Vetëm me raste, në ngjarje të veçanta fetare	Vetëm me raste, në kohë krize personale/ familjare	Asnjëherë	Refuzim
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(99)



## II. SEKSIONI 2: FEJA, SHOQËRIA DHE FAKTORËT SOCIAL-EKONOMIKË

11. Duke pasur parasysh komunitetin ku jetoni, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUK E DI
Në komunitetin ku jetoj familja ka gjithnjë e më pak kontroll/ndikim tek të rinjtë	1	2	3	4	88	99
Sjellja e të rinjve ndikohet ndjeshëm nga opinioni i komunitetit të banorëve	1	2	3	4	88	99
Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumar, alkool, droga etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhuna, akte vandalizmi etj.)	1	2	3	4	88	99
Familja ka qenë shtysa kryesore për praktikimin e fesë nga ana e shumicës së besimtarëve që njoh	1	2	3	4	88	99
Shumica e njerëzve që njoh janë bërë besimtarë praktikante për shkak të rrethit të tyre shoqëror	1	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj veproj në individë/grupe që nxisin ekstremizmin e krishterë.	1	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj veproj në individë/grupe që nxisin ekstremizmin islamik	1	2	3	4	88	99

12. Sipas eksperiencës suaj, si do t'i vlerësonit pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUK E DI
Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar	1	2	3	4	88	99



Mjekra (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë	I	2	3	4	88	99
Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politike dhe institucione shtetërore	I	2	3	4	88	99

13. Cili është vlerësimi juaj lidhur me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUK E DI
Punëkërkuarit e mirë-arsimuar duhet të pranojnë edhe vende pune për të cilat ata janë të mbikualifikuar	I	2	3	4	88	99
Në përgjithësi, të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune	I	2	3	4	88	99
Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme	I	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime	I	2	3	4	88	99
Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë privilegje ose përfitime materiale/ekonomike praktikantëve të fesë së tyre	I	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj ka shumë familje/individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës	I	2	3	4	88	99
Disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja	I	2	3	4	88	99
Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, edhe atë të paligjshëm	I	2	3	4	88	99
Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet	I	2	3	4	88	99





### III. SEKSIONI 3: FEJA DHE FAKTORËT (NDËR)SHTETËRORE/POLITIKË

14. Deri në ç'masë pohimet e mëposhtme reflektojnë qëndrimet tuaja? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUKE DI
Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë civile të qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore	1	2	3	4	88	99
Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë e duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja	1	2	3	4	88	99
Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë	1	2	3	4	88	99
Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë të krishterë	1	2	3	4	88	99
Zbatimi i Sheriatit (Legjislacioni Islam) duhet të lejohet për besimtarët myslimanë në Shqipëri	1	2	3	4	88	99
Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë dhe të drejtat nga institucionet shtetërore	1	2	3	4	88	99

15. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUKE DI
Përfshirja ose nxitja e përfshirjes në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar	1	2	3	4	88	99
Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët	1	2	3	4	88	99



Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim	1	2	3	4	88	99
Vendet me besim fetar të fortë kanë qeveri më pak të korruptuara	1	2	3	4	88	99
Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi	1	2	3	4	88	99
Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti	1	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezencë e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët	1	2	3	4	88	99
Prezencë e "shtetit" si ligjzbatues dhe ofrues i shërbimeve publike është më e ulët në fshat sesa në qytete	1	2	3	4	88	99
Në zonën ku jetoj ka individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm me baza fetare	1	2	3	4	88	99
Në zonën ku banoj ka individë radikalë që u bëjnë presion besimtarëve t'i bashkohen kauzave ekstremiste	1	2	3	4	88	99
Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare	1	2	3	4	88	99

16. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUK E DI
Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame	1	2	3	4	88	99
Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame	1	2	3	4	88	99
Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare	1	2	3	4	88	99



Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina & Maqedonia)	I	2	3	4	88	99
SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina & Maqedonia)	I	2	3	4	88	99

#### IV. SEKSIONI 4: PRAKTIKIMI I FESË NË SHQIPËRI

17. Sipas eksperiencës dhe/ose perceptimit tuaj, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/ S'ka lidhje	NUK E DI
Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame	I	2	3	4	88	99
Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë	I	2	3	4	88	99
Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator	I	2	3	4	88	99
Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm	I	2	3	4	88	99
Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare në vend	I	2	3	4	88	99
Islami tradicional në Shqipëri sulmohet vazhdimisht nga grupe ekstremiste fetare jashtë vendit	I	2	3	4	88	99
Predikimet fetare në Shqipëri duhet të përshtaten me tendencat moderne e perëndimore të vendit	I	2	3	4	88	99
Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë Islame	I	2	3	4	88	99



Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë se krishterë	I	2	3	4	88	99
Objektet e kultit (kisha, xhamia, etj.) të ngritura pa lejen e komunitetit fetar përkatës duhen ndaluar	I	2	3	4	88	99
Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tirane) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj	I	2	3	4	88	99
Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët	I	2	3	4	88	99
Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin/formimin e duhur fetar	I	2	3	4	88	99

#### V. SEKSIONI 5. REINTEGRIMI DHE PARANDALIMI

18. Cili është qëndrimi juaj personal lidhur me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante/S'ka lidhje	NUK E DI
Është e pamundur që besimtarët e radikalizuar të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare	I	2	3	4	88	99
Është e pamundur që ekstremistët e dhunshëm të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste fetare	I	2	3	4	88	99
Rikthimi i shtetasve shqiptarë që kanë qenë pjesë aktive e luftës në Siri përben kërcënim për shoqërinë	I	2	3	4	88	99
Organet shtetërore duhet të angazhohen për rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit	I	2	3	4	88	99
Organet shtetërore duhet të riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por nuk kanë kryer krime	I	2	3	4	88	99



■ EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË SHQIPËRI

Përfshirja e njohurive fetare si lëndë me zgjedhje në shkolla do të forconte tolerancën fetare në Shqipëri	1	2	3	4	88	99
--	---	---	---	---	----	----

19. Cila është përkatësia fetare e shumicës së rrethit tuaj shoqëror?

Persona të të njëjtit besim fetar si unë	1
Persona me besime të ndryshme fetare	2
Ateistë	3
Të përzierë (ateistë dhe besimtarë të feve të ndryshme)	4
Nuk e di, nuk e kam menduar kurrë	5
Refuzim	99

20. Sipas mendimit tuaj në Shqipëri ka kryesisht:

JU LUTEM VLERËSONI NË NJË SHKALLE NGA 1 NË 4 KU "1 = URREJTJE FETARE" DHE "4=HARMONI FETARE

Urrejtje fetare			Harmoni fetare
1	2	3	4

21. Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes suaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) të martohej me një person të një besimi tjetër fetar?

Patjetër që po	1
Do ta pranoja por nuk do ta mbështesja/inkurajoja	2
Do ta kundërshtoja në çdo rast	3
Do ta kundërshtoja nëse personi me të cilin/ën martohej është besimtar praktikant	4
Nuk jam i/e sigurt	5
Refuzim	99

22. Sipas jush, cilat janë TRE arsyt kryesore që krijojnë ose nxitin radikalizimin fetar tek individët në Shqipëri?

Arsyet ekonomike (p.sh., papunësia, varfëria, etj.)	1
Niveli i ulët arsimor	2
Izolimi shoqëror	3
E shkruara kriminale (persona me precedentë penalë)	4
Paaftësia e klerit	5
Paaftësia e institucioneve shtetërore	6
Ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë	7
Niveli i ulët i njohurive fetare	8



Tjetër (Specifiko:_____)	9
Nuk e di/Refuzim	99

23. Sipas jush, cilët janë TRE faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë fetare ekstremiste?

---



---



---

24. Sipas jush, cilët janë TRE aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri?

Pushteti vendor	I
Shërbimet e ndihmës sociale	2
Klerikët lokalë	3
Drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare	4
Institucionet ligjzbatuese (policia, prokuroria, gjykatat)	5
Pushteti qendror (Qeveria, ministritë)	6
Media	7
Shoqëria civile	8
Gratë	9
Të rinjtë	10
Shkollat	11
Besimtarët	12
Tjetër (Specifiko:_____)	13
Nuk e di/Refuzim	99

## Ju faleminderit



## IX. Bibliografia

- Balkan Insight*. 2017. "Turkey Presses Albania To Extradite Key 'Gülenist' Suspect." Marrë nga adresa: <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-to-face-turkish-request-to-extradite-gulen-supporter-10-13-2017>
- Balkan Insight*. 2018. "Vetting Process Leaves Albanian Courts Unable to Work." Marrë nga adresa: <http://www.balkaninsight.com/en/article/vetting-process-leaves-albanian-courts-unable-to-work-07-18-2018>
- Balkan Insight*. 2018. "Kosovo Leads World in Cheering for Trump, Poll Shows." (18 January 2018.) Marrë nga adresa: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-shows-highest-support-for-us-leadership-in-europe-poll-01-18-2018>
- Balkan Post*. 2018. "Erdogan steps up pressure on Albania's PM Edi Rama to get rid of all Gülen assets in the country." Marrë nga adresa: <http://balkanspost.com/article/79/erdogan-g%C3%BClen-albania>
- Banka Botërore, 2007. "Migracioni dhe lëvizshmëria." Marrë nga adresa: <http://documents.worldbank.org/curated/en/445651508415857577/pdf/120539-replacement-PUBLIC.pdf>
- BIRN. 2014. *Zanafilla e islamit radikal në Shqipëri*. Marrë nga adresa: <https://www.reporter.al/zanafilla-e-islamit-radikal-ne-shqiperi/>
- Bogdani, A. 2016. *Fshatrat e xhihadit: Si u rekrutuan të rinjtë për të luftuar në Siri*. Marrë nga adresa: <https://www.reporter.al/fshatrat-e-xhihadit-si-u-rekrutuan-te-rinjte-per-te-luftuar-ne-siri>
- British Council. 2018. "Extremism research forum – Albania report." Marrë nga adresa: <https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/erf20albania20report202018.pdf>
- Council of the EU. 2018. "Conclusions on Enlargement and the SAP (Albania)." Marrë nga adresa: <http://www.consilium.europa.eu/media/35863/st10555-en18.pdf>
- Denoeux, G. dhe L. Carter. 2009a. "Development Assistance and Counter-Extremism: A Guide to Programming". Marrë nga adresa: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PNADT977.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADT977.pdf)
- Denoeux, G. dhe L. Carter. 2009b. "Guide to the Drivers of Violent Extremism". Marrë nga adresa: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/Pnadt978.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf)
- Departamenti i Shtetit i ShBA-ve. 2017. "International Religious Freedom Report." Marrë nga adresa: <https://www.state.gov/documents/organization/281118.pdf>
- Economist Intelligence Unit. 2017. "Democracy Index." Marrë nga adresa: <https://infographics.economist.com/2018/DemocracyIndex/>
- Elbasani, A. 2016. "State-organized Religion and Muslims' Commitment to Democracy in Albania." *Europe-Asia Studies*, vol. 68, issue 2.
- Endresen, C. 2015. "Faith, Fatherland or Both? Accommodationist and Neo-Fundamentalist Islamic Discourses in Albania". In Elbasani, A. and O. Roy (eds.) *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*, Basingstoke,





Palgrave Macmillan, pp. 222–241.

Faktor.al. 2018. Durrës, vritet me thikë në zemër 19 vjeçari, Anxhelo Gjokazaj. Marrë nga adresa: <http://www.faktor.al/2018/03/02/durres-vritet-me-thike-ne-zemer-16-vjecari->

Fazliu, H. 2017. Xhihadistët e burgosur në Maqedoni përpiqen të rekrutojnë online. Reporter.al. Marrë nga adresa: <https://www.reporter.al/xhihadistet-e-burgosur-ne-maqedoni-perpiqen-te-rekrutojne-online>

Forumi Mysliman i Shqipërisë. 2016. Shoqërimi i besimtarëve nëpër komisariate për sqarime. Marrë nga adresa: <http://www.fmsh-al.org/al/arkivi/izrael.html>

Freedom House. 2018. “Freedom in the World: Albania 2018 report.” Marrë nga adresa: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/albania>

Freedom House. 2018. “Nations in Transit 2018: Albania.” Marrë nga adresa: [https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018\\_Albania\\_o.pdf/](https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018_Albania_o.pdf/)

Fuga, A. 2004. Shoqëria periferike. Tiranë: Ora.

Gazeta Impakt. 2017. “Imam A. Aliu compares the Chair of AMC to Caushescu” (Nov. 2017). Marrë nga adresa: <http://gazetaimpakt.com/imam-armand-aliu-krahason-kryetar-in-e-kmsh-se-nikolla-causheskun/>

Gray, M. 2011. “Political Culture, Political Dynamics, and Conspiracism in the Arab Middle East.” In Graf, A, S. Fathi and L. Paul (eds.), *Orientalism and Conspiracy: Politics and Conspiracy Theories in the Islamic World*. London and New York, I. B. Tauris, pp. 105–127.

Human Rights Report. 2017. “Albania.” Marrë nga adresa: <https://www.state.gov/documents/organization/277377.pdf>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. 2015. “Religious Radicalism and violent extremism in Albania.” Marrë nga adresa: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. 2017. “Trust in Governance Opinion Poll.” Marrë nga adresa: <http://idmalbania.org/trust-governance-opinion-poll-2017/>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. 2018. “Trust in Governance: Opinion Poll 2017.” Marrë nga adresa: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/03/IDM-OpinionPoll-2017-EN-web.pdf>

Java News. 2018. “L. Vangjeli: Erdogan e ka shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i madh i lëvizjes gyleniste.” Marrë nga adresa: <http://www.javanews.al/lorenc-vangjeli-erdogan-e-ka-shpjetuar-shqiperine-nga-rreziku-madh-levizjes-gyleniste/>

Joppke, C. 2018. “Culturalizing Religion in Western Europe: Patterns and Puzzles.” *Social Compass*, vol. 65, issue 2, pp. 234–246.

Komisioni Evropian, 2018. “A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans.” Marrë nga adresa: [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf/](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf/)



- Komisioni Evropian, 2018. "European Commission Report 2018 Albania". Marrë nga adresa: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>
- Kullolli, A. 2009. "Proselytization in Albania by Middle Eastern Islamic organizations." Monterey (CA): Naval Postgraduate School. Marrë nga adresa: <http://www.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a496881.pdf>
- IBNA. 2018. "Unemployment in Albania Drops." Marrë nga adresa: <http://www.balkaneu.com/unemployment-in-albania-drops>
- INSTAT. 2012. "Albania: Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011." Marrë nga adresa: [http://www.instat.gov.al/media/3058/main\\_results\\_\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf)
- INSTAT. 2018. "Popullsia në Shqipëri, 1 janar 2018". Marrë nga adresa: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/population/publication/2018/population-in-albania-1-january-2018/>
- INSTAT, Swiss Agency for Development and Cooperation & UNFPA. 2015. Të rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë. Marrë nga adresa: <http://www.instat.gov.al/media/2791/libri-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-sfidat-n%C3%AB-koh%C3%ABt-q%C3%AB-ndryshojn%C3%AB.pdf>
- Monitorimi i Biznesit të Mediave në Shqipëri, 2018. Project available at <http://albania.mom-rsf.org/en/>
- Merdjanova, I. 2013. *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*. Oxford: Oxford University Press.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. 2015. "Strategjia Kmobëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020." Marrë nga adresa: [https://www.unicef.org/albania/National\\_Strategy\\_for\\_Social\\_Protection2015-2020\\_en.pdf](https://www.unicef.org/albania/National_Strategy_for_Social_Protection2015-2020_en.pdf)
- O'Brien, M. 2012. "Fluctuations Between Crime and Terror: The Case of Abu Sayyaf's kidnapping Activities." *Terrorism and Political Violence*, vol. 24, pp. 320–336.
- Open Society Institute Bulgaria. 2018. "2018 Media Literacy index." Marrë nga adresa: [http://osi.bg/downloads/File/2018/MediaLiteracyIndex2018\\_publishENG.pdf](http://osi.bg/downloads/File/2018/MediaLiteracyIndex2018_publishENG.pdf)
- OraNews. 2016. "Vendimi për "xhihadistët", Zhilla: Më i ashpëri në vendet e rajonit." Marrë nga adresa: <https://www.youtube.com/watch?v=L7iceHUCpyY>
- Picarelli, J. T. 2012. "Osama bin Korleone? Vito the Jackal? Framing Threat Convergence Through an Examination of Transnational Organized Crime and International Terrorism." *Terrorism and Political Violence*, vol. 24, pp. 180–198.
- Qafmolla, R. et al. 2017. Xhihadistët nga Ballkani 'të lirë' në internet. Reporter.al. Marrë nga adresa: <https://www.reporter.al/xhihadistet-nga-ballkani-te-lire-ne-internet/>
- Regional Cooperation Council. 2018. "Balkan Public Barometer 2018." Marrë nga adresa: <https://www.rcc.int/seeds/results/2/balkan-public-barometer>
- Roy, O. 2013. *Holy Ignorance: When Religion and Culture Part Ways*. Oxford: Oxford University Press.



- Sageman, M. 2004. *Understanding Terror Network*. Philadelphia: University of Philadelphia Press.
- Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit. Miratuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 18.11.2015. Marrë nga adresa: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf)
- Tirana Post. 2018. Mbrëmë u vra me thikë 14-vjeçari, në mëngjes një tjetër vrasje në Mamurras. Marrë nga adresa: <http://www.tiranapost.al/mbreme-u-vra-thike-14-vjecari-ne-mengjes-nje-tjeter-vrasje-ne-mamurras>
- Tošić, J. 2015. "The Loudspeaker of Faith in the 'Calm' City." In Elbasani, A. and O. Roy (eds.) *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*. Basingstoke, Palgrave Macmillan, pp. 95–97.
- Trading Economics. 2018. "Albania Employment Rate." Marrë nga adresa: <https://tradingeconomics.com/albania/employment-rate>
- Trading Economics. 2018. "Albania Unemployment Rate." Marrë nga adresa: <https://tradingeconomics.com/albania/youth-unemployment-rate>
- Trading Economics. 2018. "European Union GDP per Capita." Marrë nga adresa: <https://tradingeconomics.com/european-union/gdp-per-capita>
- Transparency International. 2017. "Corruption Perception Index 2017." Marrë nga adresa: [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2017#table](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017#table)
- UNDP & Institute for Democracy and Mediation. 2018. "Religious Tolerance in Albania." Marrë nga adresa: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albania.pdf>
- VKM Nr. 930, date 18 nëntor 2015." Marrë nga adresa: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf)
- VKM Nr. 737, datë 13 dhjetor 2017." Marrë nga adresa: <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%20225/VKM%20nr.%20737,%20date%2013.12.2017.pdf>
- Vurmo Gj. 2018. "Western Balkans Extremism Research Forum – Albania Report 2018." Marrë nga adresa: <https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/erf20albania20report202018.pdf> page 18.
- Zëri i Amerikës. 2017. "Turkey on Diplomatic Push to Close Schools Linked to Influential Cleric." Marrë nga adresa: <https://www.voanews.com/a/turkey-erdogan-gulen-schools/4010073.html>
- Zoto, E. 2013. "Failure and Success of the Jihadi Information Operations on the Internet." Master thesis. Monterey (CA): Naval Postgraduate School. Marrë nga adresa: <http://www.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a620523.pdf>



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Vurmo, Gjergji

Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri: vlerësim kombëtar i  
nxitësve, formave dhe rreziqeve / Gjergji Vurmo, Enis

Sulstarova. – Tiranë : IDM, 2018

144 f. ; 29.7x21 cm.

ISBN 978-9928-4385-2-2

1.Dhuna 2.Probleme sociale 3.Marrëdhënie mes njerëzve  
4.Marrëdhënie ndërfetare 5.Studim

316.48(496.5) (048.8)





